

1 E martë, 26 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i  
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që të  
12 gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

13 Do të vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të  
14 Prokurorisë W03873.

15 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për  
18 procesverbal që Avokati Kujdestar i Dëshmitarit W03873 është  
19 po ashtu i pranishëm në sallën e gjyqit.

20 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

21 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi, z. Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
23 vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju rikujtoj të përgjigjeni  
24 qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje,  
25 lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e

1 kuptoni. Gjithashtu na thoni ku i bazoni ju faktet dhe  
2 rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

3 Jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë  
4 e lexuat përmes deklaratës solemne. Gjithashtu ju rikujtoj  
5 garancitë që ju ka dhënë dje Trupi Gjykues dhe këto garanci  
6 vlejné ende. Në rast se ju refuzoni të përgjigjeni, mund të  
7 gjobiteni.

8 Mos harroni të flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë  
9 sekonda përpara se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë për hir  
10 të përkthyesve.

11 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do  
12 të bëjmë organizimin përkatës.

13 DËSHMITARI: HALIL QADRAKU [Vijon]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë  
15 me pyetjet nga Prokuroria. Dëgjojini me vëmendje.

16 Z. Pace, fjala është për ju.

17 DËSHMITARI: HALIL QADRAKU [Vijon]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Koci,  
19 keni diçka për të thënë?

20 Z. KOCI: Po. Mirëmëngjes, Gjykatë. Mirëmëngjes, të  
21 gjithëve. Me respektin më të madh për Gjykatën, do të them  
22 diçka. I kam disa vërejtje në lidhje me përkthimin. Jam  
23 vetëdijshëm për rolin tim shumë specifik në këtë proces, por  
24 nëse më lejon Gjykata, dy-tre fjalë i kisha thënë lidhur me  
25 përkthimin. Prapë po them, me gjithë respektin për Gjykatën.

1 Po filloj prej shqiptimit të gabuar të mbiemrit tim.  
2 Vazhdimisht thojnë Koçi, është Koci. Por kam përshtypje se  
3 shpesh ekipa e përkthimeve nuk e njuh kontekstin kosovar edhe  
4 të folmen e gjuhës tonë në Kosovë edhe pse flasim gjuhën e  
5 njëjtë, kam përshtypjen se përkthyesit janë të Shqipërisë.

6 Për shembull, ka probleme, nëse nuk e njuh kontekstin, me  
7 përkthi fjalën ka djek prej deke, kjo nuk --

8 Z. PACE: [Përkthim] Më falni që ju ndërpres, ky është  
9 parashtrim krejt i panevojshëm nga Avokati për dëshmitarin. Ka  
10 procese të tjera për të trajtuar këto aspekte. Nuk i takon  
11 Avokatit Kujdestar t'i trajtojë këto.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokat, na  
13 vjen keq, po duhet të pajtohemi. Nuk është kompetencë e jua  
14 të bëni parashtrime të tilla. Nëse ka nevojë do të dali.

15 Z. KOCI: Plotësisht pajtohem dhe unë me Prokurorinë. Por  
16 mendova që është detyrë edhe e imja me e ndihmu Gjykatën.  
17 Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
19 z. Koci. Dhe ju kërkohet ndjesë se emrin tuaj e shqiptojmë  
20 gabim ne. Shqiptimi vjen prej palëve, jo prej përkthyesve.

21 Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

24 PË. Mirëmëngjesi.

25 PY. Do vazhdojmë me atë videon që po shihnim dje.

1           Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem shohim në ekran materialin  
2 që mban numrin 11362302 dhe duhet të shikojmë segmentin kohor  
3 54:18 deri në 55:26. Njësoj si dhe dje, nuk do ta nxjerrim  
4 transkriptin në shqip, i cili për procesverbal ka numrin  
5 113623-02-TR *Revised*, por do të shohim faqen përkuese që mban  
6 numrin 13 nga gjysma e poshtë, do të fillojmë me fragmentin  
7 përkues ku thotë: "Halil Qadraku" dhe do të shkojmë deri në  
8 fund të faqes. Dhe përbri videos, do të nxjerrim transkriptin  
9 në anglisht që mban numrin 113623-03-TR-ET *Revised* dhe tek  
10 transkripti do të shohim dy rreshtat në faqen e 13 deri në  
11 fillimin e faqes tjetër, ku thotë: "... komisioni disiplinor  
12 ...", pra, deri këtu.

13           Pra, do shohim materialin filmik. Dhe njësoj si dje, do  
14 të bëj disa pyetje.

15           Edhe një herë ju lutem e vendosim videon në minutën e  
16 54:18 dhe ndaloni tek 55:26.

17                               [Luhet videoincizimi]

18           "Halil Qadraku: Në qoftë se ka pas segmente brenda LDK-së  
19 që kanë qenë kundër nesh, ai është individi, po jo LDK-ja.

20           "Gazetari: A ka pas individë të tillë brenda LDK-së?

21           "Halil Qadraku: Po s'kam pas asi rasti. Për shembull,  
22 kemi ndëgjju pakëz, diçka, janë kanë disa mosmarrëveshje me  
23 Fetah Rudin në Malishevë.

24           "Gazetari: Po.

25           "Halil Qadraku: Unë çka mbaj mend, kishin tentuar

1 ushtarët për me grumbullu millin nëpër disa fshatra me jua çu  
2 banorëve. Janë kanë të strehum banorët nëpër lugina.

3 "Gazetari: Po.

4 "Halil Qadraku: Me një vend 10.000, me një vend 15.000,  
5 kanë mbet pa mill. Dhe tash kanë marrë -- u lëshu urdhri nga  
6 Shtabi i Përgjithshëm që me u kujdes për popullatën që janë në  
7 fusha të shpërngulur nga shtëpitë.

8 "Gazetari: Po.

9 "Halil Qadraku: Edhe ka shku ushtria për me marrë millin  
10 në për q'ato fshatra. Ai tash si kryetar i LDK-së, duke qenë  
11 ushtar i UÇK-së, Fetah Rudi, ushtar i UÇK-së. Po kryetar i  
12 LDK-së i atij fshati apo ça.

13 "Gazetari. Po.

14 "Halil Qadraku: "Jo, nuk bën ju me marrë." "Pse?", "Jo,  
15 këtu jam unë", "Dhe ti djalë a din ...". E qaty e kanë pas një  
16 farë mosmarrëveshje. E kanë marrë, e kanë çu në zonë në  
17 komision disiplinor.

18 "Gazetari: Po.

19 "Halil Qadraku: Pse? Me pengu."

20 Z. PACE: [Përkthim]

21 PY. Faleminderit. Tani do t'ju tregoj dhe transkriptin.

22 "Halil Qadraku: Po të kishte segmente brenda LDK-së që të  
23 ishin kundër nesh, këta ishin individë të caktuar, jo LDK-ja.

24 "Gazetari: A kishte persona të tillë brenda LDK-së?

25 "Halil Qadraku: Unë nuk kam parë raste të tilla. Për

1 shembull, kemi dëgjuar që ka pas mosmarrëveshje me Fetah Rudin  
2 në Malishevë.

3 "Gazetari: Po.

4 "Halil Qadraku: Nga sa më kujtohet, ushtarët shkuan për  
5 të marrë miell në disa fshatra për t'ua shpërndarë banorëve.  
6 Banorët ishin strehuar në lugina.

7 "Gazetari: Po.

8 "Halil Qadraku: Ishin 10,000 në një vend, 15,000 në një  
9 vend tjetër, të cilët nuk kishin miell. Pra, ata e morën,  
10 kishte një urdhër të lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm që të  
11 kujdesej për popullatën që ishte në terren të larguar nga  
12 shtëpitë e tyre. Ushtria shkoi në fshatra të mbledhte miell.  
13 Pra, ai, si drejtues i LDK-së, e në të njëjtën kohë ishte  
14 ushtar i UÇK-së, pra, Fetah Rudi, një ushtar i UÇK-së, por  
15 udhëheqës i LDK-së në atë fshat u afrua. Citoj: 'Jo, nuk duhet  
16 ta merrni.', 'Pse?'. 'Jo, unë jam përgjegjës këtu'. 'Por  
17 djalosh' ... pra, vetëm në këtë rast ka pasur një marrëveshje.  
18 E ndaluan dhe e dërguan te zona ... tek përpara komisionit  
19 disiplinor ..."

20 Dëshmitar, pikësëpari ku e dini ju që ka pasur një urdhër  
21 nga Shtabi i Përgjithshëm për t'u kujdesur për popullatën siç  
22 thuhet në këtë transkript?

23 PË. Një urdhër si i dhënë si urdhër nuk ka pasur, mirëpo ka  
24 qenë një komunikatë e Shtabit të Përgjithshëm e cila është  
25 lëshuar më 31 mars të vitit 1999, e cila ka pas brenda asaj

1 komunikate dy çështje. Çështja e parë ka qenë mobilizimi i  
2 përgjithshëm i të gjithë njerëzve të aftë për luftë dhe  
3 çështja e dytë ka qenë obligim i të gjithë ushtarëve të UÇK-së  
4 në terren ta ndihmojnë popullatën me të gjitha nevojat që  
5 kanë. Në këtë aspekt ndoshta unë këtu e kam thënë si urdhër,  
6 po ishte një lloj njoftimi komunikues përmes mjeteve të  
7 informimit atëherë që ishin të disponueshme.

8 Si rast, si rast, këtë intervistë e kam dhënë vitin e  
9 kaluar edhe shumë vonë e kam mësuar problemin. Ky problem edhe  
10 nuk ka qenë problem, po tashti dikush, dikush mund ta bën  
11 problem nga asgjëja. Ka filluar për miell mes ushtarëve të  
12 UÇK-së edhe ushtarit Fetah Rudi. Ai ka qenë njëkohësisht  
13 ndoshta edhe pjesë e Shoqatës Nënë Tereza. Ka pas një sasi  
14 mielli të caktuar në depon e tij, e ushtarët i kanë thënë që  
15 pak miell të shpërndajë edhe nëpër ato vende ku popullata ka  
16 qenë e stacionuar apo e mshefur apo për ato momente.

17 Kështu që ka qenë një mosmarrëveshje që nuk do të duhej  
18 të ishte problem kaq i madh sa të vijë këtu. Kaq di unë për  
19 këtë.

20 PY. Dëshmitar, ju lutem thjesht përqendrohuni tek pyetja. E  
21 kisha fjalën vetëm për urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm.

22 Ju thatë në video që ishte, ekzistonte një urdhër i  
23 lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm, por në formën e një  
24 komunikate. Nga e mësuar ju ekzistencën e kësaj komunikate apo  
25 përmbajtjen e saj?

1 PË. Më duket se e thashë qartë se ka qenë përmes mjeteve të  
2 informimit. Atëherë Kosova informohej përmes Radio Tiranës apo  
3 TV Shqipërisë, e kishte një gjysëm ore të rezervuar në atë  
4 televizion. Kishim edhe radion tonë Radio Kosova e Lirë, e  
5 cila ishte po ashtu në zonën tonë dhe mund ta dëgjonim me  
6 krenari. Kështu që, ajo komunikatë, ajo thirrje e Shtabit të  
7 Përgjithshëm është dhënë dhe është dëgjuar nga të gjithë  
8 shqiptarët kudo që janë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni e  
9 në troje tjera.

10 PY. Flasim për një aspekt tjetër që pamë tek materiali  
11 filmik. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues nga e keni mësuar ju  
12 incidentin lidhur me Fetah Rudin që përmendet në këtë pjesë të  
13 videos për të cilën ju dhatë dëshmi para një çasti?

14 PË. Po e thashë, që pas luftës këto zëra janë dëgjuar nëpër  
15 kularët e shokëve, nëpër shoqërinë, që është biseduar se  
16 kështu-kështu ushtari Fetah Rudi e ka bërë të qartë një  
17 problem që s'ka qenë problem, po që e ka problematizue. Edhe  
18 unë, sigurisht, kam takuar shokë, bashkëluftëtarët tanë nga  
19 ajo brigadë, që është Brigada 122, që operonte në kuadër të  
20 Zonës Operative të Pashtrikut edhe me siguri se nga ata kam  
21 mësuar se ku, pse ka lind ky problem. Dhe ata më kanë treguar  
22 se ky problem ka lind kështu siç e kam shpjeguar unë. Kaq di  
23 unë për këtë.

24 PY. Kush janë këta shokët e Brigadës 122 që ta dhanë këtë  
25 informacion?



1 PË. Brigada 122 kishte përmbi 1200 ushtarë dhe tashti unë nuk  
2 mund të flas me emër e mbiemër me cilin. Mirëpo jam takuar me  
3 shumë nga ata si në Prizren, si në Malishevë, si në Rahovec  
4 nëpër ndonjë përvjetor, nëpër ndonjë ndeje, nëpër ndonjë  
5 festim kombëtar. Nuk kam ndonjë datë të përcaktuar ku dhe kur,  
6 por nga ta.

7 PY. Kush ka qenë komandanti i Brigadës 122?

8 PË. Unë mendoj se në përfundim të luftës komandant i Brigadës  
9 122 ka qenë Vllaznim Kryeziu edhe në këtë kohë.

10 PY. Cila ka qenë zona e përgjegjësisë e kësaj brigade, pra, e  
11 Brigadës 122?

12 PË. Unë mendoj që zona e përgjegjësisë e kësaj brigade ka  
13 qenë në pjesën perëndimore të aksit rrugor Rahovec-Malishevë.  
14 Domethënë, Malisheva e Ulët, pjesa e poshtme e Malishevës ka  
15 qenë zona e veprimit e kësaj brigade.

16 PY. Përfshihet Bubëli këtu? Bubëli - shqiptimi sipas  
17 Prokurorit - Bubël, fshati Bubël.

18 PË. Po.

19 PY. Thatë që e keni mësuar këtë incident lidhur me Fetah  
20 Rudin pas luftës. Më konkretisht kur e keni mësuar?

21 PË. Nuk di ta them kur, por pas luftës ka qenë. Dhe ato vonë  
22 pas luftës, ndoshta mbas dhjetë vjetësh, dhjetëvjeçarit e  
23 fundit apo dymbëdhjetëvjeçarit e fundit.

24 PY. A ju kujtohet të keni dëgjuar lidhur me këtë incident në  
25 Rahovec në qershor të 1999 apo në Prizren në korrik të 1999?

1 PË. Ndoshta, nuk më kujtohet tani.

2 PY. Në materialin filmik, ju thoni që Fetah Rudin e çuan tek  
3 zona. Mesa keni ju dijeni, në cilën pjesë të zonës e dërguan?

4 PË. Unë atëherë nuk isha prezent në lokalet e Zonës Operative  
5 të Pashtrikut kur ka ndodh kjo. Mirëpo, atë, ju po thoni e  
6 çuan, ata të gjithë edhe ushtarët që kanë kërkuar miell edhe  
7 këta ushtarët që s'ju kanë dhënë miell, të gjithë bashkë kanë  
8 shkuar në zonë që secili të japë arsyet e veta. Këta pse s'e  
9 japin miellin, kurse ata pse e duan miellin. Kështu që kanë  
10 shkuar të mirren vesh a kanë të drejtë këta që po e ruajnë për  
11 vete apo kanë të drejtë edhe ata që po kërkojnë për me  
12 shpërnda miellin.

13 Domethënë, kanë shku si grup, kanë shku si  
14 bashkëluftëtarë, kanë shku si pjesë e një brigade se edhe  
15 Fetah Rudi edhe ata që kanë shku me të kanë qenë  
16 bashkëluftëtarë mes vete. E nuk flitet këtu që dikush dikën e  
17 ka dërguar me dhunë apo me diçka. Kanë shkuar që të qartësohen  
18 dhe të deklarohen.

19 PY. Ju i thatë Gjykatësve që vetë ju nuk keni qenë i  
20 pranishëm kur ka ndodhur ky incident. Por kur ka ndodhur ky  
21 incident?

22 PË. Nuk më kujtohet, se prapë ju them, saktësisht se kur ka  
23 ndodhur. Mirëpo, kjo duhet të ketë ndodhur pas prilli, maji i  
24 vitit 1999. Ndoshta ne kemi qenë diku në luftime të tjera me  
25 pjesëtarë të tjerë të zonës. Por një e di se është përmendur

1 edhe atëherë, domethënë, ndoshta si rast, po ka qenë kaq rast  
2 jo i rëndësishëm se dhënia apo mos dhënia e miellit për këto  
3 nuk ka qenë rast që do të duhej të diskutohej në komandë. Se  
4 po të ishte ndonjë problem më i madh, jam i bindur, jam i  
5 bindur se do ta kishte, do ta kishte lajmëruar vetë  
6 bashkëluftëtari Fetah Rudi në brigadën e vet apo në Zonën  
7 Operative të Pashtrikut si rast, si rast që i ka ndodhë atij  
8 nga dikush me qëllime të këqija apo me diçka.

9 Prandaj nuk është, nuk është trajtuar si rast edhe si  
10 çështje kjo. Kjo është bë çështje politike mbas luftës. Mbas  
11 luftës ka shumë tendenca në Kosovë që pjesëtarët e UÇK-së të  
12 anatemohen, të cilësohen si kundërshtarë të LDK-së e që unë e  
13 kundërshtoj, sepse nuk ka qenë e vërtetë kjo. Kosova, z.  
14 Gjykatës, ka pas 20 kryetarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës  
15 nëpër të gjitha komunat. Në asnjë komunë, asnjë kryetar i LDK-  
16 së nuk ka pas problem me ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të  
17 Kosovës.

18 Janë disa individë të yshtur, të yshtur nga mendësia e  
19 tyre për të bërë problem nga diçka që nuk ka qenë problem. Kjo  
20 në atë kohë nuk ka qenë problem. Kjo është problematizue shumë  
21 vonë kur ata deshën ta shfrytëzojnë për qëllimet e tyre  
22 politike.

23 PY. Dëshmitar edhe një herë, po përgjigjeni më shumë se  
24 ç'duhet. Unë thjesht doja të dija kur ka ndodhur kjo ngjarje.  
25 Duhet të më mirëkuptoni se e kam shumë të kufizuar kohën.

1 Pak më herët ju the Gjykatësve, përmende persona që  
2 refuzuan ta jepnin miellin dhe kur the "ata" përdore shumësin.  
3 Mesa keni ju dijeni, me përjashtim të Fetah Rudit që u çua tek  
4 zona, ka qenë ndonjë person tjetër me të?

5 PË. Unë jam i bindur se dikush duhet të jetë me të. Se një  
6 njeri i vetëm as nuk mund ta ruajë miellin, as nuk mund ta  
7 ndalojë shpërndarjen e miellit. Mirëpo ka qenë ai ndoshta ai  
8 me një grup të bashkëfshatarëve të tij apo bashkëveprimtarëve  
9 në atë Shoqatën Nënë Terezë. Nuk jam në dijeni. Prapë po them,  
10 nuk ka qenë problem. Kjo ka ndodhë në periudhën sepse  
11 komunikata e Shtabit të Përgjithshëm ka qenë në 31 mars. Kjo  
12 ka ndodhë sigurisht në prill, maj të 1999, si kohë që e  
13 kërkuat ju kur ka ndodhë. Po sesi ka ndodhë kjo që flitet tani  
14 nuk është e vërtetë. Nuk ka qenë kështu.

15 Ata kanë shkuar për t'u sqaruar në zonë pse ky grup nuk e  
16 jep miellin dhe pse ky grup po e kërkon miellin. Kaq. Edhe  
17 janë besoj që janë marrë vesh atëherë. Po më vonë është  
18 politizuar.

19 PY. Dëshmitar, ku e keni fjalën ju që:

20 "... ky përshkrim nuk është i vërtetë".

21 Cili përshkrim nuk është i vërtetë? Për çfarë e keni  
22 fjalën?

23 "Nuk kanë ndodhur kështu ngjarjet", thatë ju. Çfarë?

24 PË. Z. Gjykatës, personi në fjalë, Fetah Rudi, bashkëluftëtar  
25 i jonë, ushtari i UÇK-së, në Kosovë, në Kosovë nëpër mediat e

1 tjera e trillon këtë problem kinse. Ai ka pas kësi kërcnime,  
2 kinse ai ka pas probleme me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës  
3 duke qenë edhe vetë pjesëtar i ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.  
4 Nga kjo po them unë, nuk di çfarë keni ju. Nuk di as ku jeni  
5 bazuar në to.

6 Fjala ime atëherë, vitin e kaluar, ka qenë e bazuar mbi  
7 thashethemet që unë kam dëgjuar nëpër mediat atëherë në Kosovë  
8 se ai akuzon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për kinse dikush e  
9 ka kërcënuar pse atë për atë çështje. Prandaj unë e kam folur  
10 këtu vitin e kaluar në televizion. Nuk kam ditur që kjo do të  
11 përdoret sot, po nuk e kontestoj. Asgjë nuk e kontestoj.  
12 Kështu mendoj, kështu është.

13 Edhe kur të doni ju mund të shkojmë në Kosovë ose ta  
14 ftoni këtu Fetah Rudin edhe ata që kanë qenë me të dhe do të  
15 tregoj, do ta shifni se ajo, ajo çështja ka qenë ashtu si po  
16 ju them unë. Nuk ka qenë problem atëherë. Është bërë problem  
17 pas luftës vetëm për dëshirat e tyne të smura politike.

18 PY. Në video ju keni thënë që Fetah Rudin e çuan në zonë tek  
19 komisioni disiplinor. Çfarë ishte ky komision disiplinor që e  
20 keni përmendur ju gjatë intervistës?

21 PË. Më fal. Komisioni disiplinor në zonë ka qenë komandanti  
22 Tahir Sinani, ka qenë zëvendëskomandanti Tahir Sinani, ka qenë  
23 komplet Zona Operative e Pashtrikut që ka qenë një nivel pak  
24 më lartë se Brigada 122. Edhe, normalisht, që për një problem  
25 që ka ndodhë në brigadë. Po të kishte ndodhë një problem në

1 kompani, kishin shku ndoshta tek komandanti i batalionit me u  
2 marrë vesh me një instancë më lartë. Ata kanë menduar që të  
3 shkojmë në zonë, është një instancë pak më e lartë që të  
4 mirremi vesh, që të mirren vesh mes veti çfarë do bëjmë me  
5 këtë çështje të miellit, që tani u bë shumë, shumë e njohur.

6 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim videon dhe transkriptin  
7 nga ekрани.

8 I nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e videos, të  
9 transkriptit dhe të përkthimit përkatës në tërësinë e vet.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
11 kundërshtime?

12 Z. DIXON: [Përkthim] Unë e kuptoj që intervista zgjat  
13 rreth një orë, nuk kam kundërshtim që të pranohen segmentet  
14 përkatëse, kështu që le të -- mendoj që duhet të pranohet e  
15 gjitha.

16 Z. PACE: [Përkthim] Po. Dhe unë dua të pranohet e gjithë  
17 videoja, megjithatë në qoftë se palët thonë që nuk duhet  
18 pranuar e gjithë videoja, ne mund ta shikojmë atëherë pjesë  
19 pas pjese videon.

20 Unë i kam treguar pjesë të ndryshme të videos  
21 dëshmitarit. Dëshmitari ka konfirmuar se videoja është e  
22 vërtetë. Pjesët që nuk i kemi treguar ne dëshmitarit deri tani  
23 nuk kanë qenë relevante për çështjen tonë.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Por dëshmitari nuk ka dhënë asnjë  
25 koment për pjesët e tjera të videos. Sidoqoftë, ne mund ta

1 trajtojmë këtë gjatë kundërpjetjeve tona.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po i japim  
3 një numër provizor për momentin dhe do të japim numrin  
4 përfundimtar pasi të përfundoni dhe ju pyetjet tuaja.

5 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nëse ju nuk e  
6 pranoi të gjithë videon tani, atëherë unë do kërkoj kohë  
7 shtesë që ta shohim edhe pjesën tjetër të videos me  
8 dëshmitarin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. PACE: [Përkthim] Presim një çast sa t'i japim numrin  
11 provizor videos.

12 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës  
13 këshillohen]

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali që mban numrin  
15 ERN 113623-02, anglishtja edhe shqipja, marrin numrin provizor  
16 të provës P01863 dhe klasifikimi është konfidencial.

17 Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

18 PY. Dëshmitar, dje ju dhatë dëshmi për Ilaz Kadollin, pamë  
19 gjithashtu edhe disa pjesë të librit të tij. Tani do ju tregoj  
20 një fletë tjetër të librit të tij dhe pastaj do ju bëj disa  
21 pyetje.

22 Z. PACE: [Përkthim] Për Sekretarin, i kërkoj që të  
23 paraqesë në ekran dokumentin 057924 deri në 058024 për brinjë  
24 përkthimit në anglisht që ka të njëjtin numër ERN dhe  
25 përfundon me -ET në fund. Le të shkojmë në faqen 058011 në të

1 dyja versionet.

2 PY. Dëshmitar, ndërkohë që paraqitet faqja që kërkoja, dua  
3 t'ju pyes a e kuptoj drejt që ju keni thënë që së bashku me  
4 Sadik Halitjahën keni krijuar Syrin e Shqiponjës, njësitin  
5 Syri i Shqiponjës për të cilin zëvendës ishte Ilaz Kadolli? A  
6 është e vërtetë kjo, a thatë kështu dje?

7 PË. Po.

8 Z. PACE: [Nuk ka përkthim].

9 DËSHMITARI: Nuk kam përkthim. Nuk kam përkthim çfarë  
10 ishte pyetja. E kam lexuar artikullin. Nuk kam përkthim nga  
11 përkthyesi çfarë ishte pyetja.

12 PËRKTHYESJA: Një, dy tre, katër dëgjoni, Dëshmitar?

13 DËSHMITARI: Po. Po, tani po. Po, tani po. Nuk e kuptova  
14 pyetjen. Kërkoj falje. Nuk e ndëgjova në fakt.

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 PY. Do ta përsëris edhe një herë pyetjen për ju, Dëshmitar.  
17 Pyetja që kisha për ju ishte kjo: Sikurse e shikoni tek pjesa  
18 që keni përpara ose që e dëgjuat përmes përkthimit, z. Kadolli  
19 në këtë pjesë i referohet një godine, një përdheseje me beton,  
20 e dyer e dritare të hekurta që mbahej Fetah Rudi, që më parë  
21 kishte qenë servisi i makinave dhe më tej ai thotë që "në  
22 rrethana lufte objekti plotësonte kushtet e një vendbanimi të  
23 përkohshëm".

24 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A jeni në  
25 dijeni të një vendi ose objekti të tillë në zonën e



1 përgjegjësisë së Zonës Operative të Pashtrikut në vitin 1998?

2 PË. Jo, që nuk jam në dijeni, nuk jam fare. Por po ta dija se  
3 këto gjëra kështu kanë ndodhur, nuk do t'i lejoja edhe nuk e  
4 besoj që ka qenë, po mungesa e jonë atje ka mund të ndodhë çka  
5 do.

6 PY. Për të qenë të qartë, a jeni në dijeni të anëtarëve të  
7 zonës operative ku ju keni qenë, domethënë, G2, që ka pasur  
8 një servis makine që përdorej për ndonjë qëllim, jeni në  
9 dijeni të kësaj, Dëshmitar?

10 PË. Jo, zotëri.

11 PY. Më herët, tek pjesa që ju po i shpjegonit Gjyqtarëve, i  
12 thatë që incidenti me Fetah Rudin kishte të bënte me  
13 mosmarrëveshje për miellin. Megjithatë, sikurse mund ta  
14 shikoni nga kjo pjesë, z. Kadolli thotë që edhe rojet dhe  
15 Fetah Rudi i kishim përmendur që Fetah Rudi ishte i ndaluar  
16 për dyshim për propagandë dhe kontakt me serbët.

17 A keni dëgjuar ju, Dëshmitar, ndonjë gjë lidhur me këto  
18 akuza ndaj tij?

19 PË. Jo, zotëri. Sepse unë atë që kam dëgjuar për Fetah Rudin  
20 është që nga fillimi, që nga maji, qershori i vitit 1998 ai ka  
21 qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë ushtar i  
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto fjalë që këtu tani për  
23 herë të parë i dëgjoj apo i lexoj në këtë libër, unë nuk i kam  
24 dëgjuar kurrë.

25 PY. Ju na thatë që nofkën e keni pasur Fatos ose Fatosi, në

1 1998 apo në 1999. Mesa dijeni keni ju, Dëshmitar, a kishte  
2 ndonjë person tjetër që kishte të njëjtën nofkë?

3 PË. Në zonë, jo. Në strukturë udhëheqëse të zonës, jo, unë  
4 nuk kam njohur ndonjë njeri që ka pseudonimin Fatos.

5 PY. Brenda G2-it, njësitit G2 ose ZKZ-së a ka pas ndonjë  
6 person që quhej Xhavit përveç Xhavit Bajraktarit?

7 PË. Jo. Përpos Xhavit Bajraktarit në sektorin e G2-it, nuk ka  
8 pas Xhavit tjetër.

9 PY. A e njihni qytezën ose fshatin Zhur - siç e tha  
10 Prokurori.

11 PË. Fshatin Zhur unë e di ku është.

12 PY. Në vitin 1998 ose 1999 a ka qenë kjo pjesë e  
13 përgjegjësisë e Zonës Operative të Pashtrikut?

14 PË. Gjeografikisht Zhuri ka qenë gjithmonë në Zonën Operative  
15 të Pashtrikut. Por Zhuri si Zhur, nuk mendoj që ka pas  
16 ndonjëherë lëvizje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës aty apo  
17 një organizim sepse organizimi ka qenë në zonën e Vrrinit.  
18 Kështu që, domethënë, gjeografikisht Zhuri i përket Zonës  
19 Operative të Pashtrikut.

20 PY. A keni dëgjuar ose a keni dijeni lidhur me një person që  
21 është njohur si Zharko - siç e tha Prokurori shqiptimin.

22 PË. Zharko më duket që ka qenë një pjesëtar i policisë serbe  
23 në atë kohë në Zhur. Më duket se kam pas një informacion në  
24 ato letrat e mia për të. Edhe më shpesh është përmendur ai  
25 emër si një njeri tepër i dhunshëm. Kaq di. Po më tepër nuk më

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje nga z. Pace [Vazhdim]

Faqe 19

1 kujtohet diçka.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më  
3 lejoni, kërkoj që të kaloj në seancë private për tre ose katër  
4 minuta dhe kjo për mbrojtjen e palëve të treta.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë  
6 në seancë private.

7 Sekretar, na kaloni në seancë private për mbrojtjen e  
8 dëshmitarit ose të një pale të tretë.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje nga z. Pace [Vazhdim]

Faqe 28

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 jemi në seancë publike.

1 Z. PACE: [Përkthim]

2 PY. Ndërkohë që paraqitet dokumenti në ekran, a ju  
3 kujtohet që gjatë seancës përgatitore ju treguam disa  
4 fotografi që janë marrë prej adresës tuaj në Facebook, prej  
5 profilit tuaj në Facebook, ju kujtohet kjo?

6 PË. Po, më kujtohet.

7 PY. A ju kujtohet që keni shkruar disa emra dhe disa numra në  
8 këto fotografi dhe më pas i keni nënshkruar fotografitë dhe  
9 keni shkruar dhe datat përkatëse?

10 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

11 PY. Do kërkoja që t'i hidhni një sy faqes që keni në ekran  
12 për një çast.

13 Z. PACE: [Përkthim] Dhe tani le të kalojmë tek faqja  
14 tjetër, tek fotografia tjetër domethënë. Vazhdojmë më tej me  
15 faqen tjetër. Vazhdojmë më tej. Dhe me faqen e fundit tani.

16 PY. Dëshmitar, a ju kujtohen që këto ishin disa prej  
17 fotografive që kemi diskutuar bashkë gjatë seancës  
18 përgatitore?

19 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

20 Z. PACE: [Përkthim] A mund të shkojmë në fund të kësaj  
21 faqeje për momentin.

22 PY. A konfirmoni që nënshkrimi që është këtu është nënshkrimi  
23 juaj, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e shikoj kohën.

1 Dhe besoj që ka ardhur koha për pushimin. Në qoftë se do bëjmë  
2 pushimin prej dhjetë minutash, më duhen dhe 15 minuta tjera  
3 për të përfunduar me pyetjet për këtë dëshmitar.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
5 kemi pushim për dhjetë minuta. Mund të dilni nga salla e  
6 gjyqit bashkë me Sekretaren. Siç e thashë, pushimi është  
7 dhjetë minuta. Do të jemi përsëri këtu për dhjetë minuta.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë  
10 publike?

11 Z. TULLY: [Përkthim] Po. Seanca publike është në rregull.

12 I morëm dokumentet nga lista e dokumenteve. E kam fjalën  
13 për numrin 7, për dokumentin me numër 7, e kam pak të vështirë  
14 që të gjej numrin ERN, duhet që të më ndihmoni në qoftë se  
15 është e mundur për të gjetur numrin ERN të këtij dokumenti.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e  
17 kontrollojmë dhe do ju themi pas pushimit.

18 Tani bëjmë pushimin për dhjetë minuta.

19 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

20 --- Seanca rifillon në orën 10.14

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
22 [Përkthim] Besoj se u zgjidh?

23 Z. TULLY: [Përkthim] Jo. që në fillimin e kësaj çështje  
24 gjyqësore për materialet sipas rregullës 102(3) praktika ka  
25 qenë që disa ekipe i merrnin materialet, disa ekipe nuk i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Pace [Vazhdim]

Faqe 31

1 merrnin, dhe për shkak të kësaj, është një dokument që nuk e  
2 kemi nga lista dhe besoj që për ekipin e Mbrojtjes së Thaçi  
3 mungojnë tre dokumente. Do lutesha që ta zgjidhnim këtë me  
4 Prokurorinë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt e verifikova dhe  
6 unë z. Tully gjatë pushimit, më duket se bëhet fjalë për  
7 materialin SPOE00070003, i cili është nxjerrë sipas rregullës  
8 102(3) dhe as ekipet e tjera nuk e kanë të njëjtin materialin.  
9 Besoj që ju duhet t'i kërkonti Prokurorisë që tua nxjerrë  
10 materialin dhe e njëjta gjë vlen dhe për ekipin e mbrojtjes së  
11 z. Thaçi.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
14 Tani mund të sjellim dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
17 Dëshmitar. Prokuroria ka ende disa pyetje për ju. Ju lutem  
18 dëgjojini me vëmendje.

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem të shkojmë në  
20 faqen e parë të këtij dokumenti që mban numrin SPOE00360152  
21 [Sipas përkthimit]. Ju lutem ta zmadhojmë pak në mënyrë që të  
22 shohim të gjitha emrat që janë të shfaqura në fotografi.  
23 PY. Dëshmitar, e di që e trajtuam pak këtë, po është e  
24 nevojshme që ta sqarojmë edhe një herë. A mund të na tregoni  
25 kush është personi me numrin 1 në këtë fotografi. Thjesht

1 emrin, ju lutem.

2 PË. Personi me numër 1 është Selim Gashi. A të vazhdoj?

3 PY. Po. ju lutem, po. Thoni emrin pastaj -- më fal, thoni  
4 numrin pastaj emrin.

5 PY. Me numrin 2 është Hajdin Abazi, i njohur me pseudonimin  
6 Lum Haxhiu; me numrin 3 është Kadri Veseli, Luli; me numrin 4  
7 është Sadik Halitjaha; me numrin 5 është Adem Grabovci; me  
8 numrin 6 është Mensur Zyberaj; me numrin 7 është Naim Gashi;  
9 me numrin 7 -- 8 është Safet Syla; numri 9 jam unë; numri 10  
10 është Isuf Krasniqi, edhe numri 11 është Nuri Bexheti me  
11 nofkën Hoxha, tani po më kujtohet, para një jave, jo.

12 PY. Çfarë roli ka pasur personi me numrin 8, Safet Syla, në  
13 UÇK?

14 PË. Me atë që unë di që mbaj mend, Safet Syla ka qenë shef i  
15 ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm, përgjegjës për  
16 komunikacion me radiomarrëse apo radiolidhëse.

17 PY. Po numri 10 i Isuf Krasniqi, çfarë pseudonimi ka, sepse e  
18 përmendët dje. Ju lutemna e thoni ngadalë në shqip  
19 pseudonimin.

20 PË. Pseudonimi i Isuf Krasniqit është Mësuesi.

21 PY. A mund ta gërmëzoni, ju lutem?

22 PË. M-ë-s-u-e-s-i.

23 PY. A do të thotë arsimtar, ë, *teacher* në anglisht?

24 PË. Nënkupton mësues, *teacher* në anglisht, po.

25 PY. Dëshmitar, a pajtoheni ju me mua që kjo fotografi ngjan



1 deri diku edhe me videon që pamë të intervistës tuaj

2 televizive të cilën e diskutuam dhe dje?

3 PË. Kjo fotografi ngjan me atë dhe është bërë në ato momente  
4 kur është bërë edhe ajo e para. Ju kam thënë se këtë fotografi  
5 e ka bërë për ta pasur vetë Lumi Haxhiu apo Hajdin Abazi. Këtë  
6 fotografi e kam parë pas luftës. Unë nuk e kam pasur në  
7 pronësi deri vonë.

8 PY. Që të jemi të qartë, të dyja fotografitë janë shkrepur në  
9 mars 1999 në Nishor, kështu?

10 PË. Po. Dy apo tre. Po, janë shkrepur në mars 1999 në Nishor.

11 PY. Fotografia që kemi aktualisht në ekran dhe ajo që pamë  
12 dje në video, të kujtohet me përafërsi kur janë bërë në mars  
13 të '99-s?

14 PË. Ju kam thënë ndoshta që është kah mesi i marsit, mesi,  
15 pjesa lart. Mundet me konë 15, 16, 17 mars. Nuk më kujtohet  
16 saktësisht, por marsi ka qenë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër.

18 PY. Në këtë faqe identifikimi është shumë i qartë dhe nuk  
19 është nevoja ta bëjmë edhe një herë. Por, dua t'ju pyes kur  
20 është bërë kjo fotografi?

21 PË. Kjo fotografi është bërë në Krumë përafërsisht mars,  
22 prill i vitit 1999 -- 1998, kërkoj falje.

23 PY. Ju keni identifikuar personin në mes me emrin Gani  
24 Krasniqi. A ju kujtohet prej nga po vinte ose ku po shkonte  
25 Gani Krasniqi kur është bërë kjo fotografi?

1 PË. Në mes në këmbë Gani Krasniqi nga Malisheva. Ne së bashku  
2 kemi shkuar nga Kosova në Shqipëri. Ai kishte punë të  
3 kontaktonte, më vonë e kam marrë vesh, jo kur kemi shku,  
4 kishte punë të kontaktonte me kryeministrin Bukoshi sepse  
5 ishte dhe vetë pjesë e shoqatës Nënë Tereza, nga i cili ka pas  
6 marrë një shumë të konsiderueshme të parave për shoqatën Nënë  
7 Tereza.

8 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

9 PY. E zvogëlojmë pak, ju lutem, këtë. Dhe shohim që në të  
10 majtë keni identifikuar veten dhe Selim Gashin më të djathtë  
11 dhe keni vendosur datën 17 korrik 1999. Mesa ju kujtohet është  
12 e saktë data?

13 PË. Po, kjo datë është e saktë. Ishte përvjetori i parë i  
14 festimit të ditës së çlirimit të betejës së Rahovecit,  
15 përvjetori i parë, se beteja kishte ndodhur me 17 korrik të  
16 vitit 1998, prandaj jam i sigurt sepse këtu kam qenë  
17 përgjegjës edhe për sigurinë e shumë mysafirëve që kanë ardhur  
18 në Rahovec.

19 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

20 PY. Këtu keni identifikuar veten tuaj dhe Isuf Krasniqin. A  
21 mund të na thoni ku edhe kur është bërë kjo fotografi?

22 PË. Kjo fotografi duhet të jetë bërë në ditët e para kur unë  
23 kam shkuar nga Rahoveci në Prizren, domethënë, mund të ishte  
24 korriku i vitit 1999, te objekti i konviktit të vajzave ku ka  
25 qëndruar Zona Operative e Pashtrikut e Ushtrisë Çlirimtare të

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Pace [Vazhdim]

Faqe 35

1 Kosovës. Unë edhe Isuf Krasniqi jemi në fotografi,  
2 përkatësisht shefi i zbulimit.

3 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

4 PY. Shkojmë më poshtë. Këtu keni identifikuar nga e majta në  
5 të djathtë veten, doktor Haki Gashin dhe Nezir Kryeziun. A ju  
6 kujtohet kur dhe ku është bërë kjo fotografi?

7 PË. Kam qenë i qartë që nuk më kujtohet kur, po sigurisht ka  
8 qenë ndonjë mbrëmje me festime apo ndonjë ditë festive, sepse  
9 me Haki Gashin, zakonisht, me doktor Haki Gashi njeri shumë të  
10 respektuar, takoheshim më shumë nëpër këto evenimente festive.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë  
12 pranimin e këtij dokumenti i cili besoj se ka pesë faqe.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
14 kundërshtime?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
17 kundërshtime. Materiali me numër SPOE00361052 deri në 361056  
18 pranohet.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marri  
20 numrin e provës P01865 dhe është i klasifikuar si  
21 konfidencial.

22 Z. PACE: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si dokument  
23 publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
25 Riklasifikojeni.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. PACE: [Përkthim] Dua të hiqet ky dokument nga ekrani  
3 dhe të shohim një dokument tjetër për pyetjet e mira.

4 Materiali mban numrin SITF0069370 deri në SITF006930715 [Sipas  
5 përkthimit] dhe do të fillojmë me faqen 370 përbri faqen 373  
6 nga i njëjti dokument, ç'ka do të thotë se është dhe shqip  
7 edhe në anglisht. Faleminderit. Zvogëlojmë të dyja faqet që  
8 t'i shohim të plota.

9 PY. Dëshmitar, në të majtë dokumenti është anglisht që është  
10 përkthimi i shqipes, në fakt. Ju lutem lexojeni me vete. Ju  
11 lutem për shpejt.

12 Z. PACE: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen tjetër.

13 PY. Dëshmitar, kjo është faqja e dytë e të njëjtit dokument.

14 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem ta zvogëlojmë që ta shohim  
15 faqen të plotë dhe kalojmë në faqen e fundit për të dyja  
16 dokumentet.

17 PY. Dëshmitar, në fund, në të djathtë të dokumentit në shqip,  
18 shohim një nënshkrim poshtë emrit tuaj. A është ky nënshkrimi  
19 juaj?

20 PË. Po, ky është nënshkrimi jem.

21 PY. Në faqen e parë përmendet data 3 mars 2000 dhe është një  
22 dokument që është çuar komandës së Zonës së 2-të të Mbrojtjes.

23 A mund të na thoni si e ka pasur emrin komanda asokohe?

24 Komandanti, më falni.

25 PY. Dokumenti daton me 3 shkurt të vitit 2000, e jo 3 mars.

1 Në atë kohë komandant i Zonës së 2-të Mbrojtëse në Prizren ka  
2 qenë gjeneral Sali Veseli.

3 PY. Ju kërkoj ndjesë, keni të drejtë për datën. Tani shihni  
4 faqet që keni përpara.

5 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës ta  
6 zmadhojë pak paragrafin e tretë. Paragrafi që fillon me fjalët  
7 "Kur dihet se ...".

8 PY. Dëshmitar, ju na thatë që nënshkrimi është i juaji, a  
9 mund të themi që dhe ju e keni -- jeni ju personi që e keni  
10 përpiluar këtë dokument?

11 PË. Po, unë e kam përpiluar.

12 PY. Këtu lexojmë si në vijim:

13 "Kur dihet se 'Qeveria e Bukoshit' ka qenë për neve  
14 tradhëtare ..."

15 Dëshmitar, pse e keni përshtuar Qeverinë e Bukoshit si  
16 qeveri tradhtare në këtë dokument?

17 PË. Pra ky është opinionimi im i asaj kohës edhe sot mendoj  
18 prapë njëjtë sepse ne, të gjithë ushtarët e Ushtrisë  
19 Çlirimtare të Kosovës, ishim të lënë anësh në kohën më të  
20 rrezikshme për ne edhe për popullin nga e gjithë qeveria e  
21 Kosovës e cila nuk mirrej prej së jashti, prej jashtë me asnjë  
22 problem që kishte populli, me asnjë problem që kishim neve si  
23 ushtarë, e me asnjë problem që kishte Kosova. Prandaj, kjo  
24 është prapë po them, opinionimi im që e kam menduar ashtu,  
25 duke u bazuar në mospunën, në mos -- në mosgadishmërinë për të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 38

1 punuar secili punën e vet. Mendoj se kryeministri Bukoshi nuk  
2 e ka kryer punën e vet me të gjitha ato mundësi që i ka dhënë  
3 posti apo që ja ka dhënë populli duke e zgjedhur.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin  
5 e këtij dokumenti.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
8 kundërshtime.

9 Dokumenti me numër SITF0069370 deri në SITF00069375  
10 pranohet në shqip dhe në anglisht.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë  
12 numrin e provës P01866 dhe klasifikimi është konfidencial.

13 Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

14 Dhe nuk kam më pyetje për dëshmitarin për momentin.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

16 Riklasifikojeni.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

19 Tavakoli.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, do të fillojë z. Dixon.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'më kishte  
22 thënë njeri.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Bëmë një ndryshim të radhës së  
24 pyetjeve.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 39

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Z. Qadraku, unë quhem Rodney Dixon. Unë do t'ju bëj disa  
3 pyetje në emër të z. Kadri Veseli.

4 Z. Qadraku, do të doja të kthehemi pas në kohë dhe të  
5 fokusohemi në fillimin e luftës në mars, prill, maj 1998. A  
6 është e vërtetë se në fshatin tuaj Rodec - shqiptimi sipas  
7 avokatit -, ju është kërkuar fillimisht të jeni komandant i  
8 fshatit tuaj, për fshatin tuaj pra, por ju refuzuat ta bënit  
9 këtë, kështu?

10 PË. Po, zotëri.

11 PY. Dhe ju u ofruat që të ishit përgjegjës që të kalonit  
12 kufirin, të shkonit në Shqipëri, të merrnit armë atje dhe t'i  
13 kthenit në zonën e territorit -- në territorin e Hasit ku dhe  
14 qëndronit ju, kështu?

15 PË. Mendoj se unë si njeri nuk kam qenë i përshtatshëm që të  
16 jem komandant edhe atëherë e kam refuzuar atë. Mendoj roli im  
17 ka qenë më mirë të jem një ushtar i thjeshtë duke ndihmuar  
18 ushrinë me forma të ndryshme. Pra, është ashtu si e thoni ju.  
19 Pajtohem.

20 PY. Faleminderit. Domethënë, juve vetë vullnetarisht e morët  
21 këtë rol që të kalonit kufirin dhe ju thatë që keni shkuar  
22 disa herë, 36 herë gjithsej, për të marrë armë? Kështu është,  
23 Dëshmitar?

24 PË. Për atë periudhë të fillimit të luftës ishte më e  
25 domosdoshme ishte armatimi i radhëve të UÇK-së sesa çdo veprim

1 tjetër, kështu që unë mendoja se aty mund ta jap kontributin  
2 tim më mirë dhe më shumë duke edhe pse ishte shumë e  
3 rrezikshme sepse kalimi përmes kufirit Kosovë-Shqipëri ishte  
4 sikur të kalojë për skaj një gjarpri. Ai mund të mos të të  
5 kafshojë një herë, por një herë do të kafshojë. Ishte e  
6 rrezikshme. Unë e pranova atë, vetvedit i dhashë atë detyrë.  
7 PY. Faleminderit për hollësitë e dhëna. Megjithatë më lejoni  
8 të them që kam shumë pyetje për ju, kështu do ju kërkoja që  
9 thjesht t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëj unë. Përqendrohuni  
10 tek pyetjet dhe jepini përgjigje vetëm pyetjeve. Megjithatë,  
11 në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër që unë dua të kem informacion  
12 prej jush do ju bëj pyetje të tjera.

13 A e kuptoni këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 PY. Është e drejtë të thuhet apo jo, që kur ju nuk dëshironit  
16 të merrnit pozitën e komandantit në zonën tuja, ju propozuat  
17 një anëtar të familjes tuaj ose një kushëririn tuaj që të  
18 bëhej komandant. A ka ndodhur kështu?

19 PË. Po, zotëri. Kështu ka ndodh.

20 PY. Në atë kohë dhe e kam fjalën këtu marsin, prillin, majin,  
21 në atë kohë ju nuk keni marrë urdhra nga askush për ta bërë  
22 këtë gjë. Thjesht këto ishin hapa që ju i keni marrë me nismën  
23 ose iniciativën tuaj në fshatin nga ku ishit. A është e  
24 vërtetë kjo?

25 PË. Po, zotëri.



1 PY. Ju e dini që asokohe e njëjta gjë ka ndodhur edhe në  
2 fshatra të tjera përreth fshatit tuaj, domethënë që kishte  
3 njerëz që merrnin nismën që të krijonin struktura fillestare  
4 komanduese në mënyrë të tillë që të përpiqeshin që të mbronin  
5 fshatrat e tyre. A është e vërtetë kjo, a ka ndodhur kështu,  
6 Dëshmitar?

7 PË. Po, zotëri. Kështu ka ndodhur, e gjitha ka ndodhur në  
8 baza vullnetare.

9 PY. Fshatrat nuk është se kanë marrë ndonjë urdhër prej  
10 dikund për të krijuar strukturat e tyre, por strukturat i kanë  
11 krijuar me vullnetin dhe me vendimin e tyre. A është e drejtë  
12 kjo?

13 PË. Po, zotëri. Është e drejtë.

14 PY. Ata duhet ta bënë këtë gjë sepse duhej që të  
15 vetëmbroheshin nga sulmet e mundshme të forcave serbe. A është  
16 e saktë kjo?

17 PË. Edhe kjo është e saktë.

18 PY. Në këtë kohë, z. Qadraku, a është e saktë që nuk ka pasur  
19 ndonjë koordinim ose një komandë të centralizuar në regjionin  
20 tuaj për të bërë koordinimin e fshatrave të ndryshe, por  
21 fshatrat në fakt po funksiononin vetë, drejtonin fshatin vetë  
22 duke bërë më të mirën që mundeshin ato. A është një vlerësim i  
23 drejtë i situatës ky që sapo ju përshkrova?

24 PË. Po. Unë e mendoj se secili fshat, secila kompani nëpër  
25 ato fshatra e ka pas një autonomi të veprimit të veprorë në

1 bazë të rrethanave dhe rreziqeve të caktuara.

2 PY. Më herët ju thatë që kalimet e kufirit i keni bërë besoj  
3 deri nga gushti i vitit 1998, apo jo, Dëshmitar? Deri në këto  
4 kohë keni bërë kalimet e kufirit, kështu?

5 PË. Kalimet e kufirit i kam bërë deri në, deri me 7 janar kur  
6 kam ardh për herë të fundit nga Shqipëria e që ishte hera e  
7 35-të. Gushti nuk ka qenë hera e fundit. Ishte e vetmja herë  
8 kur kam ra në pritë, por jo hera e fundit që kam hy nga  
9 Shqipëria.

10 PY. Faleminderit për sqarimin. Për të qenë të qartë  
11 plotësisht, në mars, në prill, maj, qershor, korrik, gusht ju  
12 e keni kaluar disa herë kufirin në drejtim në Shqipërisë dhe  
13 nga Shqipëria më pas jeni kthyer me armë. Ky ka qenë roli  
14 kryesor i juaj gjatë kësaj periudhe ose këtyre muajve, apo jo,  
15 Dëshmitar?

16 PË. Po, zotëri, ky ka qenë roli im.

17 PY. Ju nuk keni kryer asnjë lloj funksioni zbulimi gjatë  
18 kësaj periudhe, apo gjatë këtyre muajve. A është e saktë kjo,  
19 Dëshmitar?

20 PË. Po, është shumë e saktë.

21 PY. Kjo ka ndodhur më pas, dhe këtë temë do ta trajtoj kur të  
22 vijë momenti. Megjithatë, për momentin dua që të përqendrohemi  
23 tek periudha e parë. Gjatë këtyre muajve është e vërtetë apo  
24 jo, që ju nuk keni pasur kontakte me Shtabin e Përgjithshëm të  
25 UÇK-së? A është kështu, është e saktë kjo?

1 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë. A mund të sqarojë  
2 avokati për cilën periudhë bëhet fjalë ose për cilët muaj  
3 bëhej fjalë?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Mendoj që ishte e qartë. Po flasim  
5 për muajt mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, kur -- të  
6 1998, kur dëshmitari ka kaluar disa herë kufirin.

7 PY. Atëherë, Dëshmitar, gjatë kësaj periudhe, ju nuk keni  
8 pasur kontakte me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. A është e  
9 saktë kjo?

10 PË. Po, zotëri, kjo është e saktë. Unë nuk kam pasur kontakte  
11 me Shtabin e Përgjithshëm, pavarësisht se në ato turnet e mia  
12 që kam mbajtur edhe ardhur në Shqipëri, e ardhur nga Shqipëria  
13 në Kosovë, ka mund në mesin e ushtarëve të ketë pjesëtarë të  
14 Shtabit të Përgjithshëm, po që unë atëherë edhe nuk i kam  
15 njoft.

16 PY. Është e saktë, apo jo, që ju nuk e dini se kush ishin  
17 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë? Domethënë e  
18 kam fjalën për të njëjtën periudhë që e përmenda pak më herët.  
19 A është e saktë kjo?

20 PË. Të vetmin kontakt që e kam pasur në mars kur kam shkuar  
21 në Likovc e dija se 10-shi është pjesë e Shtabit të  
22 Përgjithshëm. Nuk e dija që ishte Rexhep Selimi.

23 PY. Ju z. Kadri Veseli në atë kohë nuk e keni njohur,  
24 Dëshmitar, apo jo? Nuk e keni dituar as çfarë roli ka luajtur  
25 ai. A është e saktë kjo?

1 PË. Jo, zotëri.

2 PY. Ju nuk keni pasur asnjë kontakt me të përpara luftës as  
3 në Zvicër kur keni qenë. A është e saktë kjo?

4 PË. Po, zotëri, është shumë e saktë. Do të isha shumë krenar  
5 po t'i njihja. Por nuk e kam njoftur Kadri Veselin para luftës  
6 në Zvicër sa kam qëndruar.

7 PY. Faleminderit. Në fakt, hera e parë kur e keni parë z.  
8 Veseli ka qenë me datën 16 nëntor 1998, kur po udhëtonit në  
9 drejtim të Shqipërisë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Ndoshta mund të jetë e saktë edhe kjo. Nuk e di, nuk e di  
11 kohën kur e kam njohur për vërtetë, por është e saktë kjo që  
12 për të qëndru për të bisedu me të sy me sy, është hera e parë  
13 16 nëntori i vitit 1998.

14 PY. Në rregull. Do i kthehem përsëri takimit të parë që keni  
15 pasur me të. Megjithatë, dua t'ju bëj këtë pyetje tani:

16 Përpara kësaj radhe ose përpara sesa të takoheshit, dhe e kam  
17 fjalën këtu për periudhën korrik, gusht, shtator, kjo ishte  
18 një periudhë e karakterizuar nga luftime intensive me forcat  
19 serbe në zonën tuaj? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PY. Po, është shumë e saktë kjo. Kemi pas ofensiva shumë të  
21 mëdha.

22 PY. Strukturat e UÇK-së që ekzistonin në atë periudhë kanë  
23 qenë tërësisht të vogla në numër, në kuptimin që nuk kanë qenë  
24 të konsoliduara. A është një përshkrim i saktë i asaj çfarë ka  
25 ndodhur në ato muaj, Dëshmitar?

1 PË. Po. Njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në ato  
2 fillime kanë qenë të vogla, sidomos me armatim, sidomos me  
3 armatim, se s'kishim armë për të gjithë. Por qëndron fakti se  
4 kemi qenë numerikisht shumë të vegjël.

5 PY. A është e drejtë të thuhet që forcat serbe ishin më të  
6 forta sesa ju në atë periudhë? A është e drejtë të thuhet kjo  
7 se ju keni qenë i pranishëm aty vetë, Dëshmitar?

8 PË. Gjithmonë. Edhe në mars, edhe në përfundim të luftës,  
9 edhe deri në përfundim forcat serbe kanë qenë numerikisht edhe  
10 me njerëz edhe me armatime kanë qenë më superior shumë herë se  
11 na.

12 PY. Po përqendrohem në periudhën nga korriku, gushti,  
13 shtatori tani. A është e saktë që ofensivat serbe në këtë  
14 periudhe kohe në regjionin tuaj, në zonën tuaj i kanë  
15 shkaktuar UÇK-së shkatërrimin e strukturave tuaja ose e kanë  
16 shkaktuar shpërndarjen e ushtarëve si rezultat i luftimeve? A  
17 do ishte e drejtë që të bëhej ky vlerësim për situatën  
18 atëherë, Dëshmitar?

19 PË. Po, zotëri avokat.

20 PY. Në fshatin tuaj, a ju kujtohet se sa ushtarë mbetën në  
21 këtë fshat, pra në fshatin tuaj në atë periudhë? Domethënë,  
22 besoj që ka qenë një numër i vogël se pjesa më e madhe e  
23 ushtarë do jenë larguar ose do kenë shkuar diku tjetër, do  
24 jenë shpërndarë? A mund të na thoni sa ushtarë kanë mbetur në  
25 fshatin tuaj gjatë kësaj periudhe?

1 PË. Ato ditë i kujtoj si shumë të rënda për mua, mbaj mend që  
2 me 3 shtator në ofensivën e shtatorit nga i gjithë njësitë që  
3 ka qenë në fshatin tim kemi mbetur ndoshta katër deri në pesë  
4 persona.

5 PY. Faleminderit. Tani do të flasim për udhëtimin në drejtim  
6 të Shqipërisë me datë 16 nëntor 1998 që ju e cekët pak më  
7 herët. Ju e keni përshkruar këtë në një nivel të caktuar  
8 hollësie në Shënimin Përgatitor numër 1, në paragrafin 12, për  
9 ata që na ndjekin. Unë do ta marr sipas rendit atë çfarë ka  
10 ndodhur.

11 Është e saktë apo jo, Dëshmitar, që ju keni qenë si  
12 koordinator, keni shërbyer në rolin e koordinatorit për  
13 lëvizjet drejt Shqipërisë edhe nga Shqipëria sepse e njihnit  
14 mirë zonën e kufirin edhe i ndihmonit njerëzit që të kalonin  
15 kufirin për në Shqipëri në qoftë se kjo ishte e nevojshme? A  
16 është një përshkrim i saktë ky, Dëshmitar?

17 PË. Unë nuk mund ta quaj veten koordinator, por meqë ishim të  
18 organizuar me ata shokë, kam qenë pjesë e atyre shokëve që  
19 kanë qenë përgjegjës për vajte-ardhje, [E pakuptueshme], por  
20 jo me emërtim koordinator, nuk kam qenë kurrë. Po jam  
21 koordinuar me ta, kam bashkëpunuar me ta, i kam njohur të  
22 gjithë ata që ishin përgjegjës në zonën e Hasit.

23 PY. Në rregull. Ju keni dëgjuar z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri  
24 Veseli dhe persona të tjerë po udhëtonin në drejtim të  
25 Shqipërisë. A është e drejtë të thuhet që juve përfituat nga

1 rasti që të bashkoheshit me këtë grup sepse dëshironit që t'i  
2 jepnit ca informacion që ishte kërkuar nga z. Xheladin Gashi?  
3 A ka ndodhur kështu, Dëshmitar?

4 PË. Po. Gjatë ardhjeve dhe vajtjeve të disa shokëve, Plaku,  
5 domethënë, Xheladin Gashi na kishte kërkuar neve që ishim  
6 pranë kufirit që t'ja vizatojmë sa më saktë vendqëndrimet e  
7 pozicioneve serbe që ruanin kufirin në bjeshkën e Pashtrikut.

8 PY. Përmes këtij udhëtimi juve përfituat nga rasti që të  
9 bashkoheshit me ta dhe t'ja jepnit këtë informacion atij në  
10 shqip -- në Shqipëri, më falni. A është e saktë kjo? Domethënë  
11 informacionin e keni dhënë në Shqipëri? A ka ndodhur kështu?

12 PË. Po, zotëri avokat. Ne atë ditë, ja kam shpjeguar edhe  
13 Prokurorisë me 16 nëntor, pse e mbaj mend këtë datë se  
14 zakonisht datat mbahen mend ose për ndonjë ngjare ose për  
15 ndonjë eveniment, ne atë ditë kishim bërë një sulm ndaj  
16 policisë së Rahovecit me disa shokë dhe kur kthyem në fshatrat  
17 ku ne qëndronim, morëm vesht se kishin ardhur disa shokë nga  
18 Shtabi i Përgjithshëm që do të shkonin për në Shqipëri.

19 Atëherë deshtëm edhe na të shkojmë aty, të bisedojmë me ta  
20 t'ju tregojmë se edhe ne do kemi nevojë të shkojmë që t'i  
21 dërgojmë Xheladin Gashin informacionin që na kishte kërkuar.

22 PY. Po. Pra, ju të gjithë keni udhëtuar së bashku. Ju thatë  
23 që ju është dashur një natë për të ecur në këmbë për të shkuar  
24 në Cahan, për të mbërritur në Cahan që është në Shqipëri. A ka  
25 ndodhur kështu? A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, zotëri avokat, kështu ka ndodhur.

2 PY. Në atë pikë, është e saktë apo jo, që z. Thaçi dhe z.  
3 Veseli, ata vazhduan rrugën e tyre prej asaj pike, ndërkohë që  
4 ju vazhduat në rrugën tjetër, në rrugën tuaj në drejtim të  
5 Kukësit ku u takuat me komandant Drinin për herë të parë? A ka  
6 ndodhur kështu? A e kujtoni që ngjarja të jetë shpalosur në  
7 këtë mënyrë, Dëshmitar?

8 PË. Zotëri Gjykatës, kur hyni në Shqipëri, stacioni i parë  
9 është Cahani. Në Cahan ishte Xheladin Gashi, Plaku. Unë aty  
10 kam ndaluar që të bisedoj me Plakun, përkatësisht me Xheladin  
11 Gashin. Kurse të gjithë këta pjesëtarët e tjerë as kam guxuar  
12 t'i pyes kah shkojnë, as nuk e di kah kanë shkuar, po unë për  
13 vete e di që unë jam ndal në Cahan bashkë me Nexhmedin  
14 Berishën për t'i treguar informacionet e duhura për çfarë na  
15 kishte thirrur ai.

16 Takimi me Drinin sigurisht që ka ndodhur mbase dy apo tri  
17 dite mbasi kam zbritur në Kukës.

18 PY. Por, ti vetë shkove në Kukës për t'u takuar me z. Drini,  
19 dhe keni thënë që kjo ka ndodhur dy ose tri ditë më pas. Ku ka  
20 ndodhur, ku ka ndodhur ky takimi i parë? Në çfarë vendi?

21 PË. Unë nuk e kam ditur as që është Drini aty. Unë nuk e kam  
22 njoftur komandant Drinin. Unë kam shkuar të takoj ushtarë nga  
23 Kosova që qëndronin në Kukës, në Krumë. Kisha dëshirë t'i  
24 takoja, t'ju tregoja për riorganizimin që po mundohemi ta  
25 bëjmë në Kosovë. Unë nuk kam shkuar aty enkas për ta takuar



1 dikë me emër e mbiemër. Mirëpo, kur kam shkuar aty njihnja  
2 Sylë Kovaçin, pronarin e atij lokalit, edhe ashtu na prezantoi  
3 kush jemi, tek jemi ne. Gjatë bisedimeve ndoshta kam shkuar  
4 për çdo ditë, për tri ditë e pas tri, katër ditësh Drini më ka  
5 lajmëruar, më ka treguar se më ka përzgjedhur për një post  
6 çfarë e mora pastaj, por në atë kohë as nuk e dija çfarë  
7 është, as nuk kam pas ambicie që të jem për një post të tillë.  
8 Kështu ka ndodhur rasti.

9 PY. Z. Drini, ju kërkoi ju që të bëheshit drejtuesi ose shefi  
10 i ZKZ-së, ose G-2-shit, në zonën e Pashtrikut. Për këtë e keni  
11 fjalën, Dëshmitar?

12 PË. Po, zotëri avokat. Për këtë e kam fjalën.

13 PY. Dhe ju keni thënë - për procesverbal e keni thënë në  
14 Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 12 - që për ju ishte e  
15 papritur kjo, sepse nuk e dinit se çfarë përfshinte ajo  
16 pozitë. Ça keni dasht të thoni që për ju ishte e papritur,  
17 ishte kështu si lajm i madh, a mund të na e shpjegoni çfarë  
18 donit të thonit me këtë?

19 PY. Unë për vete kur më tha ai që do të jam i zgjedhur nga ai  
20 për këtë, unë isha i befasuar sepse as nuk kam -- nuk kisha  
21 njohuri për këtë sektor çfarë duhet të bëj. Isha mësuar të jem  
22 një ushtar i thjeshtë, një ushtar i përgjegjshëm, një ushtar  
23 punëtor, një ushtar që më shumë punonte fizikisht sesa në  
24 mënyrë të fshehtë, se kjo -- ai thoshte që është shërbimi i  
25 fshehtë, shërbim [E pakuptueshme], kështu që isha i befasuar

1 se nuk kam pas kurrfarë dijenie, dijeni për këtë sektor dhe  
2 për këtë lami.

3 PY. Ju më përpara nuk është se kishit bërë asnjëherë punë  
4 zbulimi, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Unë kurrë nuk kam punuar në punë zbulimi.

6 PY. Për ta sqaruar elementin e kohës, ju e keni diskutuar  
7 këtë me z. Drini për disa ditë, apo jo, përpara sesa në fund  
8 vendosët që ta merrnit përsipër këtë pozicion mbështetur në  
9 kërkesën që ju kishte bërë ai ju. A ka ndodhur kështu,  
10 Dëshmitar?

11 PË. Po, kështu ka ndodhur, sepse unë vazhdimisht e kam  
12 refuzuar këtë, kam refuzuar sepse kam menduar se nuk jam i  
13 përgjegjshëm, nuk jam personi adekuat që mund ta drejtojë këtë  
14 sektor. Nuk di pse më kishte zgjedhur. Mirëpo pas insistimit  
15 dhe pas këshillimit të tij se na duhet një njeri që kemi  
16 besueshmëri më të madhe që ka energji të mjaftueshme për të --  
17 ma mbushi mendjen. Ma mbushi mendjen dhe unë pranova për hir  
18 të çështjes, e jo për hir timin si person, jo nga ambicia ime.

19 PY. Ju z. Drini nuk e kishit takuar më përpara sikurse na e  
20 keni shpjeguar disa herë. Por, nga momenti që e takuat e  
21 takuat për disa ditë. A ndërtuat ndonjë lloj besimi me të  
22 gjatë ditëve, gjatë kësaj periudhe, gjatë ditëve kur keni  
23 diskutuar me të përpara sesa të ktheheshit në Kosovë?

24 PË. Ato ditët e para kur u njofta unë me të, ai më prezantoi  
25 edhe më tregoi vetë se ishte i përzgjedhur si komandant i

1 zonës operative të Pashtrikut, që do të jetë kur të hyjë në  
2 Kosovë. Mandej e kam pyetur edhe kam shkuar te Plaku,  
3 natyrisht, gjatë këtyne tri-katër ditëve, e kam pyetur edhe  
4 Plakun, "A është e vërtetë kështu që thotë Drini". Edhe ai më  
5 ka thënë që "Po, është e vërtetë se Drini është zgjedhur për  
6 komandant". Domethënë, e kishte atë peshën, e kishte mundësinë  
7 ta përzgjidhte stafin e tij.

8 Atëherë unë domethënë e kam njoft Drinin, atëherë e kam  
9 dit që për ç'ka është përzgjedhur, si do të hyjë në Kosovë  
10 edhe pse më kërkon mua për shef të një sektorit për mua të  
11 panjohur.

12 PY. Ky emërimi që bëri ai nuk ka qenë emërim i bërë nga  
13 Shtabi i Përgjithshëm, apo jo, domethënë, është thjesht një  
14 emërim i bërë prej tij atje kur ju jeni takuar me të. A është  
15 e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Mua në nëntor Drini më ka përzgjedhur, përzgjedhur për  
17 këtë sektor. Kurse emërimin, emërimin me letër e kam marrë me  
18 8 janar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, z. Bislum Zyrapi.

19 PY. A është diçka që e keni marrë me shkrim? Domethënë këtë  
20 emërimin tuaj e keni marrë me shkrim apo jo, Dëshmitar?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e ka  
22 thënë, në fakt, sapo e tha dëshmitari këtë gjë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] A mund ta konfirmoj edhe një herë?

24 PY. A e keni marrë me shkrim këtë, Dëshmitar?

25 PË. Emërimin me shkrim e kam marrë nga shefi i Shtabit të

1 Përgjithshëm, Bislam Zyrapi me 8 janar. Propozimin për  
2 emërimin tim e kam marrë nga Drini në nëntor të vitit 1998.  
3 PY. Sa i takon këtij propozimi të bërë nga z. Drini, z. Kadri  
4 Veseli nuk ka pasur asnjë lloj lidhjeje, nuk ka pas asnjë  
5 lidhje me atë proces ose me atë diskutim që ka bërë Drini me  
6 ju, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Jo, zotëri, unë nuk e kam ditur për këtë sektor. Nuk e  
8 kam ditur që ekziston ky sektor. Ai më ka thënë, komandant  
9 Drini më ka thënë që jemi duke e formuar për herë të parë  
10 zonën, e zona duhet ta ketë këtë sektor, domethënë, të gjitha  
11 ishin duke u formuar për herë të parë.

12 PY. Për të qenë të qartë deri në fund. Z. Veseli nuk ka qenë  
13 i përfshirë në asnjë lloj forme në këto biseda me komandant  
14 Drinin dhe ju lidhur me emërimin tuaj në sektorin e G2-shit? A  
15 është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Nga pjesa ime, unë kurrë nuk e kam parë Kadri Veselin të  
17 flet për mua me mua. Domethënë, nuk ka qenë, nuk ka qenë Kadri  
18 Veseli ai që më ka përzgjedhë ose mu nuk më ka thënë Drini  
19 diçka më tutje përpos që ai personalisht më ka përzgjedhur  
20 duke u bazuar në fjalët e shumë ushtarëve aty përreth që më  
21 njihnin gjatë shkuarjeve e ardhjeve të mia në Shqipëri e  
22 Kosovë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
24 pushimin e paradites tani.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do bëjmë  
2 pushim për 30 minuta. Do kthehemi përsëri në sallë për 30  
3 minuta.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DO bëjmë  
6 pushim deri në orën 11.30.

7 --- Pauza fillon në orën 11.03

8 --- Seanca rifillon në orën 13.31

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
10 sillni dëshmitarin në sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
13 Dëshmitar. Z. Dixon ka ende pyetje për ju.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Z. Qadraku, dua t'ju bëj një pyetje për paragrafin 12 të  
16 Shënimit Përgatitor numër 1. Unë po e lexoj çfarë keni thënë,  
17 dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje. Këtu thuhet se:

18 "Kur keni pyetur çfarë ishte ZKZ-ja apo G2" - kur e keni  
19 pyetur Drinin pra, "Drini të është përgjigjur dhe të ka thënë  
20 që është diçka e ngjashme me SHIK-un. Por SHIK-u ishte akronim  
21 më i njohur asokohe dhe se mblidhte informacione të zbulimit.  
22 Drini të ka thënë është njësoj si zbulimi dhe kundërzbulimi në  
23 vendet lindore, dhe i ngjashëm me SHIK-un në Shqipëri. Por, që  
24 deri në fund të luftës ju nuk keni bërë dallim mes G2, ZKZ-së  
25 edhe SHIK-ut."

1 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

2 PË. Po, zotëri. Më kujtohet. Më kujtohet sepse komandant  
3 Drini në nëntorin e vitit 1998 kur më ka propozue edhe kur më  
4 ka tregue për çfarë jam përzgjedhur, ai më ka thënë se "Do të  
5 jesh shefi i G2". Unë kurrë deri atëherë nuk e kisha dëgjuar  
6 emërtimin G2. Nuk e di as çfarë është G2. Atëherë, e kam  
7 pyetur, "Më fal, çfarë është kjo G2?" Atëherë ai më ka thënë  
8 si në ushtritë lindore që është zbulim-kundërzbulim ose si te  
9 ne në Shqipëri që e njohim SHIK-u, Shërbimi Informativ  
10 Kombëtar. Domethënë, ai të trija këto, të gjitha këto m'i ka  
11 thënë duke nënkuptuar atë për çka më kishte përzgjedhur mua.

12 Është e vërtetë që unë atë ditë, ato ditë për herë të  
13 parë kam dëgjuar për këto emërtime dhe deri në përfundim të  
14 luftës, nuk kam dit dallimin ta bëj mes G2, mes zbulim-  
15 kundërzbulimit edhe mes SHIK-ut si akronime.

16 PY. Pra, është e vërtetë, pra, që gjatë luftës këto termat i  
17 përdornit në mënyrë të shkëmbyeshme me njëri-tjetrën, për të  
18 përshkruar rolin tuaj në zbulim e kundërzbulim. Pra, përdornit  
19 herë njërin, herë tjetrin, pa bërë dallim, kështu?

20 PË. Është e vërtetë. Unë gjithmonë kam menduar se vetë emri  
21 im mjaftueshëm tregon se kush po raporton apo kush po njofton  
22 apo kush po propozon, kurse akronimet para emrit tim a është  
23 shefi i SHIK-ut, a është shefi i G2, a është shefi i ZKZ-së?  
24 pak më parë e kishim një dokument nga Prokuroria ku ishte,  
25 isha i nënshkruar poshtë, shefi i DI-së, i Departamentit

1 informativ. Sepse pas luftës na kanë quajtur edhe Departament  
2 Informativ.

3 Kështu që gjithmonë kam menduar se është e njëjta gjë,  
4 dhe gjithmonë jam nënshkruar për të njëjtën gjë pa ditur  
5 dallimet mes këtyre tre akronimeve.

6 PY. Faleminderit. Përdorimi i termit SHIK është një term që  
7 ka ardhur nga komandant Drini, apo jo? I cili ju ka shpjeguar  
8 ju dhe ju ka thënë që ky term është një term që përdoret për  
9 grumbullimin e informacioneve që lidhen me zbulimin, apo jo?  
10 Është ai që e ka thënë për herë të parë, kështu?

11 PË. Po, zoti avokat, ashtu ka qenë. Nga ai kam dëgjuar për,  
12 kur bëhej fjalë për mua, se është sikur SHIK-u apo sikur  
13 zbulim-kundërzbulimi. Domethënë nga ai e kam dëgjuar për herë  
14 të parë.

15 PY. A është e vërtetë që pas luftës ke kuptuar dallimin mes  
16 ZKZ-së dhe SHIK-ut? Pra, që ZKZ-ja referohej zbulimit  
17 ushtarak, ndërsa SHIK-u njësoj si në Shqipëri, kishte të bënte  
18 me informacione të zbulimit, por që lidhen me civilët, kështu?

19 PË. Po, zotëri, është e vërtetë. Pas luftës mendoj që kam  
20 shkuar në Shtab të Përgjithshëm, ndoshta sigurisht për takime  
21 që kishim javore me sektorët, edhe mbaj mend se Fadil Kodra,  
22 atëherë për herë të parë e njihja Fadil Kodrën, ai më ka thënë  
23 se tani këto janë të ndryshme. SHIK-u është diçka tjetër,  
24 zbulim-kundërzbulimi është diçka tjetër. Kështu që është e  
25 vërtetë që pas luftës e kam kuptuar që ato dy drejtime janë

1 krejtësisht të tjera.

2 PY. Ky Fadil Kodra që po përmendni ju, ka qenë shefi i ZKZ-së  
3 ushtarake në UÇK në atë kohë, pas luftës, apo jo?

4 PË. Po, zotëri. Fadil Kodra ka qenë shefi i zbulim-  
5 kundërzbulimit në Shtabin e Përgjithshëm, pas luftës.

6 Domethënë, ende vazhduam deri më 19 shtator të ishim ende me  
7 uniformën e UÇK-së, por edhe pas transformimit, dhe pas  
8 transformimit mendoj se Fadil Kodra ka qenë shefi i atij  
9 sektorit si TMK.

10 PY. Do flasim për një periudhë të mëvonshme në fakt, por  
11 përpara se ta bëjmë këtë dua të flasim pak për periudhën  
12 nëntor-dhjetor në 1998. Në këtë periudhë keni qenë ende në  
13 Shqipëri, në Kukës, dhe ne e dimë nga dëshmia jua se  
14 komandant Drini është larguar më 14 dhjetor të 1998.

15 A ju dha ndonjë udhëzim përpara se të largohej, se çfarë  
16 detyrash duhet të kryenit ju në fushën e zbulimit në zonë?

17 PË. Po, zotëri avokat. Gjatë atij qëndrimit në Kukës, ku edhe  
18 ai ishte aty, deri më 14 dhjetor kur është nisur për në  
19 Kosovë, ne jemi takuar shpesh, ndoshta çdo javë, ndoshta çdo  
20 tri-katër ditë, dhe ai më ka shpjeguar në atë kohë, është  
21 munduar në shpejtësi të më tregojë detyrat për çfarë unë duhet  
22 të përgatitem, për çfarë unë duhet të lexoj, për çfarë unë  
23 duhet të kem njohuri, për çfarë duhet të bëj kur të shkojmë në  
24 Kosovë. Domethënë, disa gjëra më kujtohen që m'i ka treguar  
25 nga vetë dëshira e tij, nga njohuritë e tij që kishte, sepse



1 ishte një oficer karriere.

2 PY. Ai ju dha edhe literaturë apo jo, që të lexonit lidhur me  
3 çështjet e zbulimit? Cilat ishin këto libra, çfarë literature  
4 ishte kjo?

5 PË. Nga komandant Drini unë nuk kam marrë ndonjë literaturë.  
6 Mirëpo gjatë qëndrimit të tij aty në Kukës, edhe timit, ne  
7 jemi takuar me kolonel Maliq Doçin, të cilit unë edhe në  
8 prezencën e Drinit edhe vetë meqë e njihja më herët, i kam  
9 kërkuar që të më ndihmojë në këtë drejtim për të më furnizuar  
10 me diçka që të lexoj për këtë sektor që të kem ma shumë  
11 njohuri që të jem më i përgatitur që të di si të veprojmë sepse  
12 për mua ishte diçka që kurrë nuk e kisha kryer këtë detyrë.

13 Në këtë aspekt, më shumë, më shumë them, më ka ndihmuar  
14 kolonel Maliq Doçi, oficer me karrierë nga Shqipëria, i cili  
15 ka qenë edhe më vonë edhe pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të  
16 Kosovës, gjatë operacionit Shigjeta, simbas dëgjimit që kam  
17 dëgjuar më vonë.

18 PY. Pra, keni qenë i lidhur me kolonel Doçin, që ishte nga  
19 ushtria shqiptare. Çfarë materialesh ju dhanë për të lexuar?

20 PË. Mua më kujtohet se m'i kishte dhënë disa doracakë të  
21 vegjël të ushtrisë shqiptare në lidhje me këtë, me rregullat e  
22 këtij sektori. Nuk ishte diçka speciale, nuk ishte ndonjë send  
23 studiuese, ishte diçka e shpejtë që ta kuptoja më mirë rolin e  
24 këtij sektori. Ishin në forma librash të vogla apo ndonjë  
25 intervistë apo revistë, se jo intervistë. Kështu që me kaq nuk

1 kam kaluar shumë kohë aty, nga 20 nëntori kur ka filluar kjo,  
2 me ndërprerje të shpeshta sepse kam shkuar ta vizitoj edhe atë  
3 grupin e madh që tentonte të hynte në Kosovë. Kaq. Kam pas një  
4 pjesë shumë të vogël të leximeve për këtë drejtim.

5 PY. Po. Kishit shumë, po ashtu kishit shumë pak, patët shumë  
6 pak stërvitje në Shqipëri, apo më saktë formim në Shqipëri, se  
7 si do t'i ushtronit veprimtaritë tuaja përpara se të hynit në  
8 Kosovë, kështu?

9 PË. Po, zotëri, kështu.

10 PY. Thatë që u kthyet në Kosovë më 7 janar të 1999. Kështu ka  
11 qenë?

12 PË. Po, zotëri.

13 PY. Tani dua të flasim se çfarë keni bërë pasi u kthyet. Por  
14 përpara të konfirmojmë diçka tjetër. Keni thënë se më 16  
15 nëntor keni parë Kadri Veselin. A është e vërtetë që nuk e  
16 keni parë më deri nga gjysma e dytë e marsit që mund të ketë  
17 qenë 15, 16, 17 mars të 1999? Këtë e thatë kur po ju tregonte  
18 Prokurori disa fotografi. Është e saktë kjo nga pikëpamja  
19 kohore?

20 PË. Po, zotëri, kjo është shumë e saktë. Unë nga 16 nëntori e  
21 deri më mars, unë nuk më kujtohet, nuk e kam parë Kadri  
22 Veselin, apo të tjerët.

23 PY. Në atë kohë ju nuk keni pasur asnjë kontakt me atë, apo  
24 jo?

25 PË. Jo, zotëri, unë nuk kam pas asnjë kontakt me të.

1 PY. Nuk keni marrë ndonjë urdhër prej tij në atë kohë, dhe as  
2 nuk i keni raportuar në atë kohë, kështu?

3 PË. Kurrë. Domethënë, gjatë krejt veprimtarisë time, nga 8  
4 janari e deri në atë kohë kur e kam lënë këtë detyrë më 20  
5 prill të vitit 2000, unë kurrë nuk kam pas ndonjë urdhër nga  
6 Kadri Veseli apo ndonjë urdhër nga sektori përkatës prej  
7 Shtabit të Përgjithshëm. Në dokumentet e mia do të isha shumë  
8 krenar po të kisha ndonjë urdhër nga ata, ndonjë urdhër detyre  
9 apo ndonjë urdhër veprimi, por kurrë nuk kam pasur një diçka  
10 të tillë. Gjithmonë kam vepruar me ato opinionet e mia çka kam  
11 nënkuptuar se cila rrugë është më e mira. Gjithmonë jam  
12 munduar ta propozoj, ta informoj komandantin tim, e përmes  
13 komandantit edhe ata në Shtab të Përgjithshëm çfarë po ndodh  
14 në zonën operative të Pashtrikut. Të gjitha kanë qenë me  
15 vetiniciativë, të gjitha kanë qenë opinionimi im. Të gjitha kanë  
16 qenë mendimi im se si duhet, se si duhet të veprohet, punohet  
17 në situata të caktuara me disa, me disa veprim, për mbrojtje  
18 të caktuara.

19 PY. Shumë faleminderit për këtë. Tani dua të shohim me  
20 saktësi çfarë keni bërë nga data 8 janar 1999 e në vijim që  
21 kur hytë në Kosovë. Thatë që u desh të krijonit nga zeroja  
22 sektorin tuaj të zbulimit. A ju kujtohet që keni thënë këtë?

23 PË. Po, zotëri, më kujtohet që e kam thënë këtë. Sepse kur  
24 kam marrë detyrën nga shefi i shtabit, Bislir Zyrapi, kam  
25 ardhur në zonë. Kam takuar komandant Drinin. Kam takuar

1 zëvendës komandantin që ishte Sylë Kollqaku, e që nuk u  
2 përmend më herët nga Prokurori, se më 11 mars ai  
3 zëvendëskomandant ka ikur, ne sa ishim duke festuar  
4 manifestimin e demonstratave të vitit 1981. I kam takuar të  
5 dytë edhe i kam pyetur, "A kam vartës dhe me cilin, me kënd  
6 unë duhet të punoj edhe bashkëpunoj?" Ata më kanë thënë që  
7 "Nuk ka asgjë edhe duhet të gjitha t'i krijosh vetë".

8 Edhe kështu që kam filluar nga zeroja të punoj, të  
9 bashkëpunoj me komandantët e brigadave për t'i formuar  
10 vartësit në brigada, batalione, kompani.

11 PY. Nga sa thatë ju, i takon që kur keni hy, kur keni  
12 mbërritur atje, në janar të 1999, nuk ka ekzistuar fare  
13 struktura e zbulimit në nivel zone. Pra, nuk ka pasur asgjë më  
14 përpara. Çka do të thotë se e keni krijuar ju të gjithën nga  
15 zeroja, kështu?

16 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Avokati e pyeti një herë  
17 dhe i tha që:

18 "Ju u desh ta bënit, ta krijonit sektorin nga fillimi."

19 Tani po e përsërit pyetjen.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
21 kundërshtimi.

22 Dëshmitar, mund të përgjigjeni.

23 Z. DIXON: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, ka nevojë ta përsërisim pyetjen apo e fiksuat?

25 PË. Jo, nuk kam nevojë ta përsëritni. Mendoj se do të

1 përgjigjemi. Është e vërtetë, pra, se kam filluar nga zeroja.  
2 Unë nuk kam mundur vetë t'i emëroj njerëzit nëpër brigada  
3 përkatëse sepse askënd s'kam njohur. Më është dashtur të shkoj  
4 nëpër secilën brigadë të kontaktoj me komandantët e tyre, e  
5 brigadave apo me shefat e shtabit të tyre, edhe t'i njoftoj  
6 njëherë se është krijuar një sektor në zona operative e  
7 Pashtrikut, që jam unë, që merret me zbulim-kundërzbulimin.  
8 Kështu që tani unë kërkoj nga ju si komandant që ta krijoni  
9 edhe ju në brigada e në batalione edhe në kompani të njëjtët  
10 strukturë në mënyrë që të kemi një lloj hierarkie për të cilën  
11 unë kam besuar atëherë se duhet të ketë dhe duhet të formohet.  
12 Pra, edhe ata vartësit e mi nëpër brigada i kanë emëruar,  
13 i kanë emëruar vetë komandantët e brigadave përkatëse.  
14 PY. Ju nuk kishit ndonjë rregullore për zbulimin, apo ndonjë  
15 bazë që ta trajtonte apo ta rregullonte çështjen e zbulimit në  
16 atë kohë, kështu?  
17 PË. Unë nga janari deri në përfundim të luftës, dhe kurrë nuk  
18 kam pasur ndonjë rregullore më të, më specifike nga, ose nga  
19 komandanti ose nga Shtabi i Përgjithshëm që ta dijmë se si  
20 duhet të funksionojë kjo, ky sektor. Pra, nuk kam parë, nuk  
21 kam pas rregullore të caktume për këtë sektor.  
22 PY. A është e vërtetë që ju reagonit sipas rastit. Domethënë,  
23 dilnin për herë të parë gjërat dhe po përballëshit për herë të  
24 parë me gjëra të caktuara kur morët përsipër këtë detyrë,  
25 kështu?

1 PË. Po, zotëri Gjykatës. Çdo gjë, çdo gjë me çka jem  
2 ballafaquar ka qenë hera e parë, çdo gjë që për çka unë jam  
3 munduar të raportoj komandantit tim Drinit ose Tahir Sinanit  
4 ka qenë e rastit, simbas ngjarjeve që kanë ndodhur, edhe  
5 simbas asaj që unë kam menduar se është e drejtë që ndoshta  
6 edhe nuk, ndoshta dhe kam gabuar, por unë atëherë edhe sot  
7 kam, mendoj se unë kam vepruar në mënyrën më të drejtë të  
8 mundshme që unë kam dit në atë kohë të organizoj detyrën time.

9 PY. Në sektorin tuaj, sektorin G2, keni pasur një grup  
10 relativisht të vogël personash që mund t'i kryenin këto  
11 detyra, apo jo? Ju keni thënë që ka qenë z. Çoçaj, kështu?

12 PË. Po, zotëri.

13 PY. Z. Xhavit ose Xhavit Bajraktarin, i cili u vra më 2 maj,  
14 që ka qenë në fakt pjesë e sektorit tuaj deri në këtë datë,  
15 kështu?

16 PË. Po, zotëri.

17 PY. A është e vërtetë që ky i fundit e ka mbajtur postin  
18 vetëm për disa ditë, pra nga fundi i prillit deri në 2 maj.  
19 Çka do të thotë që nuk ka qenë shumë gjatë në atë post. A ju  
20 kujtohet?

21 PË. Po, zotëri. Sepse Xhavit Bajraktarin e kishim caktuar  
22 edhe si të jetë korrespondent i Radios Kosova e Lirë, që të  
23 furnizojë me informacione nga terreni Radion Kosovën e Lirë.  
24 Kështu që besoj se qashtu ka qenë si thoni ju. Nuk e di  
25 ndoshta me datë të caktuar, por besoj që qashtu ka qenë.

1 PY. Më pas atë e zëvendësoi z. Isuf Krasniqi, kështu thatë,  
2 apo jo?

3 PË. Po, zotëri, e saktë.

4 PY. Pra, në realitet keni qenë vetëm ju të tre bashkë me z.  
5 Gashi, që ju thatë që ishte një person që ju ndihmonte. Kaq  
6 persona kishte sektori juaj, apo jo?

7 PË. Po, zotëri, ishim katër persona. Gashi është znj. Gashi,  
8 jo z. Gashi.

9 PY. Kërkojmë ndjesë, zoti, po. Ju lutem, na shpjegoni  
10 shkurtimisht që ta kuptojmë ne, si funksiononit si grup? Çka  
11 do të thotë, sa shpesh takoheshit? Si i ndanit informatat,  
12 lidhur me detyrat që kishit? Pra, çfarë bënit ju si grup?

13 PË. Unë mund ta përshkruaj me pak fjalë ato ditët e, kur ne  
14 kishim mundësi të qëndronim --

15 PY. Përmbledhje ju lutem.

16 PË. Për shembull, kishim një takim në mëngjes kur zgjoheshim  
17 edhe bisedonim se çfarë mund të bëjmë që të shkojmë të  
18 kontrollojmë, të kontrollojmë njësitet tona, brigadat tona,  
19 nëpër vende të caktuara. Të shofim çfarë ka për të, për neve  
20 interesant, a ka lëvizje të armikut, a ka ndonjë gjë që duhet  
21 të shqetësohemi. Domethënë, tërë koha na ka shku neve duke i  
22 kërkuar shkaqet të cilat ne duhet t'i dijmë, e shumë pak, e  
23 shumë pak e hiç.

24 Siç mund ta shifni edhe nga dokumentacioni që më është  
25 konfiskuar kur unë jam arrestuar në vitin 2001, unë nuk kam

1 raporte nga asnji sektor ose kisha shumë pak raporte nga  
2 sektorët e brigadave dhe të batalioneve. Të gjitha ato gjëra,  
3 të gjitha ato njohuri që ne kishim, duhej t'i shkonim vetë  
4 personalisht, ose Xhaviti, ose Neziri, ose Isuf Krasniqi, ose  
5 unë, me të tjerët, të shkojmë personalisht edhe të  
6 kontrollojmë dhe të shofim a është çdo gja mirë. Sepse  
7 mungonte ajo, mungonte ajo kultura e raportimit, mungonte ajo  
8 hierarkia e raportimit.

9 Në dokumentet e mia, z. Gjykatës, dy apo tri herë figuron  
10 ankesa bërë komandantit tim se sektorët vartës në brigada të  
11 ndryshme nuk raportojnë. Domethënë, edhe kjo ka qenë në dorën  
12 e tyre, në mëshirën e tyre, duan apo s'duan të raportojnë, nuk  
13 kam pas mekanizëm që t'i detyrojë ata për të raportuar tek  
14 unë, kështu që mund të them që çdo ditë e imja ka qenë në  
15 kërkim të çështjeve që neve do të na interesonin edhe do të na  
16 hynin në punë si sektor për sigurinë e territorit, aty ku  
17 jetonim ne edhe popullata që ishte me neve.

18 PY. Do flasim dhe për këto ankesat në kohën e duhur. Unë po  
19 përpiqem të kuptoj si keni operuar ju në këtë periudhë, nga  
20 janari e në vijim.

21 Për shembull, nëse kishit një informacion, ju këtë  
22 informacion ia raportoni komandantit të zonës, kjo ishte vija  
23 e raportimit?

24 PË. Po, zoti avokat. Çdo herë, çdo gjë, si të mirë si të  
25 rëndë, ne kemi pas për detyrë që ta raportojmë në takimet tona



1 që i kishim me komandantin, me zëvendëskomandantin, me  
2 sektorët e tjerë edhe gjashtë G-ja të tjera që i bënim me  
3 komandantin të çdoditshme. Kurse me sektor e kishim një herë  
4 në javë.

5 Pra, ne kishim për detyrë vetëm komandantin ta njoftojmë,  
6 e përmes komandantit ai do ta shifte të arsyeshme a do ta  
7 raportonte në Shtab të Përgjithshëm apo jo.  
8 PY. Pra, është e drejtë, apo jo, Dëshmitar, që ju nuk i keni  
9 raportuar asnjëherë drejtpërsëdrejti Shtabit të Përgjithshëm  
10 për asnjë temë ose për asnjë lëndë që kishte të bënte me punën  
11 tuaj, por kjo ka shkuar përmes komandantit të zonës, ose  
12 strukturës së zonës, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, zoti avokat, kjo është e saktë. Shihet dhe në  
14 dokumentet e mia, se unë gjithmonë i kam raportuar  
15 komandantit. Kurrë rrugë direkte nuk i kam raportuar Shtabit  
16 të Përgjithshëm. Ndoshta një herë Prokurori javën e kaluar apo  
17 edhe sot më tregoi, dje më tregoi një dokument ku jam munduar  
18 meqë e kam parë të arsyeshme, se komandanti nuk po reagon në  
19 lidhje me disa dukuri negative, kam menduar se edhe ai po e  
20 bojkoton atë njoftim. Ndoshta jam munduar përmes shoferit të  
21 shefit të Shtabit të Përgjithshëm Bislim Zyrapit që ishte  
22 Ferat Ademaj, jam munduar që t'i njoftoj disa shokë atje lart  
23 çfarë po ndodh poshtë. Kështu që -- por e di që kurrë nuk kam  
24 raportuar direkt në Shtabin e Përgjithshëm për këto gjëra.

25 PY. Po, faleminderit për këtë. Do ta shohim këtë dokument pas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 66

1 pak. Megjithatë, tani për momentin dua që t'ju pyes lidhur me  
2 këtë. Sa i takon raportimit që keni bërë për komandantin e  
3 zonës, kur e keni bërë? E keni bërë këtë vetëm në këto  
4 mbledhje që keni pasur me të apo e keni bërë edhe me shkrim?  
5 Çfarë forme ka pas raportimi, në çfarë trajte e keni bërë  
6 raportimin, Dëshmitar?

7 PË. Unë mendoj, unë mendoj se çdo herë raportimet e mia te  
8 komandanti i zonës i kam bërë me shkrim. Ndoshta ka qenë  
9 ndonjë herë ndonjë informatë *ad hoc*, urgjente që kena mujt me  
10 bo, mirëpo edhe atë informatë *ad hoc* që ia kam dhanë  
11 gojarisht, javës së ardhshme e kam cekur në shkrime. Kështu që  
12 nuk kam ndonjë çështje që unë nuk e kam shkruar në raportet e  
13 mia, në propozimet e mia, në njoftimet e mia drejtuar  
14 komandantit Drinit apo Tahir Sinanit.

15 PY. Po. Gjatë kësaj periudhe, është e saktë, apo jo, që ju  
16 nuk i keni dërguar ndonjë raport lidhur me informacionin e  
17 mbledhur, lidhur me atë se çfarë po bënit. Pra, një  
18 informacion të tillë nuk ia keni drejtuar z. Kadri Veseli  
19 drejtpërsëdrejti, apo jo, Dëshmitar?,

20 PË. Drejtpërsëdrejti unë kurrë nuk i kam raportuar Kadri  
21 Veselit. Por përmes, ju kam thënë, ju thashë, përmes  
22 komandantit gjithmonë kam tentuar që të njoftoj me një kopje  
23 dhe Shtabin e Përgjithshëm. Ka qenë në detyrën e tij, apo në  
24 vendimin e tij, do ta dërgoj apo s'do ta dërgoj atë dokument  
25 në Shtab të Përgjithshëm.

1 PY. Si pjesë e detyrave tuaja, a është e saktë që ju,  
2 Dëshmitar, keni ndihmuar gjithashtu edhe për logjistikën në  
3 mars, kur persona që kanë negociuar në Rambuje po ktheheshin  
4 përsëri në vend, domethënë në Kosovë, përmes Maqedonisë? A ju  
5 kujtohet ta keni bërë këtë, Dëshmitar?

6 PË. Po ishte, ishte pjesë e jona edhe ajo. Unë mendoj se  
7 përmes, përmes ushtarëve të tjerë është organizuar edhe ardhja  
8 apo vajtja e Shtabit të Përgjithshëm, pavarësisht se në cilin  
9 drejtim kanë shkuar. Kanë shkuar në drejtim të Maqedonisë apo  
10 në drejtim të Shqipërisë. Mirëpo, mendoj se zona jonë  
11 pjesëtarët e ushtrisë të zonës tonë kanë ndihmuar edhe në këtë  
12 drejtim në logjistikë për t'i ndihmuar anëtarët e Shtabit të  
13 Përgjithshëm.

14 PY. Dhe, në këtë kontakt, apo jo, Dëshmitar, ju keni pas një  
15 ndërveprim të dytë me Kadri Veselin kur ai po kthehej nga  
16 jashtë, domethënë nga jashtë shtetit, nga Rambujeja, pra po  
17 kthehej në Kosovë nga Maqedonia rreth mesit të marsit. A është  
18 e vërtetë kjo?

19 PË. Nuk, mesit të marsit ne -- ndoshta kemi ardhur vetë apo,  
20 po e di që jemi takuar në atë kohë, me Kadri Veselin.

21 PY. Po, i kemi parë disa fotografi të kësaj dhe ju thatë që  
22 kjo ka ndodhur disa ditë përpara se sa të nënshkruhej  
23 marrëveshja e Rambujesë që ka qenë më 18 mars të 1999. Dhe ju  
24 datën e keni përcaktuar përafërsisht rreth 14, 15 ose 16  
25 marsit. A është e saktë kjo po ta shohim në perspektivë?

1 PË. Unë mendoj se është e saktë ashtu. Kaq mund të mbaj mend  
2 meqë nuk ishte edhe fotografia ime. Nuk e kisha parë unë këtë  
3 fotografi gjatë, kur, ne e mbaj mend që e kemi bërë, por më  
4 kishte ikur nga mendja edhe ma ka dërguar mandej mbas luftës  
5 Lum Haxhiu, Hajdin Abazi.

6 Kështu që unë besoj që ato ditë që ju i cekët që unë i  
7 kam cekuar më herët, ka qenë data kur ne jemi fotografuar.

8 PY. Ju keni thënë dhe, për ta sqaruar, është thënë në  
9 seancën, në shënimin përgatitor, në paragrafin 15, domethënë  
10 Shënimi Përgatitor 1, keni thënë që keni pasur disa biseda me  
11 z. Veseli dhe me persona të tjerë aty lidhur me Rambujenë.  
12 Keni thënë që keni diskutuar marrëveshjen edhe se si do të  
13 zbatohej ajo. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

14 PË. Jo se si do të zbatohej, sepse në ato kohë ato ditë mbaj  
15 mend, z. Gjykatës, edhe zoti avokat, mbaj mend që shokët tanë  
16 nga jashtë, shokët e Lëvizjes Popullore të Kosovës, ishin  
17 kundër nënshkrimit të Rambujesë. Ishin kundër duke mos e  
18 njohur realitetin mbrenda në Kosovë dhe në zonat e luftës.  
19 Prandaj edhe ishte krijuar një konfuzion, ishte krijuar një  
20 konfuzion që të nënshkruhet apo të mos nënshkruhet marrëveshja  
21 e Rambujesë.

22 Unë nuk pretendoj të jem unë ai faktor që kam biseduar me  
23 Kadri Veselin, Adem Grabovcin, apo Lum Haxhiun, që mund të më  
24 kenë pyetur mua personalisht a ta nënshkruajmë apo mos ta  
25 nënshkruajmë. Mirëpo mbaj mend se atë ditë komandant Sadik

1 Halitjaha edhe të gjithë shokët kanë biseduar edhe për temën e  
2 nënshkrimit apo mos nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë.  
3 Dhe mbaj mend se nga ajo kohë kemi krijuar edhe një hendek mes  
4 shokëve që ishin të Lëvizjes Popullore të Kosovës jashtë  
5 vendit edhe nesh që ishim në trevat e luftës e që kishim  
6 kundërshtime edhe kishim kundërshtime në veprim edhe mendim  
7 për marrëveshjen e Rambujesë. Mirëpo, falë një mendimi të mirë  
8 pozitiv, mendoj që kemi bërë mirë që e kemi nënshkruar atë  
9 marrëveshje për të shpëtuar atë çka mund të shpëtohej që ishte  
10 deri në atë [E padëgjueshme], deri në mars, prill të 1999.  
11 PY. Po, faleminderit. Ishte një temë ose një çështje e madhe  
12 në atë kohë që të nënshkruhej ose jo marrëveshja. A e kujtoni  
13 si të tillë, Dëshmitar:?  
14 PË. Ishte një çështje shumë e madhe që për neve kishte një  
15 shenjë të jemi apo të mos jemi. Të ekzistojmë apo të mos  
16 ekzistojmë. Municionet tona ishin në harxhim e sipër, kufiri  
17 ishte i bllokuar mes Shqipërisë edhe Kosovës për të sjellur  
18 armatime, për të -- se bile atë çështje e njoh shumë mirë.  
19 Ishte përforcuar nga forcat serbe.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju  
21 lutem, vetëm thjesht përgjigjuni pyetjeve që ju bëhet. Nuk  
22 është e nevojshme që të shtoni informacion tjetër. Avokati në  
23 qoftë se ka nevojë për informacion shtesë, do ju thotë që të  
24 jepni informacion shtesë.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 PY. Dhe unë isha gati të thoja të njëjtën gjë që t'i thoja  
2 dëshmitarit të përqendrohemi se në të kundërtën do na duhet  
3 shumë kohë për të qëndruar këtu. Kam një listë të gjatë  
4 pyetjesh, kështu që ju lutem përgjigjuni pyetjes. A e kuptoni,  
5 Dëshmitar?

6 Keni thënë në shënimin përgatitor që ju e persona të  
7 tjerë i keni ofruar mbështetje Veselit, edhe pse LPK-ja nuk  
8 pajtohej me nënshkrimin e marrëveshje. A ju kujtohet kjo,  
9 domethënë që keni ofruar mbështetje për këtë nismë? Ju  
10 kujtohet kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

12 PY. A keni diskutuar ndonjë gjë tjetër në këto biseda, apo  
13 gjithçka që keni diskutuar ka qenë Rambujeja dhe në qoftë se  
14 marrëveshja e Rambujesë do të nënshkruhej apo jo?

15 PË. Ishte një takim shokësh. Mund të kem biseduar shumë gjëra  
16 normale që mund të bisedojnë shokët. Po e mbaj mend se njëra  
17 nga ato temat që ishin më të theksuara ishte kjo temë, sepse  
18 kjo ishte një fokus të ngjarjeve dhe të ditëve.

19 PY. Z. Veseli më pas u largua nga Nishori. A është e saktë  
20 kjo? Domethënë, në atë kohë, a ju kujtohet kjo që të jetë  
21 larguar z. Veseli nga Nishori?

22 PË. Po, në atë natë pas takimit unë mendoj që ai është  
23 larguar nga Nishori dhe më nuk e kam parë deri më 1 prill në  
24 Shtab të Përgjithshëm.

25 PY. Po. Do flasim edhe për këtë takim të fundit më datën 1

1 prill. Megjithatë, dua ta sqaroj që nga ajo periudhë deri më  
2 datën 1 prill ju jeni përpjekur që të ruanit një vijë  
3 mbrojtjeje kundër serbëve në zonën tuaj. A ju kujtohet kjo,  
4 Dëshmitar? Pra që të keni ruajtur këtë vijën e mbrojtjes  
5 kundër serbëve?

6 PË. Po, zotëri. Më kujtohet sepse e dinim që do vijë kohë  
7 ofensivash. Ishim të përgatitur për ofensiva të rrepta me  
8 forcat serbe.

9 PY. Po, sepse bombardimet e NATO-s filluan gjatë asaj  
10 periudhe, domethënë nga fundi i marsit. Pra, është e saktë të  
11 thuhej që ju prisnit sulme dhe po përgatiteshit për këto  
12 sulme. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, zoti avokat, është e saktë.

14 PY. Pra, ishte vija e frontit nga Dragobili deri në Suharekë.  
15 Domethënë pak a shumë rreth 30 kilometra e gjatë. Këtë e keni  
16 thënë në Shënimin Përgatitor 1 në paragrafin 18. A është e  
17 saktë kjo?

18 PË. Po, zoti avokat, kjo është e saktë. Në bazë të vendimit  
19 që kishte marrë komanda apo përkatësisht komandant Tahir  
20 Sinani dhe Sadik Halitjaha, kemi marrë vendim që territori të  
21 fillojë të mbrohet nga Dragobili siç e cekët ju, e deri në  
22 Suharekë, deri në Sllapuzhan, apo deri në Bllacë. Ka qenë një  
23 front i gjatë përafërsisht 30 kilometra, siç e cekët ju. Ka  
24 qenë një përgatitje e mirë nga komanda dhe nga ushtarët edhe  
25 nga komandantët e brigadave. Pra, është e vërtetë kjo.

1 PY. Po, në fakt e parashikuat pyetjen që do ju bëja unë tani.  
2 Nga i morët urdhrat për të bërë këtë gjë? Këto urdhra janë  
3 dhënë me shkrim, apo si krijoheshin këto vijat e frontit? Si i  
4 keni marrë urdhrat?

5 PË. Unë ju thashë se ne si zonë për çdo ditë takoheshin  
6 komandanti me zëvendëskomandantin e me disa sektorë, javore i  
7 kishim takimet tona. E di që ka marrë vendim komanda e zonës  
8 operative të Pashtrikut përkatësisht, komandant Tahir Sinani  
9 edhe Sadik Halitjaha kanë marrë vendim ndoshta së bashku me  
10 komandantët e brigadave, se aty ishin Brigada 122, 123, 124  
11 edhe 125, që do të thotë ndoshta janë marrë vesh edhe me ata  
12 komandantët e katër brigadave të tjera, por që unë nuk kam  
13 qenë në atë takim, por mbaj mend vetëm që me neve ka marrë  
14 vendim që të bëhet kjo linjë frontale.

15 PY. Do të vazhdoj më tej. Është e saktë, apo jo, Dëshmitar,  
16 që forcat serbe arritën që të thyenin vijën tuaj mbrojtëse.  
17 Dhe ju filluat menjëherë që të tërhiqeshit në drejtim të zonës  
18 së Kleçkës. A ka ndodhur kështu, Dëshmitar?

19 PË. Po, zoti avokat. Nga data 23, 24, kur jemi pozicionuar në  
20 atë linjë frontale deri më 1 prill, kemi qëndruar, kemi pas  
21 shumë viktima, kemi pas shumë të plagosur. Kemi pas  
22 vazhdimisht sulme të rënda. Dhe më 1, më 31 mars, duke hyrë në  
23 1 prill, ajo linjë frontale është çarë.

24 PY. Pra, kjo është mënyra se si ju shkuat në zonën e Kleçkës  
25 më datë 1 prill. Domethënë, u tërhoqët në mënyrë të tillë që



1 të mbronit Shtabin e Përgjithshëm aty, a është e saktë kjo?

2 PË. Po. Pas kësaj ishte vendimi i komandës prapë që të  
3 tërhiqemi dhe të shkojmë të mbrojmë Shtabin e Përgjithshëm.

4 PY. Më 1 prill përsëri ka pas luftime të ashpra në atë zonë,  
5 domethënë në zonën e Kleçkës ku keni qenë dhe ju. A është e  
6 saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Më 1 prill ka pasur edhe andej luftime, ka pas sulme me  
8 avion, ka pas sulme me armë të ndryshme të armatës jugosllave.  
9 Po, është e vërtetë.

10 PY. A është e saktë që forcat serbe në atë kohë e mbushën atë  
11 zonë, domethënë, ishin ato forcat serbe të cilat morën zonën  
12 nën kontroll në 1 dhe 2 prill? A është kështu?

13 PË. Më datën 1 dhe 2 prill ndoshta zonën ku ishim ne të  
14 stacionuar nga Dragobili e deri në Suharekë apo në fshatrat  
15 poshtë, ka mundur të jetë, kurse nalt ku ishim ne tashti në  
16 Shtabin e Përgjithshëm atje ne kemi, mendoj se e kemi mbrojtur  
17 Shtabin e Përgjithshëm që mos të, të pamundësojmë hyrjen e  
18 forcave serbe në territorin e Shtabit të Përgjithshëm.

19 PY. Tani të kalojmë në kontaktin që keni pas me z. Veseli ose  
20 takimin me z. Veseli, më datën 1 prill. Ky ka ndodhur në zonën  
21 e Kleçkës, domethënë në zonën ku ishte i vendosur Shtabi i  
22 Përgjithshëm kur ju u hasët ose u takuat me z. Veseli. A është  
23 e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, zoti avokat, është shumë e saktë. Domethënë, ishte  
25 një kaos aty, brenda natës 4000 ushtarë hynin përnjëherë në

1 fshatrat Kleçkë e Divjakë, Berishë, po edhe në atë tollovi, në  
2 ato jemi takuar me Kadri Veselin.

3 PY. A ju kujtohet që ai ju pyeti, ju kërkoi që të shkonit dhe  
4 të kontrollonit me ushtarët e UÇK-së, pra, kur ata ishin duke  
5 shërbyer, domethënë, kur po bënë roje në zonat përreth, a ju  
6 kujtohet t'ju ketë pyetur, t'jua ketë kërkuar këtë gjë ai?

7 PË. Po, zotëri. Më kujtohet sepse kemi biseduar për sigurinë  
8 edhe se nuk dija, unë nuk e dija personalisht kah është vija  
9 mbrojtëse e Shtabit të Përgjithshëm. Atëherë edhe ai më ka  
10 propozuar që të shkoj t'i vizitoj a janë të gjitha në rregull,  
11 a janë të gjitha të linjarizuara siç duhet, kështu që atë  
12 detyrë e kam kryer nga mbrëmja deri në mëngjes, mendoj me  
13 sukses, edhe ka qenë në rregull.

14 PY. Kur u kthyet në mëngjes, është e saktë, apo jo,  
15 Dëshmitar, që z. Veseli nuk ka qenë më aty? Domethënë që ju  
16 nuk i keni raportuar më atij kur u kthyet në mëngjes, sepse ai  
17 nuk ishte aty. Është e saktë kjo?

18 PË. Është shumë e saktë. Kur jam kthyer kam takuar vetëm Azem  
19 Sylën, komandantin e përgjithshëm. Kërkoj falje se i thashë me  
20 emër. Edhe ai kur më pa në atë situacion çfarë isha, i erdhi  
21 keq sepse isha tepër i lodhur, shtatë-tetë ditë pa gjumë, pa  
22 fjetur, pa -- e mbaj mend që më tha, "Shko në dhomën time  
23 pusho pak". Gjë që ishte për mua një nder i madh. E nuk e kam  
24 takuar Kadri Veselin kur kam ardhur në mëngjes.

25 PY. Në mënyrë të tillë që ta kemi të saktë datën. Po flasim

1 këtu për mëngjesin e datës 2 prill 1999, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Unë mendoj se është data 2 prill të 1999.

3 PY. Z. Qadraku, të shohim një provë që është e regjistruar si  
4 prova P500.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të  
6 paraqesë një dokument në ekran në anglisht dhe në shqip.

7 PY. Është një dokument që e keni parë edhe më herët në  
8 momentin kur Prokuroria po ju bënte pyetje.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë, dhe një herë për  
10 Sekretarinë bëhet fjalë për provën P500.

11 PY. A e njihni dokumentin, z. Qadraku?

12 PË. Po, zotëri, e njof.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të kalojmë  
14 në fund të dokumentit, të shohim nënshkrimin tuaj.

15 PY. Ju e konfirmuat më herët që ky është nënshkrimi juaj, dhe  
16 është dokument që e keni përpiluar ju, apo jo?

17 PË. Po, zotëri.

18 PY. Është e saktë, apo jo, që me sa dini ju ky dokument është  
19 gjetur në dokumentin që ju keni pasur në shtëpi? A është  
20 kështu?

21 PË. Po.

22 PY. A e dini në qoftë se ky është versioni origjinal i  
23 dokumentit, apo jo, apo nuk e dini? Domethënë, është kopje,  
24 apo është versioni origjinal i dokumentit, apo nuk e dini?

25 PË. Unë mendoj se është kopje, se do të ishte nënshkrimi im

1 me të kaltër.

2 PY. A ka qenë praktikë e zakonshme për juve që të  
3 nënshkruanit të gjitha kopjet e dokumenteve që ju përpilonit  
4 vetë?

5 PË. Normalisht po, të gjitha kopjet, të gjitha informatat, të  
6 gjitha propozimet e mia jam munduar që të mos e lëshoj asnjë  
7 pa e nënshkruar dhe pa --

8 PY. Lidhur me këtë dokument, a e dini në qoftë se ju këtë  
9 dokument e keni përcjellë më tej apo jo?

10 PË. Unë nuk e mbaj mend. Unë besoj që ia kam dhanë ose  
11 komandant Drinit, ose Sadik Halitjahës, edhe ky ishte  
12 zëvendësi i komandantit, apo -- edhe besoj që përmes komandës  
13 e kam dërguar aty ku duhet.

14 PY. A është e saktë të thuhet se ju keni ndjekur zinxhirin e  
15 zakonshëm të komandës dhe këtë deklaratë ia keni dhënë ose  
16 komandës së zonës, domethënë komandant Drinit, ose zëvendësve  
17 të tij. Këtë po thoni në dëshminë tuaj, Dëshmitar?

18 PË. Po, zotëri. Këtë po them sepse edhe vetë Sadik, komandant  
19 Sadik Halitjaha edhe ai ishte pjesë të komandës, ishte  
20 zëvendës i Tahir Sinanit apo i, në atë kohë ishte pjesë e  
21 komandës edhe në kohën e Drinit. Kështu që vetë prezenca e tij  
22 në këtë, emrit të tij këtu, tregon se ka mundur edhe ai ta  
23 dërgojë këtë në duart e komandant Drinit apo --

24 PY. A e dini nëse komandant Drini e ka marrë këtë dokument?

25 PË. Nuk e di.

1 PY. A e dini nëse ai ose z. Halitjaha e kanë përcjellë  
2 dokumentin nga komanda e zonës për Shtabin e Përgjithshëm? A e  
3 dini a ka ndodhur kjo, Dëshmitar?

4 PË. Unë mendoj se ne e kemi dorëzuar në komandën tonë. A e  
5 kanë dërguar më lart, nuk e di. Nuk jam në dijeni për këtë.

6 PY. A mund ta konfirmoni për shembull kur thuhet këtu që  
7 "bëhet në tri kopje", dhe këtu thuhet "për arkivin". Ku thuhet  
8 "arkivi" bëhet fjalë për arkivin e zonës?

9 PË. Po, gjithmonë arkivi ishte arkivi i zonës.

10 PY. Kur ia keni dërguar komandantit të zonës, i takon që  
11 praktika e zakonshme do ishte që dokumenti të shkonte në  
12 arkivën e zonës, a është kështu, Dëshmitar?

13 PË. Jam mundur çdo herë që një kopje ta ketë edhe arkiva e  
14 zonës.

15 PY. Megjithatë, ajo çfarë dua të sqaroj është kjo. Kur ia  
16 dërguat këtë letër komandant Drinit, a e dinit ju në qoftë se  
17 ai do ta mbante këtë letër në nivel komande të zonës?

18 PË. Jo, nuk e dija. As nuk kisha të drejtë ta pyesja.

19 PY. Më poshtë thuhet "Shtabit të Përgjithshëm". A do të thotë  
20 kjo që përmes komandës së zonës letra i dërgohej dhe Shtabit i  
21 Përgjithshëm, domethënë, ky ishte synimi, këtë keni dashur të  
22 thoni këtu, Dëshmitar?

23 PË. Po, zotëri. Ky ishte synimi jonë që Shtabi i Përgjithshëm  
24 për neve ishte më shumë, z. Bislum Zyrapi që ishte shef i  
25 shtabit atje. Domethënë, kjo kopje do t'i shkonte atij. Mirëpo

1 ne s'mund të komunikoni direkt me të, kështu që besoj që ka  
2 shkuar përmes komandës së zonës operative të Pashtrikut,  
3 përkatësisht përmes komandant Drinit në atë kohë. Sepse mendoj  
4 që është shkurti i vitit 1999 kjo -- kjo deklaratë.

5 PY. Atëherë, sikurse mund ta shikojmë, kjo është një  
6 deklaratë e datës 14 mars 1999. E shohim këtë në krye të  
7 dokumentit. Doni ta konfirmoni këtë, a mund, a doni që të  
8 shikojmë më sipër në faqe për të parë datën?

9 PË. Jo, s'kam nevojë, unë besoj, unë e besoj këtë. Kështu  
10 qysh, ndoshta gabova unë që ish në shkurt.

11 PY. Pastaj te pika 3 këtu thuhet "SHIK-ut pranë Shtabit të  
12 Përgjithshëm". Kur thoni "SHIK-ut pranë Shtabit të  
13 Përgjithshëm", për kë e keni pas fjalën, pra, kë synoni ju që  
14 t'i dërgoni një kopje të këtij dokumenti, të kësaj letre?

15 PË. Me "SHIK në Shtabin e Përgjithshëm" unë kam menduar që  
16 t'i dërgoj eprorit të sektorit tim që unë isha në zonën  
17 operative të Pashtrikut, pavarësisht se nuk e dija a ka  
18 dikush, a është dikush prezent, apo s'është dikush prezent  
19 aty. Kam pas dëshirë që ta kenë edhe ata një kopje të tillë.  
20 Nuk kam shkruar me emra të përveçëm, por sektorin. Sektorit të  
21 shërbimit informativ që kam menduar se është sektori i G2 në  
22 këtë drejtim.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që u çova në këmbë.

24 Më thanë që mund të ketë një problem te përkthimi.

25 Tek reshti 5 ose 6, sa i takon z. Zyrapit, më thonë që

1 dëshmitari ka thënë që "për ne Shtabi i Përgjithshëm ka qenë  
2 Bislam Zyrapi."

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
4 verifikojmë me përkthyesit këtu.

5 Vazhdoni. Vazhdoni, z. Dixon.

6 Z. DIXON: [Përkthim]

7 PY. Kur thoni SHIK këtu, sektori i zbulimit në Shtabin e  
8 Përgjithshëm, ju e dinit që më 14 mars të 1999, kur është  
9 përpiluar dhe kjo deklaratë, pra ju e dini që shefi i atij  
10 sektori ka qenë z. Veseli, apo jo, në Shtabin e Përgjithshëm?  
11 PË. Po, e dija, mendoja se është q' ai. Mirëpo mendoja se  
12 është sikur vetë që jam nënshkruar vetë ndonjëherë SHIK e  
13 ndonjëherë G2, unë kam menduar se mund ta shkruaj shefit të  
14 SHIK-ut. Ndoshta paska qenë dashur t'i shkruaj shefit të G2 në  
15 Shtab të Përgjithshëm. Por për mua atëherë ka qenë, ju thashë  
16 edhe më herët, ka qenë kuptimi i njëjtë i këtyne akronimeve.

17 PY. Keni thënë në dëshminë tuaj se kjo është dërguar përmes  
18 komandës së zonës. Pra, përmes komandantit të zonës. A mund ta  
19 konfirmojmë nëse mund të na thoni pra, që ju nga ana juaj nuk  
20 keni bërë asnjë përpjekje që ta anashkaloni komandantin e  
21 zonës dhe të shkonit ju drejtpërsëdrejti te Shtabi i  
22 Përgjithshëm, saktë?

23 PË. Nuk kam tentuar. Nuk kam tentuar, unë gjithë i kam  
24 treguar dhe sa herë kam qenë në Shtab të Përgjithshëm, por nuk  
25 kam tentuar të dërgoj diçka fshehtas nga komanda e zonës

1 kurrë. Se nuk kam pasur dhe arsye. Gjithmonë kam menduar se  
2 duhet problemin ta sheh i pari komandanti i zonës, komanda e  
3 zonës, pastaj nëse ka, është problemi ma i madh, le të shkoj  
4 edhe në Shtab të Përgjithshëm, por çdo gjë, çdo gjë që kam  
5 menduar kam menduar gjithmonë përmes, përmes zonës dhe përmes  
6 komandës së tij.

7 PY. Ju nuk keni marrë asnjëherë ndonjë përgjigje lidhur me  
8 këtë deklaratë nga Shtabi i Përgjithshëm, apo jo?

9 PË. Jo, zotëri, kurrë nuk kam marrë përgjigje në këtë  
10 deklaratë.

11 PY. Po ndonjë përgjigje përmes komandës së zonës, a morët?  
12 Për shembull, përmes komandant Drinit, apo zëvendësit të tij,  
13 a ju dha ndonjë përgjigje ju lidhur me këtë deklaratë?

14 PË. Jo, jo. Nuk më dha kurrfarë përgjigje sepse i kishim edhe  
15 pak ato marrëdhëniet, marrëdhëniet qysh distancuese mes nesh,  
16 por nuk na dha kurrfarë përgjigje.

17 PY. Është e vërtetë që ju e respektonit komandant Drinin, por  
18 kishit disa mospëlqime, pakënaqësira për këtë, për z. Drini,  
19 kështu?

20 PË. Po, zotëri. Unë nga natyra jam ndonjë shpirt më ambicioz,  
21 më punëtor, më ofensiv. Te ai kam pa një njeri pak më të qetë,  
22 më defensiv edhe nuk, shpesh herë nuk pajtohesha me veprimet e  
23 tija që ka bërë ai. Por kjo s'do të thotë që unë nuk kam  
24 zbatuar urdhrat e tij. Çdo urdhër, çdo gjë që më është kërkuar  
25 nga ai, nga ana e tij për mua, unë gjithmonë e kam zbatuar.



1 Pavarësisht jam pajtuar unë me atë apo nuk jam pajtuar.

2 PY. Pra, rrallëherë ka pasur mospëlqime, mosmarrëveshje, dhe  
3 këto ishin kryesisht lidhur me taktikat ushtarake, apo që  
4 lidheshin me veprimet ushtarake, a është një vlerësim, një  
5 përshkrim i saktë?

6 PË. Ndonjëherë ishte për taktika ushtarake, ndonjëherë ishte  
7 për emërtime të ndryshme, ndonjëherë ishte për organizime të  
8 ndryshme. Ndonjëherë ishte për mosmarrjen më serioz të një  
9 çështjeje apo të një tjetër, kështu që kishte shumë çështje  
10 për çka -- jo një, nuk është një varg i njëjtë, por shpeshherë  
11 kam pas, kam menduar se kam të drejtë, kam menduar se kam të  
12 drejtë të jap propozimin tim ndryshe nga ai mendimi i  
13 komandantit, pavarësisht a pranon apo s'e pranon ai.

14 PY. Megjithatë, ju nuk ndiheshit i kufizuar, nëse kishit  
15 mospëlqime lirisht mund t'i thonit, apo jo, sikurse dhe keni  
16 bërë në këtë deklaratë?

17 PË. Gjithmonë unë i kam thënë edhe atij, edhe Tahir Sinanit,  
18 ato që kam menduar i kam thënë gjithmonë përmes shkrimit, në  
19 sy, në prezencën e të gjithë njerëzve. Kurrë nuk e kam mshefur  
20 mendimin tim për veprimet e tilla që kam menduar se janë të  
21 gabuara, sepse kam menduar që unë kam më shumë të drejtë,  
22 domethënë që çdo herë, çdo herë vërejtjet e mia kanë qenë të  
23 hapura dhe përmes tij kanë shkuar.

24 PY. Por ju gjithmonë e keni respektuar zinxhirin komandues  
25 ushtarak, apo jo?

1 PË. Unë gjithmonë kam respektuar zinxhirin ushtarak  
2 pavarësisht relacioneve, pavarësisht bindjeve të mia.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekрани,  
4 dhe do lutesha të vendosej një dokument tjetër që e kemi  
5 trajtuar disa herë. Është dokumenti që mban numrin e provës  
6 P60 -- P650, dhe në anglisht dhe në shqip.

7 PY. Presim që të dalë në ekran, Dëshmitar, që ta shihni  
8 sërish.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Shkojmë në fund, ju lutem. Tek pjesa  
10 ku duhet të jetë nënshkrimi.

11 PY. Z. Qadraku, mund ta shihni këtu sikurse dhe e thatë më  
12 herët, që ky dokument nuk është nënshkruar prej jush. Është  
13 një dokument tjetër që është marrë në shtëpinë tuaj, kështu?

14 PË. Po, ashtu duket.

15 PY. Meqë është i panënshkruar, atëherë a mund të na thoni,  
16 keni dijeni nëse është, i është dërguar kjo deklaratë  
17 komandant Drinit apo zëvendësve të tij përmes procedurës  
18 standarde?

19 PË. Unë besoj se i është përcjellur përmes procedurës  
20 standarde, por ndoshta atë kopje që e kam ndalë për vete  
21 ndoshta atë kopje nuk e kam nënshkruar. Është e mundshme kjo.  
22 Por kjo përmbajtja e këtij artikullit, përmbajtja e kësaj më  
23 kujtohet edhe është e imja, unë e pranoj që është.

24 PY. Atëherë, a e dini se si shkoi ky dokument tek inspektori  
25 i përgjithshëm, edhe tek Shtabi i Përgjithshëm, siç shënohet

1 këtua?

2 PË. Unë nuk e di se si shkoi. Unë e di që i kam dhënë  
3 komandës këtë dokument që ta përcjellë në rrugën e tyre për te  
4 Shtabi i Përgjithshëm edhe te inspektori i përgjithshëm. Unë e  
5 kam, ia kam dhënë komandantit që ai ta gjejë rrugën, sepse ne  
6 përmes tij komunikojmë me Shtabin e Përgjithshëm edhe ai  
7 gjente ose korrier, ose njerëz që frekuentonin rrugën për  
8 Shtab të Përgjithshëm. Nuk ka qenë detyrë e imja me e çu  
9 letrën apo njoftimin atje se s'kam pas as mundësi, s'kam pas  
10 as njerëz të duhur për të [E padëgjueshme].

11 PY. Pra, që ta sqarojmë. Ju personalisht nuk ia keni dhënë  
12 këtë deklaratë apo ndonjë dokument të ngjashëm me këtë ndonjë  
13 korrieri apo ndonjë vozitësi që t'i çonin ata drejtpërsëdrejti  
14 te Shtabi i Përgjithshëm dhe të linit kështu mënjane ju  
15 komandën apo komandant Drinin apo zëvendësin e tij?

16 PË. Kurrë nuk e kam lënë mënjane komandën e zonës operative  
17 të Pashtrikut. Ju thashë më herët, kurrë nuk e kam  
18 anashkaluar, jam munduar gjithmonë përmes tyre. Jam mundur  
19 ndoshta kurrë nuk m'u ka dëgjuar kur kam këmbëngulur, jam  
20 mundur të gjej edhe zgjidhje të tjera. Por jo ta anashkaloj,  
21 jo ta anashkaloj komandën e zonës operative të Pashtrikut.

22 PY. A morët ndonjëherë ndonjë përgjigje prej ndokujt lidhur  
23 me këtë deklaratë, dhe kur them prej ndokujt, të gjithë  
24 nivelet, nivel zone, nivel Shtabi të Përgjithshëm. A ju ktheu  
25 njeri përgjigje?

1 PË. Gjatë këtyre katër, pesë muajve që kam shkruar unë, kurrë  
2 asnjëherë Shtabi i Përgjithshëm nuk më ka kthyer mua  
3 përgjigje, edhe pse gjithmonë iu kam drejtuar me një kopje  
4 atyre. Edhe për këtë kurrë nuk më kanë kthyer përgjigje.

5 PY. Po nga komandanti i zonës suaj? Morët ndonjë përgjigje  
6 prej tij?

7 PË. Po, nëse e shofim, nëse mund të ktheni në faqen e parë.

8 PY. Patjetër.

9 PË. Unë mendoj se këtë deklaratë komandant Drini e ka lexuar  
10 në mënyrën e vet, edhe mendoj se ndërrimet që unë kam kërkuar  
11 që të bëhen në Brigadën 124 i ka bërë në bashkëpunim me  
12 komandantin e Brigadës 124. Kështu që mendoj se kjo letër  
13 ndoshta ka ndikuar edhe pse nuk ka pas përgjigje me shkrim,  
14 por besoj që ka ndikuar në emërimin e personit adekuat në S2 e  
15 Brigadës 124, që është këtu në fillim, që paraqitet ankesa për  
16 të.

17 PY. Dhe këto ndryshime u bënë nga komanda e zonës, nga  
18 komandant Drini, apo jo?

19 PË. Unë besoj që ka qenë intervenimi i komandant Drinit ose  
20 propozimi i komandant Drinit i dhënë komandantit të Brigadës  
21 124, që ka ndikuar për këtë, se unë nuk e kam pasur atë  
22 mundësi, nuk e kam pasur as kurrfarë elementi detyrues për  
23 komandantin e Brigadës 124.

24 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

1 PY. Tani do të doja të flisnim për një temë tjetër përpara se  
2 të marrim pushimin e drekës. Dhe tema ka lidhje me  
3 bashkëpunëtorët. Ju keni dhënë dëshmi dje lidhur me këtë temë.  
4 Prokurori ju pyeti --

5 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe do t'ju jap edhe numrin për  
6 referencë, në transkriptin provizor ishte faqja 60, rreshti 2  
7 e në vijim.

8 PY. "Ju lutem, a mund t'i thoni Gjykatësve si e kryenit ju  
9 detyrën për zbulimin e bashkëpunëtorëve?"

10 Dhe ju u jeni përgjigjur:

11 "Ne nuk u shtronim asnjë detyrë sepse nuk ishte detyrë  
12 shtëpie kjo për ne."

13 A ju kujtohet që e thatë këtë?

14 PË. Po, zotëri, më kujtohet. Nuk ishte detyrë shtëpie, nuk  
15 mundim nga aty ku ishim ne, nuk mund të ushtronim këtë detyrë  
16 sepse ishim të ndarë me zona. Ishte zona ku operonin ushtria  
17 dhe policia serbe. Ne jetonim në zonën më të izoluar ku ishte  
18 një pjesë e popullatës edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës,  
19 kështu që nuk e kishim atë në plan. As detyrë shtëpie, si  
20 thatë.

21 PY. Në rregull. Le ta trajtojmë pak më shumë këtë. A është e  
22 vërtetë që në sektorin tuaj ju nuk keni pasur asnjë rast që të  
23 keni hetuar persona si bashkëpunëtorë dhe të keni marrë masa  
24 kundër tyre? A e keni thënë këtë në dëshminë tuaj?

25 PË. Po, zotëri. Këtë e kam thënë. Neve nuk kemi qenë të

1 interesuar për këtë pjesë të investimit apo hetimeve.

2 PY. Kur thoni nuk ishim të interesum, e keni fjalën që ju

3 s'kishit burime, nuk ishit në gjendje, nuk ishit të aftë që ta

4 kryenit detyrën? Na e shpjegoni pak më shumë, ju lutem.

5 PË. Ju shpjegova pak më para që i kishim territoret pak a

6 shumë të ndara. Ne jetonim në zona rurale, ata jetonin në zona

7 më të përqendruara në qytete. Neve nuk na, nuk kishim mundësi,

8 në fakt, të hetonim shumë, brenda kornizave ndoshta, por nuk

9 kishim as interes të madh që të rrezikonim njerëzit për të

10 parë çfarë po ndodh në jashtë territorit. Kishim interes tonin

11 që ta mbrojmë territorin ku ne ishim të përqendruar. Kishim

12 interes që ta ruajmë atë territor që të mos na hyjnë forcat

13 serbe, mos të na hyjnë dikush që mund të vinte me qëllim apo

14 me orientim të forcave serbe. Domethënë, na kemi pas detyrë që

15 ta ruajmë vetëm veten, zonën tonë, edhe q'atë territor ku kemi

16 jetuar me atë pjesë të popullatës gjatë këtyre ditëve të

17 luftimeve në Kosovë.

18 PY. Po, e kuptoj unë rolin mbrojtës. Por z. Qadraku, unë po

19 përpiqem të kuptoj këtë: Dje kur ju pyeti z. Pace, ju u

20 përgjigjët dhe thatë që informacionet i merrnit nga civilët,

21 por edhe nga ushtarë të UÇK-së lidhur me personat që mund t'ju

22 vendosnin ju në rrezik. Dhe në dëshminë tuaj, ju thatë që i

23 merrnit informacionet të tilla. A keni çelur ndonjëherë ndonjë

24 hetim ju në bazë të informacionit që keni marrë?

25 PË. Domethënë, është e drejtë edhe ajo që e thatë. Ne në ato

1 përpjekje për të ruajtur territorin tonë, për të ruajtur  
2 vendin ku ne ishim të strehuar, normalisht që pranonim,  
3 pranonim informacione nga popullata që na tregonin se ne nuk  
4 dijmë edhe ku jemi. Unë nuk e kam ditur ku është Nishori,  
5 nuk e kam ditur ku është Kravasaria, nuk e kam ditur ku është  
6 Banja e Malishevës nga ku duhet të ruheshim. Edhe normalisht  
7 që kam qenë i interesuar të di se me çfarë rrethine kemi të  
8 bëjmë, me çfarë njerëz jemi të rrethuar. Kush mund të na  
9 rrezikojë që të hyjë në territoret tonat e të na dëmtojë, në  
10 këtë aspekt domethënë ka qenë një proces i vazhdueshëm,  
11 interesimi jonë edhe informacione që na kanë pru, na kanë  
12 sjellë popullata civile në këtë drejtim, sepse ne nuk e dinim  
13 me kënd ishim të rrethuar. Dhe jo unë, por as pjesa e  
14 komandës.

15 Komandant Drini vinte nga Prizreni, Sadik Halitjaha vinte  
16 nga Mushtisht. Ata të -- Vesel Maliqi vinte nga malet e  
17 Suharekës. Ne asnjë nuk ishim në vendet tona, ishim në vend të  
18 huaj. Dhe çdo gjë na interesonte përreth se me kë jetojmë, me  
19 kë bashkëjetojmë, nga kush jemi të rrezikuar, kush mund të na  
20 rrezikon, kush mund të na hyjë, a ka ndonjë emër që mund të na  
21 bëjë dëm.

22 Domethënë, në këtë aspekt ndoshta kemi bërë, kemi marrë  
23 shënime që të dijmë më mirë kë të lejojmë, apo kë mos ta  
24 lejojmë që të na rrezikojë ne, por kurrë ne të shkojmë në  
25 Prizren, Rahovec, Prishtinë apo dikund që ne të ndërmarrim

1 ndonjë aksion kundër atyne që edhe pse njiheshin haptas që  
2 ishin bashkëpunëtorë të UDB-së, nuk kemi dash të rrezikojmë  
3 popullatën civile, sepse ata për një vrasje të një  
4 bashkëpunëtorit serb i vranin 100 civilë të tjerë.

5 U mundova pakëz ma shkurt me e thanë, se boll gatë, mjaft  
6 gatë.

7 PY. Po. Dëshmitar, unë e kuptoj pse ishin të rëndësishme këto  
8 informacione. Por ju lutem, të kuptoni se çfarë dua, ku dua të  
9 dal unë.

10 Unë po ju pyes, kur i mblidhnit të gjata këto  
11 informacione, në bazë të informacioneve që keni mbledhur, a ka  
12 ndodhur ndonjëherë, pra në bazë të informacioneve që keni  
13 mbledhur, a ka ndodhur ndonjëherë që ju të çelnit ndonjë hetim  
14 kundër tyre, të merrnit ndonjë masë kundër tyre, t'i ndalonit  
15 këta persona, t'i ndiqnit penalisht? A keni ndërmarrë ndonjë  
16 hap të mëtutjeshëm në bazë të informacionit që grumbullonit?

17 PË. Jo, zotëri, unë nuk e kam hapur asnjë proces, asnjë hetim  
18 ndaj askujt. Prandaj në marsin e vitit 1999 unë kam bërë një  
19 kërkesë Shtabit të Përgjithshëm, kam bërë një kërkesë zonës  
20 operative të Pashtrikut që të formohet, që të formohet  
21 gjykata, të formohet komplet hierarkia e drejtësisë me  
22 gjykatë, me Prokurori, me hetuesi. Sepse nga vetë popullata  
23 kishim presion. Edhe popullata kishte probleme me vete. Kishte  
24 problem vëllau me vëlla, kishte problem djali me babë.

25 S'kishin ku të drejtoheshin, vijshin te ne. Unë nuk dija të



1 merresha me ato problemet e juridikut, prandaj kam kërkuar nga  
2 zona edhe nga Shtabi i Përgjithshëm që të na lejohet formimi i  
3 të gjitha strukturave juridike në zona operative e Pashtrikut  
4 për të cilën kurrë nuk më kanë ofruar përgjigje dhe kurrë  
5 s'kanë pranuar që të formohen këto.

6 Ka qenë marsi i 1999 kur unë kam kërkuar -- më duket që e  
7 keni të shtypur se më është treguar në Prishtinë, në Prishtinë  
8 kur kam qenë, më është treguar ai, ajo kërkesë e imja drejtuar  
9 Shtabit të Përgjithshëm edhe zonës operative të Pashtrikut, të  
10 na lejohet të formohet gjykata, hetuesia, prokuroria, edhe  
11 burgu. Të gjitha këto i kam kërkuar hapur, mirëpo kurrë s'kam  
12 pas pranim as nga Shtabi i Përgjithshëm e as nga zona  
13 operative e Pashtrikut. Kështu që, unë nuk jam marrë me hetime  
14 sepse nuk na kanë lejuar as nuk kam pas kompetenca, as nuk kam  
15 dit të bëj hetime në këtë drejtim sepse nuk jam jurist, nuk  
16 kam asi profesioni. Edhe nuk ishte detyrë e imja. Detyrë e  
17 imja ka qenë vetëm zbulimi dhe kundërzbulimi.

18 PY. Në fakt këtu do dilja. Ju lutem, thjesht kufizojeni pak  
19 përgjigjen. Në -- pra, ka qenë detyra jua si pjesë e zbulimit  
20 të hetonit raste të tilla, pra ka qenë apo nuk ka qenë pjesë e  
21 rolit tuaj hetimi i rasteve të tilla?

22 PË. Po vetë emërtimi zbulim-kundërzbulim është të zbulosh  
23 rastet e këqija që na bëjnë dëm neve. Unë nuk kuptoj, ndoshta  
24 unë s'po ju kuptoj specifikisht juve, apo unë s'po di të  
25 shprehem qartë. Emri zbulim-kundërzbulim është që të zbulohet

1 e keqja jashtë edhe mbrenda nesh, ato, të evidentohet, të  
2 evitohet kaq detyrë e jona ka qenë evidenca e të gjitha të  
3 këqijave që mund të na, të na kërcënonin mirëqenien dhe jetën  
4 tonë.

5 PY. Po. E keni thënë dhe më herët në dëshminë tuaj këtë që  
6 natyrisht ka qenë pjesë e rolit tuaj kjo gjë. Unë po përpiqem  
7 që të eksploroj me ju nëse ka funksionuar kjo në realitet, dhe  
8 ju thatë që në realitet nuk kishin kapacitete për ta kryer  
9 këtë, flasim për këto muajt, nga fillimi i 1999. A është një  
10 përshkrim i saktë i situatës, pra, që ju nuk ishit në gjendje  
11 ta ushtronit këtë detyrë.

12 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj, është bërë disa herë  
13 pyetja dhe ka marrë përgjigje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e  
15 drejtë, në fakt. Sidoqoftë, mund ta bëni pyetjen.

16 Në rregull, Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni pyetjes.

17 DËSHMITARI: Nuk kam pasur mundësi të -- unë jo se jo, se  
18 nuk është proces i imi hetimi edhe mbarëvajtja juridike,  
19 mirëpo nuk kemi pas atë që kam kërkuar. Ju thashë qëparë, më  
20 herët, unë kam kërkuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U përgjigjët,  
22 e keni thënë këtë.

23 Z. DIXON: [Përkthim]

24 PY. Z. Qadraku, a e pranoni ju se në atë kohë ishte tejet e  
25 vështirë të krijoheshin këto struktura, pra që të hetonin dhe

1 të merreshin masa kundër personave të tillë, sepse thjesht  
2 ishte shumë e vështirë për shkak të betejave, mungesës së  
3 personelit, mungesës së burimeve në atë kohë. E pranoni këtë?  
4 PË. E pranoj, shumë e saktë është.

5 PY. Ju e kalonit pjesën më të madhe të kohës duke luftuar  
6 forcat serbe. Ju s'e kishit as kohën, as kapacitetet t'i  
7 ndërmerrnit këto hapa, që duhet t'i kishte kryer si rregull në  
8 kohë paqëje një shërbim zbulimi.

9 PË. Po unë mendoj se kemi qenë gjatë gjithë kohës kemi qenë  
10 të zënë ose me parapërgatitje ose me sulme, ose me luftime të  
11 çdoditshme. Por sidomos viti 1999 ka qenë i stërmbushur me  
12 luftime në të gjitha qeto territoret ku ne kemi mund të  
13 qëndrojmë. Pra, dhe nuk e kemi pas as atë mekanizëm.

14 Edhe unë mendoj se nuk ka qenë, nuk ka qenë hetuesia punë  
15 e imja. Punë e imja ka qenë vetëm zbulimi. Të evidentoj diçka  
16 çka mund të na rrezikojë edhe t'i jap komandantit, komandanti  
17 e jep nëse do të kishte Gjykatë, nëse do të kishte hetues,  
18 nëse do të kishte diçka tjetër. Puna ime ka qenë veç me zbulu.  
19 Me e ditë ku shumë është keqbërësi, kush është ajo, nëse do të  
20 mundja.

21 PY. A është e vërtetë që ju ishit po ashtu shumë të ngarkuar  
22 në zonën tuaj prej civilëve sepse shumë persona ishin të  
23 shqetësuar për sigurinë e tyre, a ka qenë kjo situata pak a  
24 shumë?

25 PË. Ne njëherësh jetonim me ata që, me banorë aty në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 92

1 fshatrave ku ne qëndronim. Por pastaj ka qenë edhe një

2 grumbullim nga fshatrat e tjera --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht  
4 përgjigjuni pyetjes, Dëshmitar.

5 Z. DIXON: [Përkthim]

6 PY. Keni nevojë ta përsërisim? Pra, thjesht po ju pyesja a  
7 keni qenë shumë të ngarkuar prej situatës me civilët, për  
8 shkak se si ishte situata me civilët.

9 PË. Po, kemi qenë shumë të ngarkuar.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është koha e  
11 pushimit.

12 Dëshmitar, tani do bëjmë një orë e gjysmë pushim. Do  
13 kthehemi në orën 14.30. Ju lutem, mos diskutoni me askënd  
14 dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit.

15 Mund të dilni nga salla me Asistenten.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim  
18 deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

20 --- Seanca rifillon në orën 14.31

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
22 sillni dëshmitarin në sallë.

23 Z. Dixon, bëme një vlerësim dhe ju ka ngelur vetëm një  
24 orë. Ju mjafton?

25 Z. DIXON: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] Unë në fakt dua që të përfundojmë brenda orës  
2 së ardhshme. Besoj se më mjafton.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Bazuar në përgjigjet që ka dhënë  
4 dëshmitari ne rishikuar vlerësimin tonë dhe do të kemi nevojë  
5 për më pak kohë. Besoj rreth 30-40 minuta.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, z.  
7 Ellis?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne kemi dërguar një email më 4  
9 nëntor dhe kemi thënë që kemi nevojë vetëm për një orë e  
10 gjysmë. Po ka të ngjarë që edhe më pak se kaq.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, znj.  
12 Tavakoli, do e keni radhën për sot?

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Besoj dhe ne gjysmë ore, por  
14 dhe më pak se aq mund të mundet të kemi nevojë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
16 të gjithëve.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
19 Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: Mirëdita.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë  
22 me pyetjet e z. Dixon. Ju lutem, dëgjojeni me vëmendje.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. DIXON: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, do fokusohem te materiali filmik, tek

1 intervista, pra, televizive të cilën e pamë edhe dje edhe sot.

2 Unë dua të shohim një fragment tjetër të intervistës të cilën  
3 nuk jua tregoi prokurori.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Është prova me numrin provizor  
5 P01863. Në fakt dua vetëm transkriptin e intervistës në shqip  
6 dhe në anglisht. Nuk është nevoja ta shfaqim videon.

7 PY. Më mjafton transkripti, nëse jeni dakord dhe ju z.  
8 Qadraku. Të mos e shfaqim videon?

9 PË. Po, jam dakord.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Më intereson faqja 11 dhe në  
11 anglisht dhe në shqip. Pak më poshtë, edhe më poshtë, ju  
12 lutem, këtu. Po, e gjeta.

13 PY. Z. Qadraku, gazetari ju ka bërë disa pyetje. Siç mund ta  
14 shohim edhe vetë nga fundi i faqes përmendet:

15 "Përmendet një pjesë që flet për deklaratat hyrëse të  
16 prokurorisë."

17 A shihni diçka të tillë?

18 Thuhet: "Është përmendur aty." Thuhet, "Aty përmenden. Besoj  
19 që e kanë [E pakuptueshme] që dhe në fjalën hyrëse të  
20 Prokurorisë." Pyetja e gazetarit.

21 E gjete?

22 PË. Po.

23 PY. Shkojmë edhe pak më poshtë. Këtë e dhashë vetëm për  
24 kontekst. Dhe do doja të shihja përgjigjen e pyetjes:

25 "Çka përmbajshin ato letra?"

1 Z. DIXON: [Përkthim] Në fakt duhet të kalojmë në faqen  
2 tjetër, në faqen 12:

3 "Çka përmbajshin ato letra?"

4 Vetëm anglishtja. Shqipen mbajeni te faqja 11, ju lutem.

5 PY. Po jua lexoj këtë pjesë. Ju keni thënë:

6 "Këto kanë qenë, krejt janë konë prej luftës. Prej sa jam  
7 zgjedh shef i G-2 e deri sa jam arrestu."

8 E shihni? E gjetët?

9 PË. Po.

10 PY. Viojmë. Gazetari ju pyet:

11 "Në ato letra të shumta që thoni, a keni pas një letër,  
12 një urdhër, për shembull, për ta vrarë dikën?"

13 Dhe ju jeni përgjigjur:

14 "Jo, kurrë; jo, kurrë. Se jo urdhër ne s'e kemi pas  
15 mendjen as qëllimin me vra."

16 Gazetari thotë:

17 "Po."

18 Pastaj ju vijoni më tej:

19 "As mendjen, as qëllimin me vra. Për shembull, shpesh na  
20 kanë vetë popullata vike që ky -- 'që ky është filan njeri që  
21 ka punuar në UDB, por endet çlirë. Pse s'po e merrni?' Pse do  
22 të merrnim? Gjithmonë kam menduar, gjithmonë kam menduar se do  
23 bënte gjykata jonë ligjin e vetingut.

24 "Gazetari: Po, po."

25 Dhe ju pastaj vazhdoni:

1 "Ky ligji i vetingut do merrej me këta persona. Ne nuk  
2 donim të merreshim me këtë çështje."

3 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë përgjigje gazetarit?

4 PË. Po, zotëri, më kujtohet. Edhe kështu edhe ka qenë. Sepse  
5 gjithmonë kam besuar se të gjithë ata njerëz që kanë punuar  
6 kundër Kosovës, gjithmonë kam menduar se gjykata -- do të  
7 formohet gjykata e lustracionit edhe do t'i dënojë ata e jo  
8 unë apo jo Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

9 PY. Po, ju keni menduar që do të krijohet një gjykatë në të  
10 ardhmen. Kështu kishit menduar, vërtet?

11 PË. Po, ashtu kam menduar.

12 PY. Sidoqoftë, nuk u krijua një gjykatë e tillë as në mars as  
13 në prill të '99-s, apo jo?

14 PË. Unë e kam menduar që do të formohet jo veç në luftë por  
15 edhe pas luftës kam menduar që do të krijohet ajo gjykatë për  
16 t'u marrë me njerëz që na kishin dëmtuar për dekada me radhë.

17 PY. Po a është e vërtetë dhe ju e keni thënë dhe vetë në  
18 dëshminë tuaj që ju keni pasur vetëm 5 muaj. Domethënë, keni  
19 pasur në dispozicion pesë muaj nga janari deri në qershor të  
20 '99-s për ta krijuar këtë organizatë. Është një periudhë goxha  
21 e kufizuar jo, apo jo?

22 PË. Po, është një periudhë goxha e kufizuar edhe e përmbushur  
23 më shumë me luftime, sesa me kushte pune.

24 PY. Është e vërtetë apo jo që në atë kohë ju nuk ishit në  
25 gjendje të krijonit asnjë strukturë që të merrej me hetimin e



1 këtyre çështjeve, saktë?

2 PË. Është e vërtetë.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani  
5 dhe ndërkohë, ju lutem, që të pranohet kjo si pjesë e provave  
6 gjyqësore, sigurisht në varësi të vendimit që do të merrni ju.  
7 Mund ta -- përkohësisht mund t'i jepni numër provizor të  
8 provës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
10 [Përkthim] Do t'i japim një numër provizor dhe nëse  
11 vendosim t'i pranojmë të dyja mund t'i bashkojmë në një provë  
12 të vetme.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

14 [Trupi Gjyqësor dhe Sekretari këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kërkojmë që të pranohen vetëm  
17 faqet që përdorëm. Sidoqoftë, ky është vendim i juaji. Nëse  
18 vendosni ta pranoni pjesën tjetër, ju lutem, të bashkëngjisni  
19 edhe këtë faqe.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
21 Faleminderit.

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, ju na shpjeguat dhe është një aspekt që ka  
24 dalë dhe gjatë intervistës, ju keni thënë që ju vinin civilët,  
25 ju bënë pyetje, ju jepnin informacione dhe a është e vërtetë

1 që ndonjëherë ata vetë, pra, popullata, ju jepte ju lista me

2 emrat personash që ata dyshonin se ishin bashkëpunëtorë?

3 PË. Është shumë e vërtetë kjo edhe në të shumtën e rasteve të

4 gjitha informacionet për këto lëvizje kanë arritur nga

5 popullata civile, sepse ushtarët e kishin të pamundur të

6 lëviznin në ato zona ku nuk ishin të kontrolluara nga tonat --

7 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

8 PY. Këto informacione, këto lista që i jepnin individët ju

9 thatë në dëshminë tuaj që disa prej këtyre listave ose

10 informacioneve ia keni dorëzuar ushtarëve në postblloqet në

11 zonën tuaj. A ju kujtohet që e thatë këtë?

12 PË. Po, zotëri, më kujtohet dhe ashtu kemi bërë për t'i

13 ruajtur pozicionet dhe fshatrat tona dhe popullatën civile që

14 ishim aty.

15 PY. Këto lista ju nuk ua dhatë rojeve në postblloqe që t'i

16 arrestonin këta persona, apo jo?

17 PË. Jo, zotëri. Nuk e kishin atë qëllim. Kishim qëllim vetëm

18 të ruajmë territorin tonë, të ruajmë vendndodhjen, të ruajmë,

19 të ruajmë ato çka ishte në territorin tonë.

20 PY. Atëherë, çfarë prisnit ju prej personave në postblloqe,

21 çfarë duhet të bënin ata sipas jush me këto informacione?

22 PË. Ushtarët që ishin në postbllok kishin të drejta që ta

23 legjitimonin personin dhe nëse ai person do -- nuk do të duhej

24 të lejohej që të hynte brenda ai veç kthehej mbrapsht nga

25 kishte ardhur.

1 PY. Ky informacion ishte informacion që ia jepnit edhe ju  
2 edhe personat të tjerë në zonë? Pra, nuk ishit vetëm ju  
3 personi që e jepnit këtë informacion?

4 PË. Këtë informacionet për postbllloqet, për policinë që i  
5 kanë ruajtur postbllloqet nuk i kam dhënë unë. Unë ia kam dhënë  
6 ato që kisha ia kam dhënë komandantit tim edhe ai ka vendosur  
7 me vendimin e tij që ato lista t'i jipen njerëzve adekuatë në  
8 postblllok i cili ruante hyrjen në territorin tonë.

9 PY. Z. Qadraku, për cilin komandant e keni fjalën këtu?  
10 Komandanti i zonës, i brigadës apo të dy së bashku?

11 PË. Fillimisht unë e kam pasur të drejtë vetëm t'i jap  
12 komandantit të zonës një herë deri në mars ishte Drini, pas  
13 marsit ishte Tahir Sinani, kurse ai, ai ka mundur mandej të  
14 komunikojë edhe me komandantët e brigadave t'iu japë sqarimin  
15 nga mund të na vijë rrezikshmëria, pse duhet të kemi kujdes  
16 nga këta njerëz. Kështu që ka shkue për afërsisht kështu në  
17 terren puna.

18 PY. Faleminderit. Është e vërtetë që ju asnjëherë nuk ia keni  
19 kaluar këto informacione Shtabit të Përgjithshëm? Pra, ia keni  
20 kaluar komandantit të zonës dhe jo më lart se aty, saktë?

21 PË. Është e saktë. Gjithmonë unë ia kam dorëzuar këto  
22 informacione vetëm komandantit të zonës dhe komandës sonë.

23 PY. Dhe nuk keni marrë ndonjë listë personash të dyshuar nga  
24 komandanti i zonës, pra, vetë komandanti i zonës ty nuk të ka  
25 dhënë ndonjë listë me persona të dyshuar?

1 PË. Nuk e mbaj mend, por po të kishte, po të ishte, besoj që  
2 do ta kisha evidentuar edhe unë në një raport edhe do ta kisha  
3 dorëzuar si raport në brifing.

4 PY. Pra, kjo është një çështje që do ta kishit diskutuar në  
5 mbledhjet e zonës, për shembull, se si duhet të pajisen  
6 postblloqet, pra, cilët persona do të jenë në postblloqe,  
7 çfarë duhet bërë në raste të caktuara, kështu?

8 PË. Patjetër që e kemi diskutuar edhe në brifingje, sepse  
9 edhe ata ishin pjesëtarë të komandës dhe pse ishin G-ja të  
10 tjera. Domethënë, besoj që kemi marrë të gjitha ato vendime i  
11 kemi marrë në mënyrë të përbashkët, por vendimin kryesor e ka  
12 marrë komandanti i zonës me zëvendëskomandantin e zonës.

13 PY. Dhe a është e vërtetë që nuk i janë dhënë ndonjë urdhër  
14 komandës së zonës për të arrestuar apo për të ndaluar persona  
15 që ishin të dyshimtë?

16 PË. Nuk e mbaj mend të kemi pasur asi raste që të kemi  
17 kërkuar për të arrestuar dikë.

18 PY. Po njësia e policisë ushtarake në zonën tuaj? Ata kanë  
19 qenë një -- ka qenë një strukturë e ndarë nga sektori i  
20 zbulimit, apo jo?

21 PË. Po. Mendoj që policia ushtarake ka qenë një strukturë e  
22 ndarë nga sektori i zbulimit; ka qenë nën komandën  
23 drejtpërdrejt të komandantit të zonës. Mirëpo, policia  
24 ushtarake ka mund të përdorej edhe për ndihmë njësive të  
25 ndryshme në territore të ndryshme gjatë luftimeve.

1 PY. Ju si një punonjës i sektorit të zbulimit nuk ishin në  
2 pozicion që t'i jepnit urdhra policisë ushtarake për të kryer  
3 ndonjë veprim, apo jo?

4 PË. Nuk e di çfarë mund të them këtu. Mirëpo kam mundur të  
5 kërkoj nga ndonjë polic që të kryejë jo ndonjë shkelje  
6 flagrante por që ta kryejë një detyrë më mirë. Për shembull,  
7 te rojet para komandës, për shembull, te rojet e depos së  
8 municioneve. Për shembull, te roja e burimit të ujit, sepse  
9 edhe aty kemi pas roje. Domethënë ka mund ta urdhëroj të  
10 qëndrojë më mirë apo të jetë më i kujdesshëm apo diçka, por jo  
11 se ai kishte komandantin e vet. Komandanti i tyre ishte Nexhmi  
12 Krasniqi. Kështu që besoj që ata kanë marrë urdhra vetëm nga  
13 komandanti i tyre.

14 PY. Pra, nëse donit t'u kërkonit diçka duhet të kalonit  
15 përmes komandës së zonës apo mund t'u drejtoheshit  
16 drejtpërsëdrejti z. Krasniqi ju?

17 PË. Nëse do të ishte shumë urgjente ka mund -- ose nëse nuk  
18 ishte prezent komandanti i zonës ka mundur t'i them  
19 drejtpërdrejt komandantit të policisë ushtarake Nexhmi  
20 Krasniqi diçka, por zakonisht, zakonisht nëse kam pas kohë,  
21 nëse kemi pas arsye më të mëdha ka qenë më mirë dhe ishte  
22 ashtu që kemi shkuar përmes komandës së zonës operative të  
23 Pashtrikut.

24 PY. Po. Dhe ju nuk mund t'i kërkonit policisë ushtarake dhe  
25 as nuk e keni bërë në fakt që të kryeni ndonjë hetim lidhur me

1 ndonjë person që ju mendonit se ndihmonte forcat serbe; a

2 është ky një përshkrim i saktë?

3 PË. Brenda territorit tonë unë nuk mendoj që kemi pasur  
4 njerëz që kanë bashkëpunuar apo punuar me forcat serbe. Kurse  
5 të dalin jashtë territoreve tona ne nuk i kemi rrezikuar as  
6 ushtarët as policinë ushtarake që të zhvillojnë hetime nëse  
7 ata njerëz jetonin jashtë. Kështu që nuk kam pas rast të  
8 urdhëroj dikën edhe nuk ka qenë prapë detyrë e imja të hetoj  
9 për dikën. Detyra ime ka qenë vetëm të ruaj tërësinë e  
10 territorit gjeografik ku ne ishim të përqendruar.

11 PY. A është e vërtetë, që ta sqarojmë pak më shumë; a është e  
12 vërtetë që keni pasur persona në territorin tuaj për të cilët  
13 civilët por dhe ushtarët vetë ndonjëherë mendonin që këta  
14 persona mund të ishin rrezik për përpjekjet tuaja ushtarake? E  
15 keni dhënë një përgjigje, por kam nevojë që ta sqarojmë më  
16 shumë.

17 PË. Nuk mbaj mend diçka konkretisht për të. Mund të ishte,  
18 mund të mos ishte, nuk më kujtohet ndonjë rast specifik për  
19 këtë.

20 PY. Që të jem i qartë. Në dëshminë tuaj ju keni thënë që  
21 vinin informata nga civilët dhe thoshit që X person është  
22 person i dyshimtë. E keni thënë këtë, pra, që vetë civilët  
23 thonin që X person, Y person është i dyshimtë, ju kujtohet që  
24 keni thënë diçka të tillë?

25 PË. Po, zotëri e kam thënë. Sepse civilët kishin mundësi të

1 dilnin edhe jashtë territoreve tona, të shkonin në qytete, të  
2 shkonin në tregje, të blinin, të konsumonin; ishin më të lirë  
3 se ne.

4 PY. Pyetja ime sqaruese është kjo: A është e vërtetë që ju  
5 nuk i keni kërkuar policisë ushtarake që të hetonte këto  
6 rastet e dyshimta?

7 PË. Me sa mbaj mend unë është e vërtetë që unë kurrë s'i kam  
8 kërkuar policisë ushtarake që të hetojë njerëzit e dyshimtë që  
9 jetonin jashtë trevave tona ku ishim ne.

10 PY. Kur thoni "jashtë trevave", por unë e kam fjalën për  
11 territorin tuaj, aty ku ishit ju; a ju është kërkuar ju - më  
12 falni - ju vetë a u keni kërkuar atyre të hetojnë ndonjë  
13 person të caktuar që jetonte në zonën tuaj?

14 PË. Unë mendoj se në zonën ku kemi jetuar ne dhe vepruar ne  
15 nuk ka pasur njerëz të tillë, kështu që s'kam pas një lloj.

16 PY. Tani dëshiroj t'ju pyes për një pjesë tjetër të  
17 intervistës televizive. Nuk është nevoja ta shfaqim sepse e  
18 patë dje. Unë thjesht do t'ju lexoj segmentin përkatës.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Është në faqen 120 të transkriptit  
20 provizor të ditës së djeshme nga rreshti 2 e në vijim.

21 PY. Intervistuesi ju pyet:

22 "Bazuar në pozicionin që kishit, i takon që kishit epror  
23 Kadri Veselin."

24 Gazetari ju ka pyetur kështu. Dhe ju jeni përgjigjur:

25 "Po, deri më 1 prill kur u zgjodh ..."

1 Dhe pastaj është ndërprerë këtu përgjigja, sepse ju ka  
2 ndërprerë gazetari.

3 Dhe ju pyet gazetari, a është e vërtetë që më 2 prill, z.  
4 Veseli nuk ishte më shef i zbulimit ushtarak të UÇK-së dhe  
5 kaloi në shërbimin e zbulimit civil dhe kishte për synim  
6 krijimin e kësaj dege në Kosovë? - më falni, pyetja ishte e  
7 avokatit, jo e gazetarit kjo -.

8 PY. Është e vërtetë që unë ashtu kam menduar edhe ashtu  
9 mendoj ndoshta edhe sot se në këtë pozitë Kadri Veseli ka  
10 qëndruar deri më 2 prill të vitit 1999 kur është zgjedh  
11 drejtor i shërbimit informativ në kuadër të Qeverisë së  
12 Përkohshme të Kosovës. Kështu që është e vërtetë ajo që i kam  
13 thënë gazetarit. Ashtu kam menduar ashtu mendoj edhe sot,  
14 ndoshta jam i gabuar.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po i referohem Shënimit  
16 Përgatitur numër 2, paragrafi 69 për ata që po na ndjekin.  
17 PY. Këtu keni thënë që ai qysh prej 2 prillit ka qenë shefi i  
18 SHIK-ut, ndërsa shefi i ZKZ-së së Shtabit të Përgjithshëm të  
19 UÇK-së ka qenë Fadil Kodra. Këtë e keni thënë gjatë seancës  
20 përgatitore. A është kështu?

21 PË. Është e vërtetë që unë e kam përmendur z. Fadil Kodra,  
22 por nuk e kam përmend nga 2 prilli, sepse vërtet unë nuk e di  
23 as kurrë nuk na është lexuar as kurrë nuk kemi marrë ndonjë  
24 informim kush e ka luajtur, kush e ka mbajtur postin e shefit  
25 të zbulim-kundërzbulimit në Shtabin e Përgjithshëm nga 2



1 prilli i vitit 1999.

2 PY. Që të jemi të qartë, nga sa ju kujtohet ju nga ajo kohë,  
3 kur keni folur me gazetarin në emisionin televiziv ju jeni  
4 përgjigjur me po kësaj pyetje, sepse ju kujtohej që z. Veseli  
5 ka qenë shefi i zbulimit të UÇK-së në mars dhe pastaj keni  
6 thënë "deri më 1 prill deri kur u zgjodh." Pra, ju keni dash  
7 të thoni që më pas ai kaloi te shërbimi civil te SHIK-u;  
8 kështu?

9 PË. Po, unë ashtu kam menduar kur në përgjigjen që i kam  
10 dhënë gazetarit.

11 PY. E mendoni ende këtë gjë e sot e kësaj dite?

12 PË. Edhe sot e mendoj se nga 1 apo 2 prilli Kadri Veseli ka  
13 qenë në fakt, ndoshta ka qenë edhe jashtë vendit besoj atje,  
14 por ka qenë i emëruar drejtor i shërbimit informativ në  
15 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës që është pjesë civile e  
16 udhëheqjes.

17 PY. Por është e vërtetë ama që ju në atë kohë nuk keni pasur  
18 kontakte me të? Nga 2 prilli e në vijim nuk keni pasur fare  
19 kontakte me z. Veseli, apo jo?

20 PË. Unë deri -- nuk kam pasur kontakte më me Kadri Veseli nga  
21 1 prilli, në fakt, apo mëngjesi i 2 prillit nuk kam pasur më  
22 kontakte me Kadri Veselin.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani të  
24 paraqesë në ekran provën P709. Është një dokument që jua kanë  
25 treguar dhe dje, Dëshmitar. Është një dokument që mban datën

1 19 gusht 1999. Z. Sekretar, ju lutem, paraqisni dokumentin në  
2 shqip dhe në anglisht.

3 PY. Dhe do ju kërkoja juve, Dëshmitar, që ta shikonit dhe një  
4 herë këtë dokument.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes në  
6 mënyrë të tillë që të shikojmë nënshkrimin edhe shënimet  
7 përkatëse. Faleminderit..

8 PY. Z. Qadraku, dje ju treguan një dokument të ngjashëm nga  
9 përpara një dite, domethënë para dy ditësh. Megjithatë, dua që  
10 të pyes lidhur me dokumentin që keni përpara në ekran. A është  
11 e vërtetë që këtë shkrimin e dorës që është në fund të  
12 dokumentit që keni përpara në ekran nuk e keni parë asnjëherë,  
13 Dëshmitar?

14 PË. Është e vërtetë që këtë dokument të plotësuar me shkrim  
15 dore poshtë unë nuk e kam parë asnjëherë deri javën e kaluar  
16 kur më është treguar nga Prokurori.

17 PY. Ju thatë se mendoni që emri aty që është z. Sinanaj,  
18 nënshkrimi që është poshtë emrit është i tij. Ai ka qenë  
19 komandant i zonës asokohe. Nënshkrimin e tij a e keni parë  
20 përpara kësaj here dhe a ju përkon që të jetë i njëjti ky  
21 nënshkrim në qoftë se e keni parë?

22 PË. Unë nuk e kujtoj më si është nënshkruar Tahir Sinani,  
23 mirëpo vetëm e lexova këtu që është Tahir Sinani. Nuk më  
24 kujtohet më çfarë shkrimi apo çfarë mënyre të nënshkrimit  
25 kishte ai se kanë kaluar 26 vite, 25 vite. Por po ju them edhe

1 i kam thënë edhe Prokurorit se vërtet, vërtet nuk ka kuptim,  
2 nuk ka kuptim kjo se një ditë më herët kam shkruar të njëjtin  
3 artikull që ia kam dedikuar Tahir Sinanit. Kurse një ditë më  
4 vonë edhe një herë të shkruaj të njëjtën gjë.

5 Ju lutem, unë nuk e di edhe një herë kërkoj nga Gjykata e  
6 nderuar, në mesin e këtyre dokumenteve që më janë treguar mua  
7 shumë dokumente kanë siglën e MUP-it të Serbisë. Është pak e  
8 palogjikshme. Unë jam arrestuar në vitin 2001 në Prizren.  
9 Dokumentet kanë shkuar në Serbi edhe nga Serbia kanë ardhur  
10 këtu. Ky dokument mund të jetë edhe i falsifikuar edhe i  
11 plotësuar, meqë janë të gjitha këto fotokopje, por mua ky  
12 dokument më duket i palogjikshëm, sepse të njëjtin e kam  
13 shkruar pa këtë plotësim me dorë një ditë më herët.  
14 Kështu që kam dyshime për këtë. Nuk e kujtoj, nuk di çka t'ju  
15 them.

16 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Vetëm këto dokumente kemi për të  
17 komentuar. Megjithatë, ajo për të cilën doja t'ju pyesja  
18 kishte të bënte me përmendjen e shef Lulit këtu që shkruhet  
19 këtu në rresht nga shef Luli. Në dëshminë që dhatë dje thatë  
20 që ishte jologjike që kjo të shkruhej. Në qoftë se kjo në fakt  
21 i referohej Kadri Veselit, sepse në atë kohë ai nuk ishte më  
22 në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së si shef i inteligjencën  
23 ushtarake; a është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Ajo është shumë e saktë. Atë u mundova deri tash edhe ta  
25 sqaroj me fjalë të miat.

1 PY. Nuk është logjike, apo jo, sepse nga ajo çfarë dini ju,  
2 nga përvoja juaj vetjake SHIK-u, pra, organi civil i  
3 inteligjencës ose informativ nuk mund t'i jepte urdhra UÇK-së,  
4 domethënë shërbimit të zbulimit ose shërbimit ushtarak të UÇK-  
5 së se çfarë të bënte UÇK-ja me personelin ose stafin e vet;  
6 apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Është shumë e vërtetë, sidomos në këtë kohë që është  
8 gushti i vitit '99 që i bjen dy muaj pas çlirimit e që të  
9 gjithë e kanë ditur që Fadil Kodra është në Shtabin e  
10 Përgjithshëm shef i sektorit të G2-shit e jo Luli.

11 PY. Pra, këto janë struktura tërësisht të ndryshme.  
12 Domethënë, struktura ushtarake informative është komplet e  
13 ndryshme nga ajo civile; apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Unë dëshmoj se struktura e G2-shit të UÇK-së pas luftës  
15 është plotësisht e ndryshme nga ajo pjesë civile të cilën ka  
16 vepruar Kadri Veseli, Luli, në këtë.

17 PY. A mund të pajtohem lidhur me këtë, Dëshmitar, që  
18 pavarësisht se çfarë është ky dokument, domethënë kjo pjesa me  
19 shkrim dore, pavarësisht se çfarë përfaqëson ajo do ishte një  
20 gabim i qartë për t'u dërguar në këtë trajtë, në këtë formë  
21 për strukturën civile, për t'u përfshirë në çështje të kësaj  
22 natyre, pra, që duhet të ketë diçka gabim këtu; a pajtoheni me  
23 mua?

24 PË. Edhe unë mendoj se diçka nuk është në rregull në këtë  
25 drejtim, sepse komandanti Tahir Sinani sidomos --

1 PY. Thjesht përgjigjuni kësaj pyetje së pari një herë,  
2 përgjigjuni pyetjes sime, a pajtoheni me mua?

3 PË. Pajtohem.

4 PY. Tani vazhdoni me pjesën tjetër që doni të shtonit.

5 PË. Unë mendoj se komandanti Tahir Sinani kishte një  
6 kompjuter, kishte një mundësi të më kthente përgjigje, të më  
7 urdhëronte për çfarë do të donte. Mirëpo, me siglën e vet, me  
8 nënshkrimin e vet e jo kështu në këtë formë, në këtë mënyrë të  
9 ma kthejë, të ma kthejë, ta shkruajë edhe një herë ai ato  
10 çfarë kam thënë unë, sepse kjo është e 19 gushtit, kurse unë  
11 atij i kam shkruar më 18 gusht. Domethënë, këtu ka diçka është  
12 diçka shumë dyshuese për mua dhe jo e logjikshme.

13 PY. A e dini në qoftë se është marrë ndonjëherë ndonjë  
14 përgjigje për këtë njoftim zyrtar ose këtë dokument zyrtar;  
15 është dërguar ndonjëherë ndonjë njoftim zyrtar si përgjigje?

16 PË. Nuk e di. Nuk e besoj.

17 PY. Z. [Sipas përkthimit] Krasniqi ka qëndruar në zonën e  
18 Pashtrikut me sa ju kujtohet juve. Juve nuk ju kujtohet të  
19 keni parë ndonjë dokument tjetër plotësues ose që ka lidhje me  
20 këtë që shohim; apo jo?

21 PË. Po, znj. Krasniqi ka qëndruar derisa ajo e ka parë të  
22 arsyeshme të qëndrojë aty në Prizren, pavarësisht asaj që  
23 kishte deklaruar Tahir Sinani.

24 PY. Faleminderit. Tani kam disa tema të tjera që janë temat e  
25 fundit përpara sesa të përfundoj me pyetjet për ju.

1 Tema e parë është kjo: Na e keni sqaruar që z. Veseli nuk  
2 ka qenë më si shef i shërbim-zbulimit të Shtabit të  
3 Përgjithshëm të UÇK-së prej datës 2 prill e në vijim. Në  
4 periudhën përpara kësaj, domethënë, nga janari deri në prill  
5 është e saktë apo jo, Dëshmitar, që ju keni dijeni në qoftë se  
6 ai ka pasur ndonjë zëvendës që kanë punuar për të; a është e  
7 saktë kjo?

8 PË. Po, është e saktë. Nuk jam në dijeni, sepse kurrë s'kam  
9 qenë tek ai edhe në raport apo të kontaktoj me Kadri Veselin  
10 në zyrën e tij në Shtab të Përgjithshëm.

11 PY. Është e drejtë të thuhet, apo jo, që z. Ferit [Sipas  
12 përkthimit] Shala, siç e tha avokati, dhe Elmi Reçica kanë  
13 qenë homologët tuaj? Ata kanë qenë shef i G2-shit në Drenicë  
14 dhe në Nerodime, përkatësisht, dhe që i kanë raportuar  
15 komandantëve të zonave të veta.

16 PË. Unë e besoj se ata kanë qenë ashtu nëpër zonat e veta dhe  
17 unë nuk e kam njohur as Ferat Shalën e as Elmi Reçicën gjatë  
18 luftës. I kam njohur pas luftës.

19 PY. Ju nuk keni pasur kontakt me të gjatë luftës, domethënë,  
20 nuk keni pasur biseda kontakte me ta fare; apo jo?

21 PË. Unë thashë që nuk i kam njohur edhe kam mund të takohem  
22 me ta, por s'i kam njohur edhe s'kam dit cili është cili.

23 PY. Me sa dini ju, ata nuk kanë punuar si zëvendës të z.  
24 Veseli; a është e saktë kjo?

25 PË. Me sa di unë, po, nuk, nuk e di çfarë kanë punuar, po se

1 s'i kam njohur as nuk i kam.

2 PY. Për të qenë të qartë, në përgjigje ju thoni që nuk e keni  
3 ditur se çfarë pune kanë bërë ata. Edhe ajo çfarë dini juve  
4 është që ata kanë qenë pjesëtarë të G2-sheve të të dy zonave  
5 që unë i përmenda pak më herët, domethënë, zonës së Drenicës  
6 dhe të Nerodimës; a është e saktë kjo?

7 PË. Po, është e saktë, por prapë po them se unë nuk i kam  
8 njohur, nuk i kam njohur personalisht si figura edhe ndoshta  
9 edhe mund të gabohem këtu, por besoj se ata kanë qenë nëpër  
10 zonat e tyre, njëri nga Nerodima, tjetra nga Drenica.

11 PY. Faleminderit. Ju keni thënë - dhe për ata që na ndjekin,  
12 bëhet fjalë për paragrafin 17 të Shënimit Përgatitor numër 1 -  
13 keni thënë që mund t'i keni para ata me njëri-tjetrin duke  
14 hëngër diçka dhe i keni thënë që ju bëftë mirë. Dhe pyetja që  
15 ju bë është që kur ka qenë kjo, kur ka ndodhur kjo. A ju  
16 kujtohet ta keni diskutuar këtë në seancë përgatitore?

17 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë. A mund të jepet pak më  
18 shumë kontekst, sepse në këtë paragraf dëshmitari ka shpjeguar  
19 gjithashtu dhe gjëra të tjera.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, lexojeni të plotë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Unë do ta lexoj të  
23 plotën.

24 Z. DIXON: [Përkthim]

25 PY. Pra, në paragrafin 17 të shënimit përgatitor, juve thoni

1 që:

2 "... ju kujtohet që e keni takuar Ferat Shalën dhe Ilmi  
3 Reçicën në Shtabin e UÇK-së, në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-  
4 së në Kleçkë, por nuk jeni të sigurt se kur ka ndodhur kjo.  
5 Kjo nuk ka ndodhur kur ju jeni emëruar në G2, sepse në këtë  
6 rast ju keni takuar vetëm me Zyrapin i cili ju këshilloi që ta  
7 merrni këtë pozicion dhe me të cilin biseduat përreth një orë.  
8 Mund të ketë ndodhur kjo kur ju jeni takuar me Shalën dhe  
9 Reçicën kur shkuat në Radion Kosova e Lirë që mund të ketë  
10 qenë me datën 1 prill ... Kur u takuat Shala dhe Reçica ishin  
11 duke hëngër diçka dhe ju i keni ju bëftë mirë."

12 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

13 PË. Po, më kujtohet ta kem thënë këtë. Mirëpo, është edhe një  
14 rast që ndoshta edhe mua më ka ikur mbas çlirimit mendoj se  
15 nga ora -- nga data 16, 17 qershor që i bjen 3-4 ditë pas  
16 çlirimit kam qenë edhe një herë në Shtab të Përgjithshëm për  
17 me dërgu disa kamionë me armatim që kishin ardhë nga Shqipëria  
18 në Rugovë të Hasit. Ka mund të jetë edhe aty ai takimi që i  
19 kam parë ata. Unë jam përgjigjur shumë me korrektësi  
20 Prokurorit që unë më kujtohet që i kam parë, por nuk më  
21 kujtohet kur i kam parë.

22 Edhe tash mund të jetë edhe kjo që t'i kem parë pesë,  
23 gjashtë ditë pas ditës së çlirimit kur i kam dërguar ato  
24 kamionë me armatim nga Rugova e Hasit për në Kleçkë. Kështu që  
25 me ndjesë ndoshta unë edhe jam habitur, por unë nuk i kam



1 njohur mirë Elmi Reçicën edhe Ferat Shalën në atë kohë. Kështu  
2 që kam mund të gjitha këto janë të përfshira në q'ato që unë e  
3 di dikun -- një herë i kam parë në Shtab të Përgjithshëm por  
4 veç nuk më kujtohet ajo koha që kur i kam parë në Shtab të  
5 Përgjithshëm.

6 PY. A ju kuptoj drejt që ju po thoni që mund t'i keni takuar  
7 ose mund t'i keni parë ata më vonë sesa 1 prilli? Domethënë jo  
8 më 1 prill, por më vonë në qershor të vitit 1999; këtë po  
9 thoni?

10 PË. Këtë desha të them se kam qenë edhe një herë katër apo  
11 pesë ditë pas çlirimit. Kishin ardhë disa kamionë me armatim  
12 në Rugovë të Hasit edhe unë i orientova ata shoferë dhe ata  
13 kamionë deri në Kleçkë, sepse nuk dija ku t'i çoja ata njerëz  
14 me armatime. Kështu që kam qenë edhe një herë atje.

15 PY. Faleminderit. Z. Qadraku, në fund fare dua që t'ju bëj  
16 disa pyetje lidhur me postimin që keni bërë në llogarinë tuaj  
17 në Facebook më datë 6 nëntor 2020. Nuk është e nevojshme që ta  
18 tregojmë në ekran. Aty keni komentuar lidhur me pikëpamjet  
19 personale për FARK-un. A ju kujtohet që ky postim në Facebook  
20 ju tregua dje?

21 PË. Më kujtohet që e kam parë dje, por nuk është një  
22 artikull. Unë e kam shkruar me dhjetëra artikuj. Mendoj se ata  
23 na kanë bërë shumë dëm. Mendoj se kanë mundur të na ndihmojmë  
24 më shumë; do të kishte shkuar lufta më mirë po të ishin me ne.  
25 Të gjitha artikujt që mund t'i shihni në rrjetet sociale në

1 emrin tim i pranoj si të miat, i pranoj si opinionimi im dhe  
2 mendimi im.

3 PY. A pranoni ju, z. Qadraku, se sikurse e thatë dhe dje,  
4 këto janë pikëpamjet dhe opinionet tuaja personale; a e  
5 pranoni këtë?

6 PË. Gjithmonë. Edhe në luftë edhe në shkrimet e mia gjatë  
7 luftës edhe pas luftës edhe me shkrimet në rrjetet sociale  
8 gjithmonë shpreh mendimet e mia. Unë kurrë s'kam mundur të  
9 marr vendime shoqërore, se s'kam qenë në ato pozita. Gjithmonë  
10 kam qenë këshilltar se edhe shefi i G2-shit është lloj  
11 këshilltari i komandantit. Kështu që gjithmonë jam mundur të  
12 luaj rolin e këshilltarit, pavarësisht i gabuar apo i  
13 pagabuar.

14 Pra, ishin gjithmonë opinionet e mia, mendimet e mia edhe  
15 ashtu kam menduar ashtu edhe mendoj dhe sot.

16 PY. Dhe ju jeni në dijeni të faktit që shumë veta në UCK nuk  
17 është se ndajnë të njëjtin opinion personal me ju. Domethënë,  
18 kanë mendim ose opinion të ndryshëm nga i juaji; a është e  
19 saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Patjetër që është e saktë. Secili ka të drejtën e  
21 mendimit të vet. Unë nuk kam vepruar kundër tyre, por kam  
22 shprehur një mendim që mendoj që ata kanë gabuar ashtu

23 PY. Ju e dini, apo jo, Dëshmitar, se janë marrë hapa të  
24 ndryshme në Shtabin e Përgjithshëm, përfshirë këtu edhe z.  
25 Veseli dhe z. Zyrapi - për të integruar FARK-un në UÇK, në

1 mënyrë të tillë që të mos ketë pas ndasi ose ndarje?

2 PË. Po jam i vetëdijshëm, e di.

3 PY. Ju jeni në dijeni se në fillim të nëntorit të '98-s ka  
4 pasur një marrëveshje të qeverisë Bukoshi jashtë shteti dhe të  
5 UÇK-së për të bashkuar ushtritë ose këto dy segmente në mënyrë  
6 të tillë që të ishin më të fortë së bashku; ju kujtohet kjo?

7 PË. Unë nuk kam dijeni për nëntorin e '98-s për ndonjë  
8 marrëveshje, por e di që me 28 nëntor 1998 grupi i madh i  
9 FARK-ut ka hy në Kosovë dhe është pozicionuar në zonën  
10 operative të Pashtrikut. Përafërsisht 148 vetë kanë qenë  
11 pjesëtarë të FARK-ut. Kam qenë atje kur janë nisur për në  
12 Kosovë. E di këtë. Por s'po flas për këtë pjesë që ka hy në  
13 Kosovë, pjesën e FARK-ut e zë atë pjesën jashtë Kosovës. Ajo  
14 na ka dëmtuar shumë me mosveprimin e saj, jo këta që kanë hy  
15 brenda, se këta kanë luftuar si ne. Ishin në UÇK si ne.

16 Këtë pjesë gjithmonë e përjashtoj nga ajo pjesë që unë e  
17 kritikoj. Unë e kritikoj atë pjesën që ka mbet nëpër Shqipëri,  
18 Zvicër e Gjermani tuj hëngër, tuj pi kingja e tu shiku në  
19 televizor qysh po vritet popullata e Kosovës. Për atë pjesë  
20 gjithmonë flas keq edhe i akuzoj për atë që s'kanë vepruar.

21 PY. Faleminderit, z. Qadraku. Po përpiqem të kuptoj atë çfarë  
22 thatë. Ju thoni që jeni të kënaqur me personat që kanë ardhur  
23 dhe që janë integruar, pra, që kanë luftuar bashkë me UCK-në.  
24 Nuk është se keni pas problem me këta persona me fjalë të  
25 tjerë; a është e saktë kjo?

1 PË. Po. Neve s'kemi pas problem me ta. Ata kanë qenë të  
2 organizuar, kanë qenë të emëruar, kanë qenë strukturë  
3 komanduese, secili ka qenë komandant nëpër disa brigada. I  
4 kemi prit mirë edhe kemi -- bashkëluftuar mirë me ta.

5 PY. Pra, nuk ka pasur ndonjë politikë brenda UÇK-së gjatë  
6 luftës për të shënjestruar ata persona të FARK-ut që kishin  
7 ardhur për të luftuar përbri luftëtarëve; a është e vërtetë  
8 kjo?

9 PË. Neve kurrë target s'i kemi pas ata, e para. E dyta, ata  
10 që e kanë pa veten që nuk janë të pastër ata -- ai ka ik vetë.  
11 Më 11 mars ka ik zëvendëskomandanti i zonës operative të  
12 Pashtrikut. Ka ik njeriu me gradë më të madhe nga ana e FARK-  
13 ut. Ishte Sylë Kollçaku ai. Na la, na le vetëm. Nuk na tregoi  
14 kurrë pse po iki. Të kishte pas problem familjar e kishim  
15 liruar. Shko në familje. Ne ishim të gjithë vullnetarë. Ai ka  
16 hy me një qëllim të keq, jam i bindur për këtë. Nuk e pa  
17 rrugën apo momentin për të vepruar edhe iku.

18 Kështu që ne ata pjesëtarë të FARK-ut që kanë ardhë me  
19 luftu i kemi prit mirë, por unë si Halit Qadraku kam pas  
20 gjithmonë një dozë, një dozë frike se mos po na bëjnë sikur në  
21 Dukagjin që kishte bërë Tahir Zema me Ramush Haradinaj. Vetëm  
22 atë dozë kam pas e kurrë nuk kam qenë kundër tyne më.

23 PY. Po. Është e drejtë, apo jo, që pikëpamjet tuaja janë  
24 formësuar shumë nga ajo çfarë ju dini që i kishin ndodhur z.  
25 Zemaj në zonën e Dukagjinit kur ai ishte larguar; është e

1 drejtë të thuhet kjo?

2 PË. Është shumë e drejtë, sepse ka qenë një goditje shumë e  
3 madhe ajo që i ka ndodh Ramush Haradinajt edhe zonës së  
4 Dukagjinit.

5 PY. Ju gjithmonë keni qenë të shqetësuar që mbase e njëjta  
6 gjë mund të ndodhte edhe në zonën tuaj. Domethënë, që mund të  
7 liheshit me duar të kyçura, të mbyllura në njëfarë mënyre?

8 PË. Unë nga natyra ndoshta jam pakëz si edhe idealist i  
9 tepruar dhe në këtë aspekt kam pas frikë se mos po na ndodh  
10 edhe neve mua kjo gjë sikurse që i ndodhi Dukagjinit. Kam pas  
11 një dozë, një dozë frike nga kjo gjë. Por jo kundërshtim për  
12 ta, kurrë. Jam gëzuar shumë kur kanë ardh ata. Ishin oficerë  
13 me karrierë, ishin oficerë të trajnuar, pavarësisht se i  
14 kishte trajnuar armata jugosllave atje. Mirëpo na duheshin  
15 edhe ishin shqiptarë, ishim të gëzuar që kishin vendosur më në  
16 fund të hynin në -- të luftonin për atdhe.

17 PY. Është e drejtë të thuhet që juve kishit nevojë për çdo  
18 ushtar që ishte e mundur në mënyrë të tillë që të mund të  
19 përballonit fuqinë e forcave serbe?

20 PË. Ne kishim nevojë për secilin njeri. Dje më duket e thashë  
21 këtu apo nuk e di, kishim nevojë edhe për një kalë, edhe për  
22 një gomar, edhe për një qen. Kishim nevojë për çdo gjë se  
23 ishim të paktë. Sidomos, sidomos marsi, prilli i '99-s kur  
24 mbetëm të vetmuar 12 mijë ushtarë me një grusht populli brenda  
25 në Kosovë ka qenë kohë shumë e vështirë. Ishte kohë, ishte

1 kohë e përgjakshme. Mungonin të gjitha mjetet si ato ushqimore  
2 si ato të luftës. Edhe kjo ndoshta e ka krijuar atë  
3 shqetësimin tim që unë vazhdimisht kam pas një frikë nga  
4 dështimet që mund të na bënin ata.

5 PY. Pajtoheni mua atëherë që kjo ishte një nismë shumë  
6 pozitive për z. Zyrapi, për z. Veseli që të shkonin jashtë  
7 shteti në shtator dhe në tetor për të siguruar një marrëveshje  
8 me qeverisjen e Bukoshit dhe FARK-un për t'u bashkuar me UÇK-  
9 në. A është deklarata e saktë kjo; a pajtoheni me mua lidhur  
10 me këtë?

11 PË. Pajtohem shumë nëse e kanë bërë atë marrëveshje. Është  
12 marrëveshje shumë e mirë. Kishim nevojë për ta.

13 PY. Dhe a e dini që si rezultat i kësaj marrëveshje, pra,  
14 sipas përvojës tuaj, sa e dini që rezultat i kësaj marrëveshje  
15 ushtarët e FARK-ut kanë ardhur në Kosovë në nëntor dhe pas  
16 nëntorit dhe që kanë punuar në mënyrë të suksesshme me  
17 ushtarët e UCK-së?

18 PY. Zoti avokat, unë e di se brenda 5500 pjesëtarëve që  
19 kishte FARK-u, 148 kanë hyrë në Kosovë. Kurse 5300 kanë  
20 qëndruar prapë në Tiranë, në Gjermani, në Zvicër në vende të  
21 tjera. Domethënë, 148 veta kanë hy në Kosovë më 28 nëntor dhe  
22 atyne ju përkulem, i hek kapelën.

23 PY. Dhe me këta që erdhën ju nuk është se keni pas probleme  
24 me ta. Keni punuar pa problem me ta; keni punuar me  
25 efektivitet me ta; apo jo?

1 PË. Unë me të gjithë ata kam punuar pa problem, pamvarësisht  
2 se ndoshta ndonjëherë kisha një dozë siç e ceka më parë; një  
3 dozë dyshimi, një dozë frike. Mos po na ndodh. Nuk ndodhi me  
4 të gjithë, por ndodhi me njërin.

5 PY. E keni fjalën për personin në komandën e zonës tuaj që u  
6 largua; për këtë e keni fjalën, Dëshmitar?

7 PË. Po, zoti avokat. Ishte komandanti i krejt këtyre. Sylë  
8 Kollçaku ishte komandanti i të gjithë këtyne 148 vetëve kur  
9 kanë hy më 28 nëntor 1998.

10 PY. Ky është personi për të cilin keni shkruar në këtë  
11 postimin në Facebook; apo jo, Dëshmitar? Për këtë e keni pas  
12 fjalën, apo jo?

13 PË. Po, ai është ai personi që kam shkruar për të në  
14 Facebook.

15 PY. Për të konfirmuar, nuk është se ka pas ndonjë politikë  
16 brenda zonës tuaj ose në UÇK që të ndërmerreshin masa negative  
17 kundër këtyre personave, duke i ndaluar ata ose duke kryer  
18 akte dhune ndaj tyre. Kjo është e saktë, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po, është e saktë kjo nuk kam.

20 PY. Faleminderit, z. Qadraku. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit  
22 dhe juve. Ky është fundi i pyetjeve që kam për këtë dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
24 pushim për dhjetë minuta tani.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
2 pushim për dhjetë minuta.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 15.30

4 --- Seanca rifillon në orën 15.41

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni  
6 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Përkthim] Atëherë, znj. Tavakoli që përfaqëson z. Thaçi  
10 ka disa pyetje për ju tani.

11 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Mirëdita, zotëri. Dëshiroj që fillimisht të flasim për  
14 LPK-në. Në rregull?

15 PË. Në rregull.

16 PY. Ju u bëtë anëtar i LPK-së në Zvicër, kështu?

17 PË. Po, zonjë.

18 PY. Nuk keni qenë një prej themeluesve të LPK-së, apo jo?

19 PË. Jo, zonjë.

20 PY. Dhe nuk keni qenë anëtar i strukturës së lartë apo  
21 qendrore të LPK-së, për shembull, nuk keni qenë anëtar i  
22 kryesisë së LPK-së apo asamblesë së LPK-së, apo jo?

23 PË. Nuk kam qenë kurrë as i këshillit të përgjithshëm e as i  
24 kryesisë.

25 PY. Javën e kaluar i keni thënë ZPS-së se keni qenë një



1 anëtar i thjeshtë i LPK-së me fjalët tuaja, kështu keni thënë,

2 apo jo?

3 PY. Ashtu është.

4 PY. Javën e kaluar me Prokurorin por edhe dje Prokurori iu  
5 tregoi një intervistë të Xhavit Halitit nga Blerim Shala. Ju  
6 kujtohet kjo?

7 PË. Po, zonjë.

8 PY. Këtë intervistë ju nuk e kishit parë më përpara, për herë  
9 të parë e patë kur jua tregoi Prokuroria, apo jo?

10 PË. Po, zonjë.

11 PY. Dje i thatë Trupit Gjykses se në atë intervistë Xhavit  
12 Haliti ka folur për aspekte për të cilat ju nuk kishit njohuri  
13 të drejtpërdrejta në atë kohë. Saktë?

14 PË. Shumë e saktë.

15 PY. Edhe ndër shembujt për Gjykatën ishin për shembull  
16 mbledhja e '93-shit e LPK-së dhe vendime që buruan prej kësaj  
17 mbledhje si për shembull krijimi i një mekanizmi të posaçëm  
18 ushtarak. Lidhur me këto aspekte ju keni mësuar pasi ka  
19 ndodhur, pas faktit, kështu?

20 PË. Po, zonjë.

21 PY. Ju nuk keni qenë proces i vendimmarrjes, apo jo?

22 PË. Jo, nuk kam qenë.

23 PY. Ne e dimë që kur u treguan intervistën e z. Haliti  
24 Prokurori ju pyeti a pajtoheni ju me disa nga pjesët që u  
25 shfaqën. Kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Kur ua tregoi ZPS-ja këtë artikull për herë të parë, a të  
3 thanë ty ata se çfarë kishte thënë vetë Haliti lidhur me atë  
4 intervistë? Dhe do tua lexoj unë çfarë ka thënë vetë Haliti  
5 për intervistën në fjalë, dhe më pas mund t'i përgjigjeni  
6 pyetjes sime. Haliti ka dhënë deklaratë. Pra, i treguan  
7 intervistën e pyetën nëse i kujtohej.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe referenca për palët është  
9 material 0835544 Pjesa 1, faqja 9 si dhe faqja 11.

10 PY. Dhe ai tha se i kujtohej intervista. Dhe e pyetën:

11 "Kur ke dhënë intervistën, a keni thënë të vërtetën dhe a  
12 keni qenë i saktë në përgjigjet tuaja?

13 Dhe Haliti tha kështu:

14 "Sa i takon këtyre intervistave ka pasur shumë intervista  
15 dhe personat i kanë përdorur këto intervista për propagandë.  
16 Ka qenë një pjesë për të t'u vendosur në politikën e Kosovës,  
17 përpjekje për t'u futur në politikën e Kosovës kjo gjë. Në  
18 fakt personat kanë shkruar libra dhe kanë dhënë intervista.

19 "Ajo që kam thënë unë në këtë intervistë asnjëherë nuk  
20 është konfirmuar nga askush në Kosovë. Kjo ka qenë një gjë  
21 politike. Kam dhënë një intervistë për arsye politike dhe nuk  
22 kam thënë fakte të plota."

23 Dhe më pas atë e kanë pyetur dhe i kanë thënë:

24 "Po keni thënë shumë fakte në atë intervistë. A po më  
25 thoni ju tani mua që ato nuk kanë qenë të vërteta?"

1 Dhe Haliti është përgjigjur:

2 "Pjesa më e madhe kanë qenë më shumë dëshira të mia për  
3 të ardhmen në mënyrë që të kisha një të ardhme politike."

4 Dhe më pas në faqen 11 ai ka vijuar dhe ka thënë që:

5 "Këto kanë qenë për arsye propagandiste."

6 A e dini ju, Dëshmitar, që z. Haliti është shprehur në  
7 këtë formë lidhur me intervistën e tij?

8 PË. Jo, zonjë. Unë s'e kam lexuar atë libër -- atë  
9 intervistë, në tërësi s'e kam lexuar.

10 PY. A pajtoheni me mua parimisht që pas luftës në Kosovë  
11 shumë persona filluan të shkruanin libra, filluan të jepnin  
12 intervista për ta ekzagjeruar dhe zbukuruar rolin që kanë  
13 pasur ata gjatë luftës?

14 PË. Po, zonjë. Kanë ndodh shumë shpesh që dikush të botojë  
15 ndonjë libër për propagandë, për dëshira të tyre, për ta  
16 rritur veten, për të treguar diçka më shumë. Unë nuk jam një  
17 njeri i tillë, nuk kam shkruar për vete kurrë, kam shkruar  
18 ndoshta një opinione të shkurtra në rrjete sociale, por jam i  
19 vetëdijshëm edhe e di se shumë njerëz kanë shkruar libra, jo  
20 ndoshta të bazuara në shkenca, po në realitetin e jonë [E  
21 pakuptueshme].

22 PY. Tani do kalojmë në një temë tjetër. Dhe dhatë dëshmi dhe  
23 thatë se pas mbledhjes së LPK-së në korrik të '94-s në Prizren  
24 u krijua PBDK-ja, partia politike. Dhe udhëheqësi i parë ka  
25 qenë Bardhyl Mahmuti, a ju kujtohet? Ju kujtohet?

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 124

1 PË. Zonjë, më kujtohet. Mirëpo është korrik '99-s, jo i '94-  
2 s.

3 PY. Ju kërkoj falje. Gabimi im. Po ashtu ju folët për PDK-në.  
4 Dhe unë tani do t'ju tregoj një dokument lidhur me këtë.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I lutem Sekretarisë që të  
6 nxjerrë në ekran materialin DHT04802 - më falni - 884822 deri  
7 në DHT04826, e kemi dhe në anglisht dhe në shqip. Ky është një  
8 fragment që është shkarkuar nga faqja e internetit së Partisë  
9 Demokratike të Kosovës. Ju lutem shkojmë tek teksti poshtë,  
10 tek diçitura poshtë fotografisë të tekstit.

11 PY. Nëse dëshironi mund ta lexoni vetë, Dëshmitar.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem të shfaqet i plotë  
13 teksti. Ju lutem Sekretarit të shohim të plotë tekstin në  
14 shqip. A është e mundur dhe anglishtja? A është e mundur t'i  
15 vendosim përbri po me tekst të plotë. Faleminderit.

16 PY. Pra, a është vërtetë, pra, bazuar në këtë tekst që PDK-ja  
17 është formuar më 10 tetor të '99-s?

18 PË. Mund të jetë. Është e vërtetë edhe kështu edhe unë e kam  
19 deklaruar më duket. Unë e kam thënë që korrik është formuar -

20 PY. Më lejoni të bëj pyetjen që ta sqarojmë fillimisht.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

22 PY. Këtu do të shihni te paragrafi i tretë thotë që:

23 "Që nga themeli kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës  
24 e deri në vitin 2016 ishte z. Hashim Thaçi."

25 E shihni?

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 125

1 PË. Po, zonjë.

2 PY. Kalojmë tani tek faqja e parë.

3 Shohim tekstin. Këtu thuhet se kjo parti është quajtur  
4 fillimisht Partia për Progres Demokratik të Kosovës, që i bie  
5 të jetë PPDK dhe më pas e ndryshoi emrin dhe e bëri Partia  
6 Demokratike e Kosovës. E shihni?

7 PË. Po, e shof.

8 PY. Këtu nuk përmendet fare partia e Bardhyl Mahmutit, apo  
9 jo? Pra, PPDK-ja? Pra, a e shihni këtu? Përmendet sipas ju, po  
10 apo jo?

11 Z. PACE: [Përkthim] Avokatja vetë tha që përmendet këtu  
12 dhe PPDK-ja kur e lexoi tekstin. Nuk e kuptoj tani pse po e  
13 pyet dëshmitarin dhe pse po i thotë nuk përmendet fare  
14 referenca.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk përmendet fare PBDK-ja  
16 këtu. Po them që përmendet PPDK-ja.

17 PY. Edhe një herë, Dëshmitar. Partia e z. Mahmuti, PBDK-ja  
18 nuk përmendet këtu, apo jo?

19 PË. Partia për Progres Demokratik e Kosovës, unë sa mbaj  
20 mend, unë nuk isha pjesë e partisë sepse isha i uniformuar,  
21 unë mbaj mend se kryetari i parë i saj ka qenë Bardhyl  
22 Mahmuti. Mandej në tetor apo më vonë kur ka marrë emërimin  
23 Partia Demokratike e Kosovës që nga fillimi i Partisë  
24 Demokratike të Kosovës e deri në 2016 unë besoj që ka qenë  
25 Presidenti Thaçi dhe kryetar i kësaj partie.

1 Unë kaq kam njohuri për PPDK-në, që kryetari i saj i parë  
2 ka qenë Bardhyl Mahmuti për një muaj apo dy muaj. Kjo është  
3 atë që unë e di.

4 PY. E kuptoj që këtë dini ju, po unë po ju them që e keni  
5 gabim, sepse dokumenti në fakt është korrekt është i saktë dhe  
6 unë po ju shpreh qëndrimin tim. Dhe qëndrimi im është ky, që  
7 Hashim Thaçi ka krijuar një parti të ndarë politike në tetor  
8 të '99-s e cila e kishte fillimisht emrin Partia për Progres  
9 Demokratik të Kosovës dhe kjo parti më pas e ndryshoi emrin  
10 dhe e bëri emrin, Partia Demokratike e Kosovës. Dhe ka qenë  
11 parti më vete. Nuk ka qenë e njëjta parti me partinë e Bardhyl  
12 Mahmutit. A pajtohem me parashtrimin tim, me propozimin tim?  
13 PË. Mund të jetë.

14 PY. Unë e kuptoj që pasi Hashim Thaçi themeloi partinë, ftoi  
15 njerëz që të bashkoheshin në të dhe më pas edhe Bardhyl  
16 Mahmuti u bë pjesë e kësaj partie. Mendoni se mund të ketë  
17 qenë edhe kështu? Të paktën ky është qëndrimi ynë.

18 PË. Unë mendoj ata që e kanë formuar dinë më mirë se unë. Unë  
19 kam qenë e uniformuar, po ju them edhe një herë. Unë mesa mbaj  
20 mend, unë mesa di, unë ashtu e kam dëgjuar pra, në vitin '99  
21 se kryetari i parë i PPDK-së ka qenë Bardhyl Mahmuti sepse  
22 përfaqësuesi i UÇK-së Hashim Thaçi ishte në terren më duket në  
23 Evropë. Pas ardhjes së tij ashtu thonin shokët që Bardhyli  
24 kishte dëshirë që ta dorëzonte partinë e ta udhëheqte Hashim  
25 Thaçi. Kaq janë njohuritë e mia. Mund të jenë të gabushme, por

1 unë kështu e dija.

2 PY. Dua ta sqarojmë këtë sepse e kam pak të paqartë. Ju thatë  
3 dje, por po e thoni dhe tani se ju keni qenë me uniformë i  
4 veshur dhe nuk merreshit me politikë dhe nuk keni qenë  
5 drejtpërsëdrejti i përfshirë në krijimin e partive politike.  
6 Dhe për ata që krijuan partitë politike ju mendoni që duhet të  
7 pyeteshin ata.

8 PË. Po, mendoj se është më e drejtë. Mirëpo unë kaq kisha  
9 njohuri për ta.

10 PY. Atëherë, të ta trajtojmë edhe një herë?

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Apo doni që ta le?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ja morët  
13 mendimin, ai jua dha mendimin. Ju doni të argumentoni me të  
14 lidhur me këtë që tha.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Për sa kjo  
16 është zbardhur për procesverbal, kjo mjafon.

17 Ju lutem mund të pranohet ky dokument si provë gjyqësore?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
19 kundërshtime?

20 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali  
22 DHT04822-04826 pranohet.

23 SEKRETAR I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marri numrin  
24 1D00216 dhe klasifikimi është konfidencial - më falni - publik.  
25 Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

3 PY. Tani duam të flasim vetë për z. Hashim Thaçi. Kur keni  
4 qenë në Zvicrës ju as e keni njohur as keni pasur kontakte me  
5 z. Hashim Thaçi, apo jo?

6 PË. Jo, zonjë. Nuk kam pasur kontakte, as e kam njohur Hashim  
7 Thaçin në Zvicër.

8 PY. Në dëshminë tuaj keni folur për dy raste në '98-n kur e  
9 keni parë Hashim Thaçin. Rasti i parë ka qenë më 13 -- më 30  
10 maj dhe në atë kohë ju nuk e dinit kush ishte ai, apo jo?

11 PË. Po, zonjë. Është e vërtetë, me 30 maj kemi hy një grup  
12 prej 70 persona.

13 PY. Faleminderit. Ai kishte vrarë këmbën dhe ju i thatë  
14 Prokurorisë javën e kaluar se ai kishte dy snajpera në kurriz  
15 dhe se armët i mbajtët ju, armët e tij, kështu? Me "po" ose  
16 "jo" mund të përgjigjeni.

17 PË. Po.

18 PY. A pajtoheni me mua se çdo anëtar i UÇK-së që kalonte  
19 kufirin nga Shqipëria drejt Kosovës mbante armë me vete.  
20 Gjithmonë kishte armë me vete sepse në këtë mënyrë u furnizua  
21 UÇK-ja me armë, përmes kalimit të kufirit në këmbë, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Ju e keni parë po ashtu më 16 nëntor dhe i thatë kolegut  
24 tim të nderuar, z. Dixon, se nuk e keni parë më pasi kaloi  
25 kufirin për në Cahan. Pra, nuk e patë më në Shqipëri pas këtij



1 momenti, saktë?

2 PË. Është e saktë. Nuk e kam parë më.

3 PY. Ju nuk keni pasur komunikime të tjera gjatë luftës me

4 Hashim Thaçin, apo jo?

5 PË. Jo, zonjë. S'kam pasur.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, znj.

9 Tavakoli.

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

11 Z. TULLY: [Përkthim]

12 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Eric Tully. Jam avokat i

13 z. Selimi. Kam rreth gjysmë ore pyetje. Shpresoj që do të

14 përfundojmë brenda orarit nëse ju jeni konciz në përgjigjet

15 tuaja.

16 Unë kam vetëm një temë që dëshiroj të diskutoj me ju dhe

17 ka të bëjë me takimin që thoni se keni pasur me z. Selimi më

18 11 mars 1998.

19 Fillimisht për kontekst. Përpara se të largoheshit në

20 Kosova në 1978-n për shkak të persekutimit politik të babait

21 tuaj, a është e saktë se keni pasur shumë familjarë në komunën

22 e Rahovecit në Kosovë?

23 PË. Po, zotëri.

24 PY. Në rregull. Besoj se i keni thënë Prokurorisë gjatë

25 intervistës në Pjesën 1 të intervistës me numër 1854.1, në

1 faqen 13 - keni thënë Dervish Qadraku, Qamil Qadraku, Naim  
2 Qadraku, të cilët po ashtu u arrestuan të gjithë si veprimtarë  
3 për veprimtari politike. Saktë?

4 PË. Është e saktë.

5 PY. Përpara se të mbërrinit në Kosovë në 1998-n në Kosovë, ju  
6 e kishit dërguar ndërkohë shoqen tuaj dhe fëmijët që të  
7 jetonin në Rahovec, apo jo?

8 PË. Është e vërtetë.

9 PY. Përpara se të mbërrinit në Kosovë, përmes -- për faktin  
10 se ju ishit anëtar i UÇK-së ju e dinit që ekzistonte UÇK-ja,  
11 por thjesht për faktin se ishit një anëtar i thjeshtë i  
12 partisë ju nuk e dinit me konkretësi, konkretisht sesi  
13 funksiononte UÇK-ja. A është kështu?

14 PË. Po, zotëri. Është e vërtetë.

15 PY. Dhe kjo është bazuar në një përgjigje që dhatë dje. Kur  
16 keni shkuar me shokun tuaj, Selim Gashin në Drenicë, pasi  
17 mbërritën në Kosovë, ju thatë që nuk e njihnit Drenicën shumë  
18 mirë, nuk e njihnit as Kosovën shumë mirë. Keni shkuar në  
19 Likovc, jeni prezantuar, keni thënë kush ishit, që ishit  
20 anëtar i Lëvizjes dhe donit të takonit disa shokë dhe të  
21 mobilizoheshit së bashku.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Kjo është thënë në transkriptin e  
23 djeshëm.

24 PY. Të kujtohet kjo përgjigje?

25 PË. Po, zotëri. Më kujtohet dhe ashtu është.

1 PY. Në rregull. Atëherë nga sa kuptoj unë, ju nuk kishit  
2 ndonjë person konkret në mendje. Ju thjesht shpresonit që të  
3 shkonit atje të takoheshit me persona dhe të ofronit shërbimet  
4 tuaja për UÇK-në, kështu?

5 PË. Po, zotëri. Ashtu është.

6 PY. Pra, 11 marsi është menjëherë fill pas ngjarjeve të  
7 Prekazit, apo jo, dhe pas kësaj ngjarje pati një numër të madh  
8 personash që hynë në Kosovë për t'u kyçur në UÇK sikurse dhe  
9 ju vetë, saktë?

10 PË. Po, është e saktë. Mirëpo deshta vetëm të bëj një  
11 vërejtje. Unë me 11 mars kam udhëtuar nga Zvicra për në Kosovë  
12 kështu që nuk do të thotë që kjo datë është ajo kur unë kam  
13 shkuar edhe në Likovc. Mund të jetë katër ditë, tre ditë, pesë  
14 ditë më vonë. Domethënë, po ishte gjatë marsit, kah mesi i  
15 marsit 1998.

16 PY. Në rregull. Por po themi me afërsi, plus minus 11 marsi.  
17 Atëherë. Duke pasur kaq shumë vullnetarë për UÇK-në nuk ishte  
18 më problemi i numrit të personave, por problemi kryesor ishte  
19 çështja e armëve, për shembull, siç ishte rasti sepse kishte  
20 më shumë persona sesa kishte armë, apo jo? Të paktën për  
21 Drenicën, apo jo?

22 PË. Po, zotëri. Ashtu ishte.

23 PY. Pra, ju mbërritët në Likovc dhe sipas asaj që shohim në  
24 Shënimin Përgatitor kur keni shkuar në Likovc keni - Shënimi  
25 Përgatitor numër 1, paragrafi 8 - keni kërkuar të takoni një

1 prej eprorëve i cili më pas rezultoi se ishte Rexhep Selimi, i  
2 cili u prezantua si Dhjetëshi. Tani, unë do t'ju pyes, kush ka  
3 qenë personi i parë që keni takuar ju kur shkuat në Likovc.

4 Për shembull, a takuat ndonjë rojë, në ndonjë bazë, apo takuat  
5 ndonjë person thjesht aty afër? Në qoftë se ju kujtohet kush  
6 ka qenë personi i parë?

7 PË. Po patjetër që kemi takuar rojën. Bile dhe aty na u desh  
8 një kohë e gjatë që t'i sqarojmë që t'i shpjegojmë kush jemi,  
9 nga jemi, që jemi shokë, shokë të disa shokëve që ne njohim.  
10 Po nuk dinim as kush është brenda, veç dinim kush jemi ne. Dhe  
11 ata më duket se biseduan në radiomarrëse, në radiolidhëse edhe  
12 ashtu që meqë pranuan të shkojmë, na pranuan [E pakuptueshme].

13 PË. Kuptoj. Po ky personi me të cilin biseduat ju, thoni që  
14 ka qenë një ushtar i thjeshtë, apo jo?

15 PË. Në vendroje --

16 PY. Personi i parë, personi i parë.

17 PY. Po.

18 PY. Pra, ju kërkuat që të takonit një epror. Po ky epror mund  
19 të ishte cilido, mund të kishte qenë një komandant batalioni,  
20 një komandant toge, një komandant i njësitit tjetër, apo jo?  
21 Ju thjesht donit të takonit një epror, saktë?

22 PË. Saktë.

23 PY. Personi që ju takuat dhe që u prezantua si Dhjetëshi, e  
24 që mësuat më vonë se ishte z. Selimi, për sa kohë biseduat me  
25 të kur mbërritët në Likovc ju dhe Selim Gashi? Sa kohë zgjati

1 biseda me të?

2 PË. Tani nuk mund të kujtoj, po ishte një kohë e mjaftueshme  
3 për t'u marrë vesh çfarë nevoja, ku mund të punojmë që të  
4 kontribuojmë për detyrat tona. Ndoshta një orë, ndoshta 40  
5 minuta, ndoshta kaq.

6 PY. Duke e marrë parasysh faktin që kjo kishte ndodhur shumë  
7 shpejt pas masakrës së Jasharve mendohet që ata ishin shumë të  
8 shqetësuar lidhur me sigurinë. Domethënë a është kështu që  
9 ishin të shqetësuar sa i takon sigurisë së vetes dhe të  
10 persona të tjerë dhe ishin shumë të interesuar që të kishte  
11 një lloj izolimi total ose të përgjithshëm në Likovc. A do  
12 ishte e vërtetë të thuhej kjo?

13 PË. Unë nuk di aq shumë për atë kohë ata çfarë [E  
14 pakuptueshme] po kam parë që kanë qenë të shqetësuar, kanë  
15 qenë të mërzitur për ato vrasjet që kanë ndodhur edhe kanë  
16 qenë të shqetësuar edhe për sigurinë e tyre, patjetër.

17 PY. Kemi dëshmi me fakt që është -- janë përdorur këto kodet  
18 dhe jo emrat ose le të themi janë përdorur nofkat ose jo emrat  
19 e vërtetë të personave. Ky do të ishte një shembull i kësaj,  
20 apo jo?

21 PY. Po, mendoj se ai është një shembull.

22 PY. Pra, ka shumë pak gjasa që në një bisedë të tillë me një  
23 person që ju e keni identifikuar si z. Selimi ai t'ju ketë  
24 treguar juve se çfarë pozicioni ka, çfarë niveli ka, ose çfarë  
25 lloj anëtari është në UÇK. A do ishte e drejtë që të jepej një

1 përshkrim i tillë, Dëshmitar?

2 PË. As nuk e kemi pyetur as nuk na ka interesuar ajo.

3 PY. Në rregull. Gjatë bisedës me të ju e thatë vetë që ishit  
4 të interesuar që të dinit se ku mund të ndihmonit më tepër.

5 Pra, pjesë e kësaj ishte që ju i thatë atij ose ai ju pyeti se  
6 nga çfarë origjine kishit, domethënë, nga ku vinte familja  
7 jote, ndërkohë që ju thatë që familja e kishte origjinën nga  
8 Rahoveci. A është e drejtë kjo, është e vërtetë kjo,  
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, zotëri. Ashtu ka qenë.

11 PY. Në rregull. Tani po të flasim në aspektin strategjik ose  
12 gjeografik Rahoveci, Drenovci, është një vend ideal për të  
13 mbledhur furnizime nga Shqipëria për shkak të qasjes së ka me  
14 kufirin, po gjithashtu edhe për faktin që është në afërsi të  
15 malit. A do ishte e drejtë që të thuhej kjo?

16 PË. Po, zotëri.

17 PY. Kur z. Selimi ju tha që të ktheheshit në komunën tuaj, në  
18 shtëpinë tuaj, ai në thelb ju tha që shërbimet tuaja nuk ishin  
19 më të mirat e mundshme në atë komunë ku ishte, por do të ishte  
20 më mirë që ju të jepnit ndikimin tuaj dhe të jepnit shërbimin  
21 tuaj vullnetar në Rahovec, aty ku kishit zonën tuaj dhe aty ku  
22 dinit më mirë se si të vepronit. A do ishte e drejtë të thuhej  
23 kjo?

24 PË. Po, zotëri.

25 PY. Ai ju udhëzoi, ose ju drejtoi te personi që bënte

1 organizimin në atë zonë, që ishte z. Zyberi në Drenovc.

2 PË. Po, zotëri. Po nuk e mbaj mend a ishte herën e parë apo  
3 herën e dytë kur u takuam, mirëpo ai na ka udhëzuar që e keni  
4 njeriun e juaj në Rahovec me pseudonimin Pesëqindshi, jo me  
5 emër, nuk e ka cek.

6 PY. Z. Zyberi ka qenë i pranishëm në rajon përpara sesa ju të  
7 shkonit atje. Domethënë përpara sesa të mbërrinit në mars, dhe  
8 atëherë ka filluar kontrabandimi. A nuk është kështu, apo jo?  
9 duhet ta thoni me zë, Dëshmitar, për procesverbal.

10 PË. Po, zotëri. Ashtu është.

11 PY. Ai po punonte për të organizuar zonën përpara sesa të  
12 mbërrinit ju. A është e vërtetë kjo? E kam fjalën për z.

13 Zyberi. A është kështu, Dëshmitar?

14 PË. Po, zotëri.

15 PY. Në rregull. Ju keni folur lidhur me këtë si në seancën  
16 përgatitore dhe sot. Kështu që do lexoj dy citime nga seanca  
17 përgatitore. Të dyja këto citime kanë të bëjnë me paragrafin  
18 16. Këtu flitet lidhur me atë se çfarë ka ndodhur në zonën e  
19 dëshmitarit.

20 "Dëshmitar besonte se në çdo komunë kishte një person i  
21 cili e fillonte punën më vete dhe më pas organizonte njerëzit  
22 e tjerë."

23 Më tej thuhet që:

24 "Kishte autonomi sa i takon organizimit dhe [dëshmitari]  
25 thotë që kjo ka qenë situata në të gjitha regjionet e ndryshme

1 sepse nuk mund të detyroje askënd që të krijonte strukturat e  
2 UÇK-së.”

3 Në këto dy citime, a e kuptoj drejt unë që ju po thoni që  
4 zonën tuaj, personi që e ka organizuar punën dhe që ka punuar  
5 në mënyrë autonome, ka qenë z. Zyberi?

6 PË. Po, zotëri.

7 PY. Dhe i takon që ai ka punuar pa urdhra ose pa udhëzime nga  
8 persona nga persona të tjerë jashtë atij regjioni. A është e  
9 saktë kjo?

10 PË. Unë nuk di të them, po besoj që shumicën e rasteve iu ka  
11 përshtat natyrës edhe situatës së përgjithshme.

12 PY. Pra, në thelb, kur ju u larguat dhe shkuat në Drenovc, z.  
13 Selimi në Drenicë, pra, që vazhdoi që të qëndronte në Drenicë,  
14 nuk ka qenë fare i përfshirë në këtë aksionin që ju dhe z.  
15 Zyberi keni kryer në veçanti në zonën Hasit, në regjionin e  
16 Hasit. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Unë mendoj se është e saktë sepse ne, me Mensur Zyberajn  
18 kemi punuar edhe me strukturat e Hasit që të gjejmë shtigje më  
19 të mira, më të lehta për të kaluar në Shqipëri dhe për të  
20 ardhur nga atje.

21 PY. Pra, në thelb kur në shënimin përgatitor thuhet që ju  
22 keni marrë detyra nga z. Selimi për të organizuar rajonin e  
23 Hasit, mbështetur në përgjigjen që ju e keni dhënë sot, z.  
24 Selimi është përfshirë deri në masën që ju ka drejtuar juve  
25 dhe z. Zyberi, i cili ishte një person që kishte nevojë për



1 ndihmën e dikujt edhe që ishte përgjegjës për organizimin e  
2 atij regjioni. A është pak më e saktë kjo që unë sapo  
3 parashtrova, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Kam edhe dy aspekte të tjera. Përderisa ju keni qenë  
6 vullnetar për UÇK-në, dhe këtu flasim për detyrat, si  
7 vullnetarë ju nuk keni qenë i detyruar që të ndiqnit detyrat  
8 që ju janë caktuar kur jeni regjistruar. Domethënë, këto ishin  
9 detyra që ju kishit dalë vetë vullnetar për t'i kryer. Nuk  
10 është se e kishit për detyrim që t'i përmbushnit ato. A është  
11 e saktë?

12 PË. Po, zotëri. Kjo është e saktë. Edhe kam mund ta ndërprej  
13 aktivitetin tim kur të doja unë. Secili ka mundur ta ndërpresë  
14 aktivitetin e vet kur të donte. Ishte luftë vullnetare.

15 PY. Në rregull. Kam edhe dy pyetje të tjera lidhur me këtë.  
16 Dua të jem i qartë, a është e vërtetë që ju nuk i keni  
17 raportuar z. Selimi gjatë kësaj periudhe ose gjatë çdo  
18 periudhe në vitin 1998 dhe 1999? A është e saktë kjo,  
19 Dëshmitar, që nuk i keni raportuar z. Selimi gjatë kësaj  
20 periudhe?

21 PË. Po, zotëri. Është shumë e saktë.

22 PY. Deri në masën që keni dijeni ju, a është e saktë që as z.  
23 Zyberi nuk i ka raportuar z. Selimi, as në vitin 1998 dhe as  
24 në vitin 1999? A është e saktë kjo?

25 PË. Për atë nuk mund të flas, por nuk besoj që ka mundur

1 diçka t'i raportojë sepse nëpër Drenovc kanë kaluar të gjithë,  
2 e gjithë Kosova më duket, duke kaluar për Shqipëri apo andej-  
3 këndeje. Nuk e di, nuk jam i sigurt për këtë.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Ju uroj  
5 rrugë të mbarë.

6 Faleminderit, të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje të  
7 tjera.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Z. Ellis, doni më mirë që të filloni  
9 nesër, apo doni që të filloni -- të vazhdoni me këto minutat e  
10 tjera?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, do ishte më mirë që të fillojmë  
12 nesër. Do t'ju informoj gjithashtu edhe sa i takon kohës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
14 kemi përfunduar sot. Do të duhet që të ktheheni përsëri nesër  
15 për pjesën të tjetër të mbetur të pyetjeve nga ekipet e  
16 Mbrojtjes. Faleminderit.

17 Mund të largoheni tani me Asistenten. Ndërkohë nuk duhet  
18 të flisni me askënd për dëshminë që po jepni përpara Trupit  
19 Gjykues.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

22 --- Seanca mbyllet në orën 16.19

23

24

25